



RAPORTI VJETOR 2020

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL

Vizioni

Të jemi kredibilë dhe të pranuar globalisht si rregullator dhe autoritet mbikëqyrës i aviacionit civil, i radhitur para të tjerëve në rajon dhe më gjerë sa i përket sigurisë së aviacionit

Misioni

Të krijojmë një ambient të aviacionit civil në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare, përmes monitorimit të vazhdueshëm, partneritetit me industrinë dhe nivelit të lartë të kompetencës profesionale të personelit.

Përmbajtja

LISTA E SHKURTESAVE.....	4
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
2. BAZA LIGJORE	9
3. PËRSHKRIMI I AAC-së	10
4. ORGANIZIMI INSTITUCIONAL	11
a) Struktura organizative e AAC-së	11
b) Të hyrat financiare të AAC-së	12
c) Pagat e personelit të AAC-së	13
4.1 BORDI MBIKËQYRËS i AAC-së.....	14
a) Mandati	14
b) Kompetencat	14
c) Funksionaliteti	14
4.2 EKZEKUTIVI	15
a) Drejtori i përgjithshëm	15
b) Zëvendës Drejtori i përgjithshëm.....	15
c) Menaxhmenti	15
4.2 BURIMET NJERËZORE.....	16
4.3 PASURITË	16
5. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË AAC-së.....	16
6. PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI I PUNËS	17
7. SISTEMI PËR MENAXHIM TË CILËSISË.....	18
a) Mirëmbajtja e Sistemit për Menaxhim të Cilësisë (SMC-së).....	18
8. PUNA GJATË VITIT	18
8.1 PËRPPJEKJET PËR ANËTARËSIM TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË ORGANIZMA NDËRKOMBËTARË TË AVIACIONIT	18
a) Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO).....	18
b) EASA.....	18
8.2 NORMALIZIMI I HAPËSIRËS AJRORE TË KOSOVËS.....	19
a) Përshkrimi i hapësirës ajrore të Kosovës	19
b) Normalizimi i hapësirës së ulët ajrore të Republikës së Kosovës.....	22
8.3 MARRËVESHJA PËR HAPËSIRËN E PËRBASHKËT EVROPIANE TË AVIACIONIT (MARRËVESHJA HPEA)	25
a) Vizita vlerësuese nga KE për zbatimin e Marrëveshjes HPEA në Kosovë	25
8.4 PROGRAMI SHTETËROR I SIGURISË (PSHS)	26
8.5 ÇËSHTJET E AVIACIONIT TË NDËRLIDHURA ME INTEGRIMIN EVROPIAN.....	29
a) Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së	29
b) Raporti i Vendit për Kosovën i Komisionit Evropian	30
c) Takimi i Nën-komitetit të MSA-së	31
d) Takimi i Komitetit dhe Këshillit të MSA-së.....	32
8.6 BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL.....	32
8.7 AKTIVITETI I AAC-së NË RRAFSHIN NDËRKOMBËTAR	36
8.8 Bashkëpunimi dypalësh në fushën e aviacionit civil	36
8.9 AKTIVITETI RREGULLATOR/MBIKËQYRËS	38

a)	Siguria e fluturimeve, certifikimi dhe licencimi.....	38
b)	Shërbimet e navigacionit ajror	49
c)	Aerodromet	58
d)	Rregullimi ekonomik i aviacionit.....	67
8.10	AKTIVITETI LEGJISLATIV	72
a)	Aktet nënligjore	72
b)	Urdhëresat administrative, Vendimet ekzekutive dhe vendimet administrative.....	74
c)	Ndëshkime/ ankesa/ konteste.....	79
8.11	PUBLIKIMET TEKNIKE PËR INDUSTRIJË	80
8.11	INFORMIMI I PUBLIKUT DHE QASJA NË DOKUMENTE PUBLIKE.....	81
a)	Qasja në dokumente publike	81
b)	Faqja zyrtare e AAC-së në internet	82
8.12	PROKURIMI.....	82
8.13	RAPORTI FINANCIAR	83
a)	Raporti i buxhetit me shpenzime	83
b)	Të hyrat.....	83
c)	Grantet e përcaktuara të donatorëve	84
d)	Shpenzimet buxhetore.....	84
e)	Planifikimi / Realizimi i buxhetit	87
f)	Investimet kapitale	87
g)	Tabelë krahasuese e buxhetit për tre vitet e fundit.....	88
h)	Buxheti i AAC-së për vitin 2020	88
8.12	AUDITIMET NDAJ AAC-së	88
9.	STATISTIKAT E TRAFIKUT AJROR.....	89
	SHTOJCA 1 - LISTA E TRAJNIMEVE	91
	SHTOJCA 2 - PLANI I PUNËS SË AAC-SË PËR VITIN 2020 DHE REALIZIMI I TIJ	93
	SHTOJCA 3 - STATISTIKAT E TRANSPORTIT AJROR 2020.....	101

LISTA E SHKURTESAVE

AAC	Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës
AMC	Qendra e Mjekësisë së Aviacionit
AME	Ekzaminues Mjekësor të Aviacionit
ANP	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”
ASHNA	Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
BE	Bashkimi Evropian
EASA	Agjencia Evropiane për Sigurinë e Aviacionit
ECAC	Konferenca Evropiane e Aviacionit Civil
EUROCONTROL	Organizata Evropiane për Sigurinë e Navigacionit Ajror
HPEA	Hapësira e Përbashkët Evropiane e Aviacionit
IATA	Asociacioni Ndërkombëtar i Transportit Ajror
ICAO	Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil
IKAP	Instituti Kosovar për Administratë Publike
IPA	Instrumenti i Para-anëtarësimit
ISO	Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit
KE	Komisioni Evropian
KFOR	Misioni i NATO-s në Kosovës
KHAIA	Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike
KTa	Kontrolli i Trafikut Ajror
LAC	Ligji për Aviacionin Civil
LKIA	Kompania private që operon ANP “Adem Jashari”
MF	Ministria e Financave
MI	Ministria e Infrastrukturës
MIE	Ministria e Integritimit Evropian
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MAP	Ministria e Administratës Publike
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
PKZMSA	Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së
PSHS	Programi Shtetëror i Sigurisë
SAP	Sistemet e mjeteve ajrore pa pilot (dronët)
SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës
SMC	Sistemi për menaxhimin e cilësisë
SPR	Standardet dhe praktikat e rekomanduara të ICAO-s
SHNA	Shërbimet e navigacionit ajror
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Autoriteti i Aviacionit Civil është agjenci e pavarur rregullatore e ngarkuar me rregullimin e aspekteve të sigurisë së aviacionit civil dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror. AAC-ja ka kapacitet të plotë juridik; është organizatë e vetëfinancuar buxhetore dhe autoritet publik, i cili iu nënshtrohet dispozitave përkatëse mbi organizatat buxhetore dhe autoritetet publike në ligjet dhe aktet e tjera nënligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

AAC-ja udhëhiqet nga Drejtori i përgjithshëm, ndërsa puna e AAC-së mbikëqyret nga Bordi Mbikëqyrës. Bordi aktual mbikëqyrës i AAC-së është emëruar nga Qeveria në tetor të vitit 2020. AAC-ja ka 30 punonjës dhe megjithë kërkesat e vazhdueshme drejtuar MF-së as në vitin 2020 nuk është miratuar rekrutimi i punonjësve të rinj.

Funksioni bazë i AAC-së është mbikëqyrja dhe rregullimi i aktiviteteve të aviacionit civil në Republikën e Kosovës me qëllim të garantimit të operimeve të sigurta në përputhje me standardet në fuqi. Kjo arrihet përmes inspektimit, auditimit, licencimit dhe certifikimit. Aktivitetet mbikëqyrëse të operatorët që i rregullon AAC-ja gjatë 2020 janë realizuar edhe përkundër vështirësive që janë paraqitur për shkak të situatës pandemike.

Matjet e realizimit të punës së AAC-së kanë treguar se Plani i Veprimit për vitin 2020 është realizuar 87% me veprime të përfunduara, rreth 13% e veprimeve nuk kanë qenë në përgjegjësinë e AAC-së ose kanë pasur ndikim direkt në veprimet e AAC-së.

AAC-ja në bazë të kompetencave të saja ligjore, edhe gjatë vitit 2020 ka vazhduar me nxjerrjen e një numri të akteve nënligjore për zbatim të Ligjit për Aviacionin Civil, si dhe për zbatim të legjislacionit të BE-së në fushën e aviacionit civil. Në kuadër të punës së AAC-së në këtë fushë gjatë vitit 2020 janë nxjerrë gjithsej nëntë Rregullore. Pas situatës së krijuar me përhapjen e pandemisë Covid -19 dhe me qëllim të ndërmarrjes së të gjithë hapave të nevojshëm për parandalimin e kësaj pandemie në lëmin e aviacionit civil, AAC-ja ka nxjerrë tre urdhëresat administrative për adresimin e kësaj çështjeje dhe ndërmarrjen e të gjitha masave për të ndikuar në parandalim e përhapjes së mëtutjeshme të pandemisë.

AAC-ja ka vazhduar të ushtrojë përgjegjësitë e veta drejt përmbushjes së obligimeve që burojnë nga Programi Shtetëror i Sigurisë në aviacion duke u koordinuar me autoritetet tjera dhe operatorët për një menaxhim sa më efikas të sigurisë së aviacionit civil në nivel të shtetit. Janë organizuar dy takime të forumit të nivelit të lartë, Komitetit të PSHS-së, ku përfaqësohen dhe koordinohen të gjitha organizatat shtetërore me rol në sigurinë e aviacionit civil në Republikën e Kosovës. Në nivel të AAC-së, në kuadër të punës së Këshillit të Sigurisë janë kryer veprime të identifikuar si të nevojshme për menaxhimin e sigurisë. Janë përcjellë dhe menaxhuar ndodhitë e raportuara dhe është promovuar siguria në mesin e industrisë së aviacionit në vend.

AAC ka organizuar takime me Komitetin dhe të gjitha institucionet tjera relevante në vendin tonë, me qëllim të koordinimit dhe bashkërendimit të veprimeve ndërinstitucionale bashkë me operatorët për zbatimin e udhëzimeve që dalin nga Agjencia Evropiane për Sigurinë e Aviacionit Civil (EASA) dhe Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO) për parandalimin e përhapjes së COVID-19 edhe kur të hapen kufijtë ajror dhe të fillojnë operimet e rregullta në ANP "Adem Jashari". Gjatë gjithë kohës inspektorët e AAC-së kanë monitoruar për së afërmi operimet në aeroport për tu vërtetuar se masat për parandalimin e COVID janë zbatuar.

Më 10-14 shkurt 2020, me ftesë të Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së, institucionet e RKS me përgjegjësi të zbatimit të obligimeve që dalin nga Marrëveshja HPEA kanë kaluar nëpër një proces vlerësimi nga ekspertët e dërguar në emër të Komisionit Evropian, ku përfshiheshin edhe ekspert nga EASA. Qëllimi i kësaj vizite ishte verifikimi i nivelit të përmbushjes së obligimeve të Republikës së Kosovës karshi Marrëveshjes për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ECAA) në fushën e aviacionit civil dhe rregullimit ekonomik.

Gjatë vitit 2020 AAC-ja ka pranuar raportime për gjithsejtë 101 ndodhi në aviacionin civil, që paraqet një ulje të konsiderueshme krahasuar me numrin e ndodhive të raportuara gjatë viteve të fundit. Besohet se kjo ulje korrespondon me uljen e numrit të fluturimeve për dhe nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari", e cila vjen si rezultati i ndikimit të përhapjes së pandemisë COVID-19 në Kosovë dhe në botë, nga data 13 mars 2020, kur janë konfirmuar dy rastet e para të personave të infektuar me koronavirus në Kosovë.

Në kuadër të diskutimeve për normalizimin e hapësirës së ultë ajrore, më 18 qershor 2020 ASHNA ka nënshkruar Letër Marrëveshje midis ASHNA-s dhe ofruesit shqiptar të shërbimeve AlbControl Tirana ACC, përmes të cilës janë hapur edhe dy pika tjera, KUKAD dhe ARBER, në kufi me Republikën e Shqipërisë, që mund të shfrytëzohen për koordinim të fluturimeve. Me datën 12 tetor 2020, KFOR HQ J3 AIR CHIEF ka kërkuar që në takim të përbashkët në mes KFOR, AACK dhe ASHNA të diskutohet mbi progresin e hapjes së rrugëve ajrore me Shqipërinë. Në takim në mes palëve në datën 15 tetor, ku është ngritur shqetësimi mbi mungesën e kapaciteteve teknike të ASHNA për hapjen e rrugëve ajrore me Shqipërinë. Fakti që ASHNA nuk është e përgaditur teknikisht për realizimin e rrugëve ajrore me Shqipërinë ka ngitur shqetësim të madhe tek KFORi dhe tek AACK, pasi që një vonesë e tillë jo vetëm që do vonoj hapjen e rrugëve ajrore me Shqipërinë por mund të dëmtoj rënd të gjithë procesin e normalizimit të hapësirës ajrore të Kosovës si proces i nisur nga NATO. Sipas informatave nga ASHNA, procesi i hapjes së rrugëve ajrore ndërlidhet me finalizimin e projektit të zgjatjes së pistës, projekt i cili nuk pritet të përfundoj me herët se shtatori i vitit 2021.

Gjatë vitit 2020, kanë vazhduar bisedimet për normalizimin e hapësirës së ulët ajrore dhe hapjen e korridoreve ajrore me të gjitha shtetet fqinje të Kosovës. Këto takime pritet që të vazhdojnë edhe gjatë vitit 2021.

AAC ka vazhduar edhe më tutje bashkëpunimin ndërshtetëror midis Autoriteteve të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës dhe AAC-ve të rajonit. Në kuadër të marrëveshjes dypalëshe, inspektorët e aerodromeve kanë pranuar ftesë zyrtare për tu bërë pjesë auditimit gjithëpërfshirës në kuadër të procesit të konvertimit të certifikatës me Rregulloren e EASA 139/2014, për Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës “Nënë Tereza”. AAC e Kosovës ka dërguar në Tiranë dy inspektorë të aerodromeve për të mbështetur kolegët e AAC të Shqipërisë për këtë proces.

Në përpjekjen e AAC për implementimin e Rregullores nr. 04/2011 lidhur me ofruesit e shërbimeve në tokë, Drejtori i AAC z. Ejupi për të sqaruar situatën lidhur me hapjen e tregut është takuar me palët e interesit si dhe ka drejtuar disa shkresa tek komiteti për partneritet publiko Privat (KPPP) si grup ndërministror, ku ka kërkuar nga që PPP të përkrah procesin e hapjes së tregut duke qenë se është në interes publik por edhe të vet Aeroportit, poashtu është kërkuar shpjegime për tarifat që organi menaxhues i Aeroporti i aplikon ndaj operatorit të vetëm “Ex-fis” shpk tarifa që nuk është në përputhje as me kontratën e PPP-së, por as nuk janë tarifa të cilat janë aprovuar nga AAC sipas rregullores.

Në bazë të Rregullores nr. 03/2016 të AAC-së mbi skemën e përbashkët të tarifave të shërbimeve të navigacionit ajror, ASHNA çdo vit i propozon AAC-së për miratim një vlerë të tarifës terminale njësi e cila do të jetë e aplikueshme në vitin pasues. AAC ka aprovuar tarifa njësi terminale në Republikën e Kosovës në vlerë prej 407 EUR, respektivisht të mbetet e njëjtë me vitin 2020 duke filluar nga 1 janari 2021, e vlefshme për një vit. Kjo vlerë e përcaktuar nga AAC është më e vogël se ajo e propozuar nga ASHNA (495.58 EUR). Duhet pasur parasysh që kjo tarifë është dukshëm më e lartë sesa në vendet e rajonit: Shqipëri 235.67 EUR, Kroaci 241.33 EUR dhe Maqedoninë e Veriut rreth 271.80 EUR. Kjo për arsye që ASHNA ka të vetmin burim financimi këtë tarifë ndërsa për ofruesit e rajonit të hyrat më të mëdha janë nga tarifa njësi e mbikalimit që ata e vjelin për shërbimet e navigacionit ajror që ofrojnë në hapësirën e lartë ajrore.

Buxheti i miratuar i AAC-së për vitin 2020 ishte 979,114 €, gjatë rishikimit të buxhetit për vitin 2020 ka pasur shkurtime buxhetore. Pas vendimeve të Qeverisë për kursime buxheti final i AAC-së në SIMFK për vitin 2020 ka qenë 884,324.22 €, duke përfshirë edhe fondet e pranuar në vlerë prej 5,928.21 €, nga projekti “BEYOND” i financuar nga Komisioni Evropian. Gjatë vitit fiskal 2020, AAC-ja ka shpenzuar 854,870.07 €, që rezulton se realizimi në përqindje është 97% i buxhetit final të alokuar.

Edhe gjatë vitit 2020, AAC është ballafaquar me sfida të shumta të cilat në rrafshin tekniko-profesional ishin të ndërlydhura me faktin që AAC ende, për shkaqe politike jashtë fushëveprimit të saj, nuk ka mundur të bëhet anëtare e barabartë e familjes së organizatave të aviacionit qofshin ato evropiane apo globale. Edhe pse AAC me përpikëri plotëson kërkesat që dalin nga Marrëveshja për Hapësirën e Përbashkët

Evropiane, pala tjetër e kësaj Marrëveshjeje, Komisioni Evropian në emër të Bashkimit Evropian, përkundër përpjekjeve tona, nuk ka siguruar që AAC të trajtohet barabartë me palët tjera të asociuara të marrëveshjes duke pranuar lidhjen e Aranzhimeve të Punës mes EASA-s dhe AAC-së dhe duke i dhënë Kosovës statusin e vëzhguesit në këtë agjenci të BE-së. Njëkohësisht mosanëtarësimi në organizatat ndërkombëtare të aviacionit ICAO, ECAC dhe EUROCONTROL paraqesin pengesa ditore në punën e AAC-së dhe zhvillimin e përgjithshëm të aviacionit në Kosovë.

AAC-ja ka vazhduar përpjekjet për të lidhur marrëveshje teknike të quajtura "Aranzhime të punës" me Agjencinë Evropiane të Sigurisë së Aviacionit (ang., European Aviation Safety Agency - EASA). Këto aranzhime do t'i mundësonin AAC-së qasje në bazën evropiane të të dhënave të sigurisë së aeroplanëve, do të krijonin kornizën e nevojshme për inspektim të performancës së AAC-së nga EASA si dhe për asistencë nga EASA në zbatimin e plotë të dispozitave përkatëse të Marrëveshjes HPEA. Përmes shkresës së dt. 7 dhjetor 2020 që Drejtori i Përgjithshëm ka dërguar të EASA dhe Komisioni Evropian, është rikërkuar lidhja e Aranzhimeve të Punës dhe pjesëmarrja e institucioneve aeronautike Kosovare në grupet e punës së EASA-s. Në periudhën e mbuluar nga ky raport nuk është pranuar ndonjë përgjigje. Gjatë vitit 2020 nuk ka pasur veprime drejt anëtarësimit në Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO) si rezultat i situatës emergjente të krijuar nga pandemia dhe qëndrimi i Qeverisë për moratorium të anëtarësimeve të reja në organizata ndërkombëtare. Më 26 qershor 2020, AAC-ja i ka dërguar një Letër Shtetërore ICAO-s mbi veprimet që ka marrë Republika e Kosovës për të zvogëluar shpërndarjen e COVID 19 përmes transportit ajror dhe mbrojtjen e shëndetit të udhëtarëve përmes ajrit dhe personelit të aviacionit.

Për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, disa aktivitete nuk ka mundur të zhvillohen si duhen, vlen të përmendet: a) kalibrimi i rregullt nga ajri i sistemeve të navigimit është shtyer. Në bazë të Rregullores nr. 03/2011 për Kalibrimin e Instalimeve Aeronautike nga Ajri, si dhe duke u bazuar në Udhëzuesin e lëshuar nga ICAO dhe pas pranimit të një sërë testimesh, të cilat kanë dëshmuar që pajisjet në fjalë nuk kanë devijuar nga operimi normal, është aprovuar shtyrja e afatit të kalibrimit për muajt korrik dhe gusht. Pas lehtësimit të masave ndaj pandemisë në tërë vendet si dhe në vendin tonë, u bë e mundur kontraktimi nga ASHNA, kalibrimin nga ajri u realizua në datën 19-10-2020 të sistemeve të navigimit (DVOR, DME dhe ILS). Për shkak të përballjes me Pandeminë COVID-19, procesi i rregullt i rivalidimit të licencave të kontrolloreve nuk ka mundur të zhvillohet si në vitet paraprake, pasi që situata ka pamundësuar ndjekjen e trajnimeve rifreskuese e që është kërkesë e Rregullores nr.19/2017. Bazuar në Rregulloren nr. 05/2020 mbi rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe themelimin e Agjencisë së Bashkimit Evropian për Sigurinë e Aviacionit, përkatësisht nenit 71 të saj, Rregullores nr. 19/2017 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrolloreve të trafikut ajror, me datë 31.12.2020 ka lëshuar shkresën me të cilë lejon zgjatjen e privilegjeve të miratimeve të njësisë sipas rekomandimit nga DSHNA.

Gjatë vitit 2020 janë lëshuar 9 (nëntë) licenca për studentë kontrollorë, ndonëse për shkak të pandemisë pjesën më të madhe të vitit 2020, shumica e aktiviteve trajnuese (OJTI) kanë qenë të suspenduara.

Gjatë vitit 2020, ANP “Adem Jashari” ka shërbyer gjithsej 1,104,435 udhëtarë, sipas statistikave që ka mbledhur operatori LKIA. Ky numër udhëtarësh është 53% më i ulët se numri i udhëtarëve që janë shërbyer në këtë aeroport në vitin 2019 (2,373,698). Kjo si pasojë e pandemisë së krijuar nga virusi COVID-19, e cila ka shkaktuar krizën më të madhe në historinë e aviacionit. Mirëpo, duhet theksuar që përkundër krizës, Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari” ka qenë i dyti me më së shumti udhëtar në rajon, duke kaluar aeroportet si atë të Zagrebit, Splitit dhe Dubrovnikut.

2. BAZA LIGJORE

AAC-ja në bazë të kompetencave të dhëna në Ligjin nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, është e autorizuar të nxjerrë akte nënligjore për zbatim të Ligjit për Aviacionin Civil, me të cilat bëhet përvetësimi i standardeve ndërkombëtare të aviacionit civil (të njohura si Standardet dhe Praktikat e Rekomanduara “SPR” dhe anekseve të Konventës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil - Konventa e Çikagos) dhe të atyre për zbatim të legjislacionit të BE-së në fushën e aviacionit civil, si ato në kuadër të Marrëveshjes HPEA, ashtu edhe të tjerat, të cilat vlejnë për vendet e BE-së, por që ende nuk janë bërë zyrtarisht pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

AAC nxjerrjen e akteve normative e bënë në përputhje të plotë me dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 03/2013 të Qeverisë së Kosovës për standardet e hartimit të akteve normative. Kjo ndër të tjera nënkupton që secila projekt-rregullore e hartuar nga AAC-ja, kalon nëpër procedurën e marrjes së opinionit të përputhshmërisë me Acquis nga institucionet përgjegjëse të Qeverisë së Kosovës para se të nënshkruhet nga Drejtori i përgjithshëm. AAC aplikon procedurë transparente gjatë nxjerrjes së akteve nënligjore në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr. 1/2012 të AAC-së për procedurat e konsultimit publik. Të gjitha aktet nënligjore të AAC-së i nënshtrohen procesit të konsultimit publik të palëve të interesit. Ky konsultim ndjek procedurat dhe afatet kohore të dhëna, gjatë të cilit, çdo palë interesi, qoftë person fizik apo juridik, ka të drejtën e dhënies së komenteve, sugjerimeve apo të kërimit të informacioneve shtesë nga strukturat e AAC-së, të cilat e nxjerrin një projekt-akt në konsultim publik. Forma e marrjes së këtyre komenteve/sugjerimeve nga palët e interesit mund të jetë me organizim të tryezave të rrumbullakëta, varësisht nga numri i të interesuarve, apo nëpërmes korrespondencës elektronike. Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik, strukturat e AAC-së brenda 2 javëve janë të obliguara që të përgatisin një raport, në të cilin do t'i ofrojnë përgjigjet e tyre në komentet e pranuar, ndërsa duhet të shpjegojnë arsyet për pranimin apo mospranimin e sugjerimeve për ndryshim të dispozitave të projekt-aktit nënligjor që është objekt i konsultimit publik.

Publikimi i akteve nënligjore të AAC-së bëhet në platformën elektronike të Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës si dhe në faqen zyrtare të AAC-së në internet.

3. PËRSHKRIMI I AAC-së

Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës është themeluar si agjenci e pavarur rregullatore në bazë të nenit 14 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil. Nga 1 janari 2009, AAC-ja ka marrë kompetencat e plota në përputhje me këtë ligj. AAC është njëra nga autoritetet publike me përgjegjësi dhe funksione në fushën e aviacionit civil në vendin tonë. Ligji përcakton që Ministria e Infrastrukturës (MI) është përgjegjëse për rregullimin ekonomik të transportit ajror¹, ndërsa Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) është përgjegjëse për rregullimin e aspekteve të sigurimit të aviacionit.² Ligji gjithashtu themelon Komisionin për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA), si institucion që funksionon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës.³

AAC-ja është e ngarkuar me rregullimin e aspekteve të sigurisë së aviacionit civil dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror. Rregullimi ekonomik i aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror nënkupton miratimin e tarifave për shfrytëzimin e shërbimeve që ofrojnë këta operatorë. AAC-ja ka kapacitet të plotë juridik dhe për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Sipas Ligjit për Aviacionin Civil, AAC-ja është përgjegjëse për:

- zbatimin e legjislacionit mbi aviacionin civil dhe zbatimin e politikave të miratuara nga MI-ja ose Qeveria në fushën e aviacionit civil;
- ofrimin e këshillave dhe propozimeve për MI-në, Qeverinë dhe Kuvendin lidhur me politikat dhe legjislacionin nga fusha e aviacionit civil;
- nxjerrjen e rregulloreve zbatuese dhe urdhrave të navigacionit ajror, në përputhje me Ligjin për Aviacionin Civil dhe Marrëveshjen mbi Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit, me qëllim të zbatimit të politikave të aviacionit civil të MI-së dhe legjislacionit përkatës nga fusha e aviacionit civil;
- lëshimin e licencave, certifikatave dhe lejeve në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë e AAC-së të përcaktuara nga Ligji për Aviacionin Civil;
- rregullimin e sigurisë së transportit ajror në Republikën e Kosovës;
- rregullimin e ekonomisë së aeroporteve dhe shërbimeve të navigacionit ajror;
- ofrimin e këshillave për MI-në në lidhje me përgatitjen nga Ministri të propozim-politikave mbi shfrytëzimin e hapësirës ajrore të Kosovës, të cilat i përmbushin nevojat e shfrytëzuesve, duke pasur parasysh sigurinë kombëtare,

¹Ligji për Aviacionin Civil, Kreu 2

²Po aty, Kreu 4

³Po aty, Neni 5

faktorët ekonomikë dhe mjedisorë dhe nevojën për standarde të larta të sigurisë;

- mbikëqyrjen dhe sigurimin e zbatimit në mënyrë efektive të legjislacionit, standardeve, rregullave, procedurave dhe urdhrave të aviacionit civil, përveç kur, me Ligjin për Aviacionin Civil ose me një akt tjetër themelor juridik, ky funksion shprehimisht i është dhënë MI-së ose një autoriteti tjetër publik;
- shpërndarjen e informatave për publikun rreth çështjeve relevante mbi funksionet dhe aktivitetet e AAC-së;
- marrjen e masave, kryerjen e hetimeve dhe inspektimeve dhe nxjerrjen e urdhrave, rregullave, rregulloreve dhe/ose procedurave të cilat AAC me arsye i konsideron të nevojshme për (i) zbatimin e rregullt dhe të ligjshëm të dispozitave të Ligjit për Aviacionin Civil ose (ii) ushtrimin e rregullt dhe të ligjshëm të kompetencave dhe detyrave të cilat i janë dhënë AAC-së me këtë ligj, dhe
- ushtrimin e funksioneve të tjera, të cilat kanë të bëjnë me aviacionin civil në Kosovë që i janë dhënë AAC-së sipas Ligjit për Aviacionin Civil ose një akti tjetër themelor juridik.

4. ORGANIZIMI INSTITUCIONAL

Selia e AAC-së në lagjen Arbëria, rruga “Ahmet Krasniqi” nr. 208 në Prishtinë, në një objekt të përkohshëm të kontraktuar me qera. Zyrat e AAC-së kanë hapësirë të mjaftueshme për t’iu siguruar nëpunësve kushte të mira për punë. Pasiqë zyrat e AAC-së janë të vendosura në një objekt privat, për të cilin paguhet qera, AAC-ja në vazhdimësi ka kërkuar nga Ministria e Administratës Publike të gjejë një zgjidhje për vendosjen e AAC-së në një objekt të përshtatshëm dhe të përhershëm shtetëror, ose për ndarjen e një trualli në qytetin e Prishtinës për ndërtimin e objektit administrativ të AAC-së i cili do të financohej me të hyra vetanake.

Më 23 dhjetor 2020, Ministri i Punëve të Brendshme ztr. Veliu, ka nxjerr Vendim me nr.1044/2020, për akomodimin në ish objektin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, me adresë: Rruga “Zejnel Salihu” nr. 22, 10 000 Prishtinë, në të cilin objekt shpenzimet komunale i bart MPB dhe AAC lirohet nga barra e ngarkesës së qiras.


a) Struktura organizative e AAC-së

Në bazë të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm, struktura organizative e AAC-së përbëhet nga 30 nëpunës të ndarë në këto njësi administrative:

- a) Zyra e Drejtorit të përgjithshëm
 - i. Drejtori i përgjithshëm; (1)
 - ii. Zëvendësdrejtori i përgjithshëm; (1)
 - iii. Zyrtare Ekzekutive (1)
 - iv. Zyra për çështje ligjore të aviacionit; (1)

- v. Zyra për marrëdhënie me publikun; ()
- b) Departamenti i sigurisë së fluturimeve ; (7)
- c) Departamenti i shërbimeve të navigacionit ajror; (4)
- d) Departamenti i aerodromeve; (4)
- e) Departamenti për bashkëpunim ndërkombëtar dhe rregullim ekonomik të Aviacionit; (3)
- f) Departamenti për siguri dhe cilësi; (1)
- g) Departamenti i administratës dhe burimeve njerëzore. (6)

Organogrami i AAC-së



b) Të hyrat financiare të AAC-së

AAC-ja është organizatë e vetëfinancuar buxhetore, sipas nenit 25 të Ligjit nr. 03/L-051 për aviacionin civil, por në praktikë kjo nuk është zbatuar, edhe përkundër kërkesave të vazhdueshme nga AAC. Tani e vite më pas, Ministria e Financave e ndanë buxhetin AAC-së si grant qeveritar dhe jo si të hyra të dedikuara sipas kodit përkatës buxhetor, rrjedhimisht vetëm 42% e të hyrave vetanake i lejohen AAC-së për buxhetin e saj vjetor. Pjesa tjetër derdhet në arkën e shtetit si të hyrat tjera nga taksat dhe tatimet.

Sipas Nenit 25 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, të ardhurat e dedikuara të AAC-së përbëhen nga:

- taksat të cilat ndërlidhen me aviacionin, detyrimet dhe tarifat;

- një përqindje nga shërbimet e navigacionit ajror që ofrohen brenda hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës;
- tarifatat për sigurinë e pasagjerëve dhe tarifatat e certifikimit dhe licencimit; dhe
- donacionet, grantet dhe përkrahjet (mbështetjet) tjera financiare ose teknike të caktuara për AAC-në.

Që nga 1 janari 2009, zbatohet Rregullorja nr. 2008/7 e Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit për përcaktimin e tarifës së sigurisë së udhëtarëve që udhëtojnë me fluturime komerciale nga Kosova. Kjo Rregullore përcakton një tarifë sigurie prej 2 euro për çdo udhëtar që niset nga Kosova me fluturime komerciale. Sipas Ligjit për Aviacionin Civil dhe dispozitave të kësaj Rregulloreje, fondet e mbledhura nga kjo tarifë sigurie janë të ardhura të dedikuara për AAC-në me qëllim të mbulimit të shpenzimeve operative.

Duke filluar nga gjysma e vitit 2011, AAC-ja përmes Rregullores nr. 7/2011 për tarifatat e ngarkuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës, e cila më pas është shfuqizuar me Rregulloren nr. 2/2015, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren 05/2018, ka siguruar bazën ligjore për mbledhjen e tarifave për shërbimet të cilat ajo i ofron, që përfshijnë dhënien e licencave, lejeve, certifikatave të ndryshme dhe kryerjen e inspektimeve dhe auditimeve, në përputhje me kompetencat AAC-së për rregullimin e aviacionit civil në Republikën e Kosovës.

Gjatë vitit 2020 AAC ka indentifikuar disa fatura që janë lëshuar sipas rregulloreve në fuqi (në vlerë prej 103,650.00€) të cilat nuk janë paguar sipas memorandumit të nënshkruar mes AAC-së dhe Limak Kosova sipas afateve kohore ku LIMAK nuk e ka bërë pagesën për fakturat e cekura më poshtë me numër: AAC-003/2020 e datës: 10.04.2020, AAC-004/2020 e datës: 14.05.2020, AAC-005/2020 e datës: 15.06.2020 , AAC-006/2020 e datës: 14.07.2020. Me kërkesë të AAC -së është inicuar procedurë përmbartimi për pagesën e obligimeve sipas faturave të lëshuara në vlerë prej 103,650 € mjete të cilat janë paguar menjëherë.

c) Pagat e personelit të AAC-së

Sipas Nenit 24.2 të Ligjit për Aviacionin Civil, pagat e personelit të AAC-së caktohen nga Ministri i Financave, me propozim të Drejtorit të përgjithshëm të AAC-së. Në caktimin e nivelit të pagave, ligji përcakton që, përveç kriterëve profesionale për personelin, duhet të merren parasysh edhe pagat e personelit të industrisë së aviacionit (aeroporti, kontrollit të trafikut ajror, kompanive ajrore), parim ky i kërkuar edhe nga ICAO. Niveli i pagave të personelit të AAC-së është miratuar më 20 mars 2009 nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave, pas propozimit të Drejtorit të përgjithshëm të AAC-së. Pagat e Drejtorit dhe Zëvendësdrejtorit të përgjithshëm të AAC-së janë caktuar nga Qeveria në përputhje me Nenin 20.2 të Ligjit për Aviacionin Civil.

4.1 BORDI MBIKËQYRËS i AAC-së

Në bazë të Ligjit për Aviacionin Civil, veprimtaria e AAC-së mbikëqyret nga Bordi Mbikëqyrës, i cili përbëhet nga pesë anëtarë. Bordi vepron me orar jo të plotë dhe duhet të takohet së paku një herë për çdo tremujor kalendarik. Kryesuesi përfaqëson Bordin në publik dhe menaxhon e organizon punën e Bordit. Bordi merr vendime me shumicë votash dhe ka kuorumin e nevojshëm për marrjen e një vendimi nëse së paku tre anëtarë të Bordit janë të pranishëm.

Drejtori i përgjithshëm i AAC-së i dorëzon Bordit Mbikëqyrës raport gjithëpërfshirës të punës çdo tre muaj dhe raportin vjetor në fund të çdo viti kalendarik.

a) Mandati

Anëtarët e Bordit Mbikëqyrës të AAC-së me Vendim e QRK nr. 03/98 të dt 29.06.2016 kanë pasur mandat katër vjeçar deri me dt. 29.06.2020. Ndërsa, me dt 07.10.2020, QRK me Vendim nr. 11/34 janë emëruar Anëtarët e Bordit Mbikëqyrës të AAC-së me përjashtim të ztr. Ardian Gaxheri me një mandat pasues në Bordin Mbikëqyrës të AAC-së. Mandati i anëtarëve të bordit është katërvjeçar, me mundësi vazhdimi edhe për një mandat.

b) Kompetencat

Bordi Mbikëqyrës është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe shqyrtimin e (i) aktiviteteve dhe vendimeve të AAC-së mbi çështjet administrative, ekzekutive, rregullatore dhe të licencimit, dhe (ii) të gjitha aspekteve të menaxhimit financiar, të ardhurave dhe shpenzimeve të AAC-së. Sipas nenit 16.1 të Ligjit për Aviacionin Civil, nëse shumica e anëtarëve të Bordit konstatojnë se ka arsye për të besuar se AAC nuk është përputhur ose nuk është duke u përputhur me një ose më shumë dispozita të këtij ligji ose një akti tjetër ligjor të zbatueshëm në Kosovë, Bordi duhet ta identifikojë (përcaktojë) fushën në të cilën dyshohet kjo mospërputhshmëri në një raport me shkrim, i cili më pas i dorëzohet Auditorit të Përgjithshëm dhe Kuvendit. Bordi nuk ka kompetenca ekzekutive, kompetenca të zbatimit ose kompetenca rregullatore.

c) Funksionaliteti

Bordi Mbikëqyrës i AAC-së ka qenë funksional deri më 29 qershor 2020. Gjatë kësaj periudhe Bordi ka mbajtur disa takime dhe ka miratuar raportin tremujor (janar-mars) 2020. Raporti tremujor prill-qershor 2020, nuk është miratuar pasi që nuk ka pasur mandat Bordi për të mbajtur mbledhje pas kësaj periudhe kohore.

Më tutje Qeveria e Republikës së Kosovës e ka emëruar Bordin e ri me Vendimin Nr. 11/34. datë 7 tetor 2020, me mandat katërvjeçar, me përbërje prej 5 anëtarëve. Bordi ka mbajtur mbledhjen e tyre të parë të rregullt me datë 3 nëntor 2020. Në këtë mbledhje ka miratuar raportin tremujor të punës për periudhën (korrik-shtator) 2020, për të cilin edhe ka nxjerr Vendim.

4.2 EKZEKUTIVI

AAC udhëhiqet nga Drejtori i përgjithshëm, si organi më i lartë i drejtimit ekzekutiv dhe administrativ. Në punën e tij të përditshme ai mbështetet nga strukturat udhëheqëse të definuara më poshtë: Zëvendësdrejtori i përgjithshëm dhe menaxhmenti

a) Drejtori i përgjithshëm

Drejtori i përgjithshëm ushtron detyrat dhe funksionet e përcaktuara në nenin 21 të Ligjit për Aviacionin Civil dhe në përputhje me ligjet tjera në fuqi, të cilat rregullojnë veprimtarinë e institucioneve publike, përfshirë këtu menaxhimin dhe raportimin e rregullt financiar. Ai punon me orar të plotë. Drejtori i përgjithshëm është zyrtar i AAC-së, i cili është përgjegjës për menaxhimin e përditshëm dhe vendimmarrjen në AAC. Sipas nenit 26 të Ligjit për Aviacionin Civil, Drejtori i përgjithshëm përgjigjet para Kuvendit lidhur me përputhshmërinë e AAC-së me politikat e aviacionit civil si dhe të gjitha ligjet dhe standardet e zbatueshme në Republikën e Kosovës.

Ish drejtori i përgjithshëm z. Eset Berisha është shkarkuar me Vendimin 01/30 të Qeverisë më 12 maj 2020 për mes të cilit edhe është emëruar ushtruesi i detyrës së Drejtorit të Përgjithshëm, z. Arianit Islami, i cili ishte në detyrë deri në emërimin e drejtorit të tanishëm, z. Ejupi.

Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së, z. Bujar Ejupi është emëruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 22 qershor 2020, përmes Vendimit nr. 05/07 në pajtim me nenin 20 të Ligjit nr. 03/L-051 për aviacionin civil. Mandati i Drejtorit të përgjithshëm zgjat pesë (5) vjet dhe mund të riemërohet nga Qeveria edhe për mandate të tjera pasuese me kohëzgjatje të njëjtë.

b) Zëvendës Drejtori i përgjithshëm

Zëvendës Drejtori i përgjithshëm punon me orar të plotë. Zëvendës Drejtori ndihmon Drejtorin e përgjithshëm në udhëheqjen ekzekutive dhe administrative të AAC-së dhe, në mungesë të Drejtorit të përgjithshëm, kryen funksionet e tij.

Z. Xhelil Bektashi është emëruar Zëvendësdrejtor i përgjithshëm i AAC-së nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 27 janar 2017 përmes Vendimit nr. 03/129. Mandati i Zëvendës Drejtorit të përgjithshëm zgjat pesë (5) vjet dhe mund të riemërohet nga Qeveria edhe për mandate të tjera pasuese me kohëzgjatje të njëjtë.

c) Menaxhmenti

Në bazë të Rregullores së brendshme, struktura udhëheqëse apo menaxhmenti i mesëm i AAC-së përbëhet nga drejtorët e departamenteve, të cilët janë përgjegjës për

veprimtarinë e tyre brenda fushëveprimit dhe kompetencave të përcaktuara në përshkrimet e punës. Përgjithësisht, Drejtori i përgjithshëm mund t'ia delegojë kompetencat e tij apo kompetencat e AAC-së një strukture apo nëpunësi, jashtë fushëveprimit të detyrave të kësaj strukture apo nëpunësi, nëse ai e sheh të nevojshme. Drejtori i përgjithshëm gjatë mungesës së përkohshme, në pajtim me nenin 23.1 të Ligjit për Aviacionin Civil, mund të delegoj plotësisht apo pjesërisht kompetencat e tij dhe të AAC-së tek një nëpunës me nivel përgjegjësie udhëheqëse.

4.2 BURIMET NJERËZORE

AAC-ja aktualisht ka 30 punonjës, 28 prej tyre janë pozita të karrierës me akt emërimi, ndërsa 2 pozita janë të emëruar.

AAC-ja investon në ngritjen profesionale dhe përditësimin e njohurive të specializuara të nëpunësve, në përputhje me standardet dhe praktikën e rekomanduara ndërkombëtare.

Në kuadër të planit të trajnimeve për vitin 2020 personeli i AAC-së ka ndjekur gjithsej katërmëdhjetë (14) trajnime. Gjatë vitit 2020 për shkak të pandemisë është mundur vetëm mbajtja e trajnimeve virtuale.

Trajnimet e realizuara në vitin 2020 janë në Shtojcën 1 të këtij raporti.

4.3 PASURITË

AAC-ja posedon 968 pasuri me vlerë në blerje prej 280.798.69 €, ku hyjnë pasuritë mbi dhe nën 1,000 €. Këto pasuri janë kryesisht orendi zyresh, pajisje teknologjike, automjete etj. Pasuritë mbi 1,000 € janë blerë në vlerë monetare prej 115,416.85 €. Këto pasuri rezultojnë të kenë rënë në vlerë zero pas zhvlerësimit, ndërsa, vlera që iu është dhënë pasurive që janë ende në përdorim nga Komisioni për vlerësimin e pasurive të AAC-së është 11,504.70 €. Pasuritë nën 1,000€ janë blerë në vlerë monetare prej 165.381.84 € ndërsa, vlera e mbetur nga zhvlerësimi sipas normave të zhvlerësimit në vite, bazuar në Rregulloren nr. 02/2013 të MF-së për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizata buxhetore, është 15.368,74 €. Disa prej pasurive të kësaj kategorie që kanë vlerë zero por janë ende në përdorim Komisioni ua ka dhënë vlerën prej 26.204.97 €.

5. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË AAC-së

AAC përcjell Objektivat Strategjike për periudhën pesëvjeçare 2019-2023, të hartuara dhe miratuara në fund të vitit 2018. Objektivat strategjike i shërbejnë AAC-së si bazë

e mirë dhe e pazëvendësueshme për planifikimet vjetore që i bën organizata. Planet vjetore hartohen në nivel të menaxhmentit, pas një procesi të identifikimit të veprimeve në nivel të njësive organizative. AAC vendos objektiva pune në baza vjetore. Këto objektiva planifikohen sipas konceptit S.M.A.R.T. (të thjeshta, të matshme, të arritshme, të arsyeshme, me afate kohore).

Për pesë vitet e ardhshme AAC-ja do të përcjellë objektivat strategjike në vijim:

1. Zbatimi i plotë i përgjegjësive rregullatore;
2. Zbatimi i programit shtetëror të sigurisë (PSHS).
3. Normalizimi i hapësirës ajrore;
4. Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare (ky objektivi nuk varet nga AAC);
5. Lidhja e marrëveshjeve teknike ndërkombëtare dhe rajonale;

6. PLANIFIKIMI DHE REALIZIMI I PUNËS

Gjatë muajit janar 2020, nga menaxhmenti i AAC-së është konsoliduar plani për vitin 2020 dhe pastaj është miratuar nga Drejtori i përgjithshëm. Plan i punës në përmbajtje përfshin: planin e veprimit, planin e aktiviteteve mbikëqyrëse, planin për menaxhimin e rreziqeve në AAC, planin e rekrutimit dhe planin e trajnimeve të personelit.

Perkundër situatës së krijuar me Paneminë COVID-19, Plan i aktiviteteve mbikëqyrëse përmes auditeve dhe inspektimeve është realizuar 100% dhe kjo paraqet suksese për AAC.

Matjet e realizimit të punës së AAC-së kanë treguar se Plan i Veprimit për vitin 2020 është realizuar 87% me veprime të përfunduara, rreth 13% e veprimeve nuk kanë qenë në përgjegjësinë e AAC-së ose kanë pasur ndikim direkt në veprimet e AAC-së.

Disa nga veprimet që nuk janë realizuar gjatë vitit 2020, dhe gjatë viteve paraprahe, si për shembull anëtarësimi në organizata ndërkombëtare të aviacionit dhe hyrja në aranzhime kontraktuale ndërkombëtare, kanë qenë të ndërlidhura me faktorë të jashtëm, kryesisht rrethana politike dhe ligjore jashtë kompetencave vendimmarrëse të AAC-së.

Plan i veprimit për vitin 2020 dhe realizimi i tij është i përfshirë në këtë raport në Shtojcën 2.

7. SISTEMI PËR MENAXHIM TË CILËSISË

a) Mirëmbajtja e Sistemit për Menaxhim të Cilësisë (SMC-së)

Projekti për ri-ngritje të sistemit për menaxhim të cilësisë në AAC ka filluar nga muaji maj, mirëpo me pas është pezulluar për të pritur ndryshimet organizative pas hartimit të rregullores së brendshme, e cila është në proces.

8. PUNA GJATË VITIT

8.1 PËRPPJEKJET PËR ANËTARËSIM TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS NË ORGANIZMA NDËRKOMBËTARË TË AVIACIONIT

a) Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO)

ICAO është agjenci e specializuar e OKB-së, e cila nxjerr standarde ndërkombëtare në fushën e aviacionit civil, të detyrueshme për 193 shtetet e saj anëtare. Gjatë vitit 2020 nuk ka pasur veprime drejt anëtarësimit si rezultat i situatës emergjente të krijuar nga pandemia dhe qëndrimi i Qeverisë për moratorium të anëtarësimeve të reja në organizata ndërkombëtare. Më 26 qershor 2020, AAC-ja i ka dërguar një Letër Shtetërore ICAO-s mbi veprimet që ka marrë Republika e Kosovës për të zvogëluar shpërndarjen e COVID 19 përmes transportit ajror dhe mbrojtjen e shëndetit të udhëtarëve përmes ajrit dhe personelit të aviacionit.

b) EASA

AAC-ja ka vazhduar përpjekjet për të lidhur marrëveshje teknike të quajtura "Aranzhime të punës" me Agjencinë Evropiane të Sigurisë së Aviacionit (ang., European Aviation Safety Agency - EASA). EASA është agjenci e specializuar e BE-së, me përgjegjësi në fushën e sigurisë së aviacionit civil. Këto aranzhime do t'i mundësonin AAC-së qasje në bazën evropiane të të dhënave të sigurisë së aeroplanëve, do të krijonin kornizën e nevojshme për inspektim të performancës së AAC-së nga EASA si dhe për asistencë nga EASA në zbatimin e plotë të dispozitave përkatëse të Marrëveshjes HPEA. Deri më tani, EASA nuk ka hyrë në aranzhime kontraktuale me AAC-në për arsye të natyrës politike, jashtë fushëveprimit dhe mundësive të AAC-së apo institucioneve tjera të Republikës së Kosovës. Përmes shkresës së dt. 7 dhjetor që Drejtori i Përgjithshëm ka dërguar te EASA dhe Komisioni Evropian, është rikërkuar lidhja e Aranzhimeve të Punës dhe pjesëmarrja e institucioneve aeronautike Kosovare në grupet e punës së EASA-s. Në periudhën e mbuluar nga ky raport nuk është pranuar ndonjë përgjigje.

8.2 NORMALIZIMI I HAPËSIRËS AJRORE TË KOSOVËS

a) Përshkrimi i hapësirës ajrore të Kosovës

Hapësira ajrore e Kosovës që nga shtatori i vitit 1999 është pjesë e “Hapësirës së Përbashkët Operacionale të Ballkanit – JOA” të NATO-s, nën kontrollin operacional të Qendrës së Kontrollit të Operimeve të Kombinuara Ajrore 5 (Combined Air Operations Control 5 - CAOC5), e cila në vitin 2014 është transferuar te Qendra Torrejon e Operimeve të Kombinuara Ajrore (Combined Air Operation Centre Torrejon CAOC TJ). Kjo hapësirë ajrore është hapësirë e kontrolluar, në të cilën ofrohen shërbime të trafikut ajror.

Në bazë të marrëveshjes në mes të NATO/KFOR-it dhe Hungarisë, hapësira e lartë ajrore e Kosovës (mbi 6205 m) që nga prilli i vitit 2014 për një periudhë pesëvjeçare do të menaxhohet nga ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror të Hungarisë, HungaroControl, i cili u ofron shërbime aeroplanëve që e mbikalojnë këtë hapësirë. Edhe tash ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror të Hungarisë, HungaroControl vazhdon ta menaxhoj hapësira e lartë ajrore e Kosovës (mbi 6205 m).

Hapësira e ulët ajrore e Kosovës (nën 6205 m) menaxhohet/kontrollohet nga Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), e cila ofron shërbime të navigacionit ajror për aeroplanët civilë gjatë fluturimit në hapësirën ajrore të Kosovës me qëllim të aterimit dhe ngritjes nga Aeroporti i Prishtinës. Gjithashtu, shërbime ofrohen edhe për fluturimet e KFOR-it, EULEX-it dhe fluturimet e aviacionit të përgjithshëm në hapësirën e ulët ajrore të vendit. Hapësira e ulët ajrore është e klasifikuar si hapësirë e klasit D dhe F, në përputhje me dispozitat mbi klasifikimin e hapësirës ajrore nga Aneksi 11 i ICAO-s.

Në figurat e mëposhtme janë paraqitur strukturat aktuale të hapësirës ajrore të Kosovës (hapësira e ulët dhe e lartë).

Hapësira e ulët ajrore e Kosovës

Në hapësirën e ulët ajrore aktualisht janë vetëm 2 korridore (shih figurën 1) që përdoren për trafik komercial për vajtje-ardhje nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”. Këto janë XAXAN dhe SARAX në pjesën jugore të Kosovës në drejtim të Maqedonisë.

Në kuadër të diskutimeve për normalizimin e hapësirës së ultë ajrore, më 18 qershor 2020 ASHNA ka nënshkruar Letër Marrëveshje midis ASHNA-s dhe ofruesit shqiptar të shërbimeve AlbControl Tirana ACC, përmes të cilës janë hapur edhe dy pika tjera, KUKAD dhe ARBER, në kufi me Republikën e Shqipërisë, që mund të shfrytëzohen për koordinim të fluturimeve, siç është paraqitur në figurën 2.

Gjatë vitit 2020, në kuadër të takimeve për normalizimin e hapësirës ajrore të Ballkanit (BANM), kanë vazhduar bisedimet për normalizimin e hapësirës së ulët

ajrore dhe hapjen e korridoreve ajrore me të gjitha shtetet fqinje të Kosovës. Këto takime pritet që të vazhdojnë edhe gjatë vitit 2021. Më shumë detaje mbi këtë temë janë dhënë më poshtë.

Figura 1. Struktura e hapësirës së ulët ajrore në Republikën e Kosovës




Figura 2. Pikat e reja, KUKAD dhe ARBER për koordinimin e fluturimeve me Tirana ACC

Hapësira e lartë ajrore e Kosovës

Struktura e hapësirës së lartë ajrore përbëhet nga 2 sektorë (shih figurat 3 dhe 4) nga niveli i fluturimit FL205 (6 km) deri në FL285 (9 km) dhe nga niveli i fluturimit FL285 (9 km) deri në nivelin e fluturimit FL660 (20 km)

Sektori 1 (FL205 deri në FL285) përbëhet nga 4 korridore (rrugë ajrore):

1. Korridori M867, i cili fillon nga pika hyrëse MEDUX dhe përfundon në pikën dalëse KOGAT;
2. Korridori L616, i cili fillon nga pika hyrëse REDVA dhe përfundon në pikën dalëse KOGAT;

3. Korridori L608, i cili fillon nga pika hyrëse LONTA dhe përfundon në pikën dalëse DOLEV;
4. Korridori M749, i cili fillon nga pika hyrëse LONTA dhe përfundon në pikën dalëse UDVAR.




Figura 3. Struktura e hapësirës së lartë ajrore në Republikën e Kosovës: Sektori 1 (FL205 deri në FL285)

Sektori 2 (FL285 deri në FL660) përbëhet nga 5 korridore (rrugë ajrore):

1. Korridori M867, i cili fillon nga pika hyrëse MEDUX dhe përfundon në pikën dalëse KOGAT;
2. Korridori L616, i cili fillon nga pika hyrëse REDVA dhe përfundon në pikën dalëse KOGAT;
3. Korridori L608, i cili fillon nga pika hyrëse LONTA dhe përfundon në pikën dalëse DOLEV;
4. Korridori M749, i cili fillon nga pika hyrëse LONTA dhe përfundon në pikën dalëse UDVAR;
5. Korridori UL603, i cili fillon nga pika hyrëse VABEK dhe përfundon në pikën dalëse LONTA.




Figura 4. Struktura e hapësirës së lartë ajrore në Republikën e Kosovës: Sektori 2 (FL285 deri në FL660)

b) Normalizimi i hapësirës së ulët ajrore të Republikës së Kosovës

Pas përfundimit të luftës, hapësira e lartë ajrore e Kosovës ka qenë e mbyllur për mbikalime të avionëve civilë, dhe nën autoritetin e NATO-s. Kjo hapësirë u hap për fluturime komerciale në vitin 2014, nën menaxhimin e HungaroControl-it. Kontrollorët tanë të trafikut ajror ofrojnë shërbime në hapësirën e ulët ajrore dhe menaxhojnë ngritjet dhe aterrimet në/nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, si dhe për fluturimet tjera brenda territorit të Republikës së Kosovës (të shumtën helikopterë të KFOR-it).

Kontrolli i trafikut ajror në hapësirën e ulët ajrore të Kosovës është nën mbikëqyrjen rregullatore të Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës. Që nga shpallja e pavarësisë, autoritetet e Republikës së Kosovës kanë punuar ngusht me NATO-n, KFOR-in, BE-në, ICAO-n dhe hisedarët tjerë në rajon për normalizimin e hapësirës ajrore të Ballkanit. Ky aktivitet është zhvilluar në kuadër të nismës së NATO-s: Mbledhja për normalizimin e hapësirës ajrore të Ballkanit (*ang. Balkans Airspace Normalization Meeting – BANM*). Interesim të madh kanë pasur edhe kompanitë ajrore, sepse mbi Kosovë kalojnë disa rrugë që historikisht janë

shfrytëzuar shumë në trafikun ajror ndërkombëtar. Meqë tanimë hapësira e lartë ajrore me rihapjen për fluturime komerciale në vitin 2014 konsiderohet e normalizuar, aktivitetet në kuadër të BANM-it janë të fokusuara në normalizimin e hapësirës së ulët ajrore, që nënkupton para së gjithash hapjen e korridoreve të reja ajrore me të gjitha shtetet fqinje.

Në vitin 2017, për herë të parë, nën udhëheqjen e NATO-s filluan që mbledhjet e BANM-it të organizohen në të ashtuquajturin “nivel ekspertësh”. Pjesëmarrës në këto takime ishin nga Republika e Kosovës, Republika e Serbisë, e Malit të Zi si dhe përfaqësues të KFOR-it.

Zhvillimet gjatë vitit 2020 janë përshkruar më poshtë, në renditje kronologjike:

Më 20-21 shkurt 2020, Drejtori i Përgjithshëm, së bashku me drejtorin e Departamentit të SHNA-së z. Arianit Islamin, mori pjesë në takimin e nivelit teknik në kuadër të Normalizimit të Hapësirës Ajrore të Ballkanit (Balkan Airspace Normalization Meeting – BANM). Ky takim në ditën e parë kishte teme përgatitjen e draft Letër Marrëveshjes (LoA) për Rugën Ajrore Speciale Prishtinë Beograd (Belgrade Prishtina Special Air Route - BPSAR), ndërsa ditën e dytë diskutimet për Letër marrëveshjet në mes ASHNA dhe AlbControl dhe në mes ASHNA dhe Agjencisë për Shërbime të Navigacionit Ajror të Malit të Zi.

Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së, e kryesoi delegacionin e Republikës së Kosovës të përbërë edhe nga përfaqësues të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror. Gjatë këtij takimi, delegacioni kosovar zhvilloi takime me: Përfaqësuesit nga NATO - Stafi Internacional, Përfaqësuesit nga NATO - njësia për hapësirën ajrore në Bruksel, Përfaqësuesit nga NATO TORREJON - përgjegjës për publikimin e SPINS (Instruksione Speciale për fluturimet në hapësirën ajrore të Ballkanit), Udhëheqësin e zyrës ligjore të KFOR-it, Udhëheqësin e KFOR J3 Air, njësia për çështjet e operimeve ajrore në KFOR, Përfaqësuesit nga AAC e Islandës, Përfaqësuesin e ambasadës së SHBA-së në Berlin si dhe përfaqësuesin e ambasadës së SHBA-së në Prishtinë, Përfaqësuesin e Eurocontrol, Përfaqësuesin nga Agjencia Evropiane për Siguri në Aviacion si dhe Përfaqësuesin nga Euroëings. Delegacioni i Serbisë nuk është paraqitur në takimin e planifikuar.

Pas diskutimeve teknike, vërejtjet e delegacionit kosovar u inkorporuan në draftin e ri të Letër Marrëveshjes (LoA), dhe pas takimit që NATO do të ketë me delegacionin e Serbisë në ambasadën e Amerikës në Berlin, palëve do t'u dërgohet drafti final për dakordim të dyanshëm. Letër marrëveshja në mes ASHNA dhe AlbControl pothuajse është finalizuar plotësisht, dhe ka mbetur marrja e pëlqimit nga MPJ për nënshkrimin e saj. Ky pëlqim është lëshuar me dt. 12 mars 2020, prandaj kjo marrëveshje mund të nënshkruhet. Sa i përket letër marrëveshjes me Malin e Zi, delegacioni malazez i kryesuar nga Ministri i Transportit dhe Çështjeve Detare z. Osman Nurkovic, u deklarua i gatshëm që të ofroj shërbime për të gjithë aeroplanët në hapësirën ajrore të Malit të Zi në drejtim të Kosovës deri në nivelin FL 145 (5500 m). Nivelet tjera të fluturimit, siç e tha Ministri Nukrovic kontrollohen nga qendra operative e ndërmarrjes së përbashkët në Beograd, prandaj Mali e Zi e ka të

pamundur që të ofroj shërbime në këto nivele të fluturimit. Drejtori i përgjithshëm i AAC-së shprehu mirënjohje për gatishmërinë e palës malazeze për bashkëpunim në hapjen e korridoreve ajrore në mes të dy shteteve dhe kërkoi nga ASHNA që të përgatis një draft të letër marrëveshjes me palën malazeze. Takimi përfundoi me zotimin e palëve për përgatitjen e letër marrëveshjeve dhe me zotimin e AAC të Kosovës dhe të Islandës për nënshkrimin e Memorandumit për Bashkëpunim, si parakusht për zbatim të marrëveshjes së nënshkruar me Komandantin e KFOR-it.

Më 17 shtator 2020, është mbajtur takimi virtual i BANM-it, përmes platformës WEBEX. Në takim morën pjesë përfaqësuesit nga Kosova duke përfshirë përfaqësuesit e AAC-së, ASHNA-s dhe Ministrisë së Infrastrukturës si dhe përfaqësuesit e NATO-s dhe shteteve të rajonit.

Në këtë takim u diskutua tema e normalizimit të hapësirës të ultë ajrore të Republikës së Kosovës, marrëveshja e nënshkruar më parë nga Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror të Kosovës (ASHNA) dhe Ofruesit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror të Shqipërisë (ALB Control), e cila parasheh hapjen e korridoreve të fluturimit ndërmjet dy vendeve, mundësia e shfrytëzimit të korridoreve ajrore ekzistuese me Malin e Zi, të cilat për momentin përdoren vetëm për operime të NATO-s etj.

Takimi i BANM ka përfunduar duke mos arritur pajtushmeri me palën Malazeze sa i përket hapjes së korridoreve me Malin e Zi për shkak të refuzimit të tyre, sidoqoft progresi i arritur me Shqipërinë sa i përket nënshkrimit të (LoA) që mundëson hapjen e korridoreve ajrore me Shqipërinë është theksuar se është shembull i mirë i cili duhet të ndjeket edhe nga shtetet tjera fqinje.

Me datën 12 tetor 2020, KFOR HQ J3 AIR CHIEF ka kërkuar që në takim të përbashkët në mes KFOR, AACK dhe ASHNA të diskutohet mbi progresin e hapjes së rrugëve ajrore me Shqipërinë. Në takim në mes palëve në datën 15 tetor, ku është ngritur shqetësimi mbi mungesën e kapaciteteve teknike të ASHNAs për hapjen e rrugëve ajrore me Shqipërinë.

Fakti që ASHNA nuk është e përgaditur teknikisht për realizimin e rrugëve ajrore me Shqipërinë ka ngjitur shqetësim të madhe tek KFOR dhe tek AACK, pasi që një vonesë e tillë jo vetëm që do vonoj hapjen e rrugëve ajrore me Shqipërinë por do të dëmtoj rëndë të gjithë procesin e normalizimit të hapësirës ajrore të Kosovës si proces i nisur që në vitin 2003 nga NATO. Pra dështimi i palës Kosovare për hapjen e rrugëve ajrore me Shqipërinë do ta dëmtoj rëndë mundësinë që Kosova të kërkoj hapjen e rrugëve me Malin e Zi dhe me Serbinë.

Duke qenë se ASHNA është përgjegjëse për implementimin dhe sigurimin e infrastrukturës teknike për hapjen e rrugëve ajrore, kemi kërkuar nga drejtori i ASHNA që të na njoftoj urgjentisht mbi gjendjen, dhe gaditshmerisë teknike të ASHNA për normalizim të hapësirës ajrore, sipas informatave të pranuar nga ASHNA rezultatin se hapja e rrugëve ajrore është i varur nga përfundimi i projektit

të zgjatjes së pistës, projekt i cili nuk pritet të përfundojë para shtatorit të vitit 2021. Për tërë procesin është njoftuar vazhdimisht Ministria e Infrastrukturës.

8.3 MARRËVESHJA PËR HAPËSIRËN E PËRBASHKËT EVROPIANE TË AVIACIONIT (MARRËVESHJA HPEA)

Marrëveshja HPEA (ang. *European Common Aviation Area*; shq. *Hapësira e Përbashkët Evropiane e Aviacionit*) është një marrëveshje multilaterale e cila krijon treg unik dhe rregulla të përbashkëta në fushën e aviacionit, e nënshkruar në mes të qeverive të vendeve të Bashkimit Evropian, Islandës, Norvegjisë dhe shteteve të Ballkanit Perëndimor. UNMIK-u e ka nënshkruar këtë Marrëveshje në emër të Kosovës dhe e ka deklaruar atë përkohësisht të aplikueshme më 10 tetor 2006. Republika e Kosovës, përmes Deklaratës së Pavarësisë, përveç tjerash, ka marrë përsipër të gjitha detyrimet ndërkombëtare të Kosovës, duke përfshirë edhe ato të nënshkruara në emrin e saj nga UNMIK-u. Këto detyrime përfshijnë edhe zbatimin e Marrëveshjes HPEA. Zbatimi i Marrëveshjes HPEA në Republikën e Kosovës është bërë i detyrueshëm përmes Ligjit për Aviacionin Civil dhe rishtazi përmes Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim.

Marrëveshja HPEA ka hyrë në fuqi formalisht më 1 dhjetor 2017. AAC-ja, si pikë kontakti për Marrëveshjen, përcjell zbatimin e saj nga institucionet e Kosovës. AAC-ja monitoron rregullisht legjislacionin e ndërlidhur me aviacion që nxjerr BE-ja, i informon sipas nevojës autoritetet tjera aeronautike të vendit rreth akteve të reja normative të BE-së dhe përfshin në planin e vet të veprimit, përveç akteve të detyrueshme, edhe secilin akt tjetër që e konsideron të nevojshëm dhe të aplikueshëm. Legjislacioni i BE-së, i planifikuar për zbatim në vitin 2020, është përfshirë në Programin Kombëtar për Zbatim të MSA-së.

Zbatimi i kësaj Marrëveshje është i paraparë nëpër dy faza tranzitore. Sipas vlerësimit të KE-së, janë dy çështje të mbetura për kalimin e Kosovës në Fazën II të HPEA-së: zbatimi i Direktivës për kohën e punës dhe heqja e një dispozite në Ligjin e Aviacionit për të drejtat e pasagjerëve. Deri në përfundim të periudhës raportuese, Qeveria kishte draftuar Projekt-ligjin e ri të punës i cili përmban direktivën në fjalë.

a) Vizita vlerësuese nga KE për zbatimin e Marrëveshjes HPEA në Kosovë

Më 10-14 shkurt 2020, me ftesë të Drejtorit të Përgjithshëm të AAC-së, institucionet e RKS me përgjegjësi të zbatimit të obligimeve që dalin nga Marrëveshja HPEA kanë kaluar nëpër një proces vlerësimi nga ekspertët e dërguar në emër të Komisionit Evropian, ku përfshiheshin edhe ekspert nga EASA. Qëllimi i kësaj vizite ishte verifikimi i nivelit të përmbushjes së obligimeve të Republikës së Kosovës karshi

Marrëveshjes për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ECAA) në fushën e aviacionit civil dhe rregullimit ekonomik.

Gjatë kësaj vizite, ekipi i KE-së ka mbajtur takime me DP, të gjitha departamentet dhe divizionet e AAC-së si dhe kanë bërë vizita në MIA, MPBAP, KHAIA, MPMS, Komisionin për Ndihmë Shtetërore, Autoritetin e Konkurrencës dhe operatorin LKIA. Ekspertët e KE si dhe ata nga EASA në fushën e aerodromeve kanë rishikuar përmbushjen e kërkesave të legjislacionit të Bashkimit Evropian, përfshirë funksionimin, proceset dhe procedurat në fushën e aerodromeve. Ekspertët kanë rishikuar gjithashtu edhe përmbushjen e kërkesave të legjislacionit të Bashkimit Evropian, përfshirë funksionimin, proceset dhe procedurat në fushën e menaxhimit të sigurisë, sigurinë e aviacionit nga fushëveprimi i DOVA-së, raportimit të ndodhive në aviacion, licencimit, certifikimit dhe rregullimit ekonomik.

Në takimin përmbyllës, ekspertët kanë vlerësuar në përgjithësi punën dhe përkushtimin e AAC-së në fushën e sigurisë së aviacionit civil dhe të rregullimit ekonomik. Pas kësaj vizite pritet të lëshohet një raport vlerësues për nivelin e zbatimit të marrëveshjes HPEA nga institucionet aeronautike të Republikës së Kosovës.

Gjatë vitit 2020 AAC-ja nuk ka pranuar ndonjë Raport të Vlerësimit nga KE-ja.

8.4 PROGRAMI SHETETËROR I SIGURISË (PSHS)

Sipas Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil (LAC), AAC-ja, si autoritet me përgjegjësi në sigurinë e aviacionit civil, duhet të iniciojë dhe koordinojë hartimin dhe zbatimin e Programit Shtetëror të Sigurisë (PSHS) së aviacionit civil në Republikën e Kosovës. Hartimi dhe zbatimi i PSHS-së është edhe njëra ndër objektivat strategjike të AAC-së për periudhën 2019-2023.

Ky është një sistem i përbashkët i të gjitha institucioneve me rol në sigurinë dhe politikat e aviacionit civil, siç janë përcaktuar me LAC, në të cilin përshkruhet veprimtaria e secilit entitet shtetëror me rol në sigurinë e aviacionit, për rregullim dhe menaxhim të sigurisë në aviacionin civil.

Standardet për hartimin e këtij programi janë të caktuara nga Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO), përmes Aneksit 19 "Menaxhimi i Sigurisë" të Konventës së Çikagos. Ky Aneks ka hyrë në fuqi në nëntor të vitit 2013 dhe shtetet ratifikuese të Konventës kanë detyrim zbatimin e plotë të tij në planet afatmesme të punës. Republika e Kosovës ende nuk ka pasur mundësi të aderojë në këtë Konventë, mirëpo përmes Ligjit për Aviacionin Civil ka marrë obligim për zbatimin e të gjitha standardeve të ICAO-s. Zbatimi i Aneksit 19 të ICAO-s është

kryer përmes Rregullores nr. 04/2018 të AAC-së për “Menaxhimin e Sigurisë” dt. 17 gusht 2018. Për të përmbushur kërkesat e PSHS-së, gjatë vitit 2020 janë ndërmarrë veprimet e përshkruara më poshtë:

- **Takimet e Komitetit të Programit Shtetëror të Sigurisë në aviacionin civil**

Gjatë vitit 2020 janë mbajtur dy takime të rregullta të Komitetit për Programin Shtetëror të Sigurisë. Më 18 mars 2020 është mbajtur takimi i VI-të i Komitetit për PShS dhe me datë 30 korrik 2020 është mbajtur takimi i VII-të i këtij Komiteti. Takimi i parë u thirr nga ish Drejtori i Përgjithshëm për të diskutuar situatën e krijuar pas shpalljes së pandemisë COVID 19, për të diskutuar ndikimin e saj në aviacion. Takimi i dytë u thirr nga Drejtori i përgjithshëm i AAC-së, i sapozgjedhur në këtë detyrë, z. Bujar Ejupi, për tu njoftuar me Komitetin dhe për të diskutuar çështje me rëndësi për aviacionin përveç sfidave të sjellura nga sitata me pandeminë. Takimet e Komitetit mbahen në përmbushje të përgjegjësi që ka ky Komitet dhe zyrtari përgjegjës për PShS, siç janë përshkruar në dokumentin “Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komitetit”.

Komiteti i PSHS-së në Republikën e Kosovës është themeluar përmes Vendimit nr. 05/96 të Qeverisë, më 26 qershor 2016. Anëtarë të këtij Komiteti përveç AAC-së janë Ministria e Infrastrukturës, Agjencia për Shërbime të Navigacionit Ajror, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave dhe Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike.

- **Takimet e Komitetit për PShS dhe insitucioneve tjera relevante në Republikën e Kosovës për koordinim rreth ri-fillimit të oprimeve**

Përveç takimeve të rregullta që ka mbajtur Komiteti për PShS, AAC ka organizuar edhe takime me Komitetin dhe të gjitha institucionet tjera relevante në vendin tonë, me qëllim të koordinimit dhe bashkërendimit të veprimeve ndërinsitucionale bashkë me operatorët për zbatimin e udhëzimeve që dalin nga Agjencia Evropiane për Sigurinë e Aviacionit Civil (EASA) dhe Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO) për parandalimin e përhapjes së COVID-19 edhe kur të hapen kufijtë ajror dhe të fillojnë operimet e rregullta në ANP “Adem Jashari”.

Takimi i parë u mbajt më 09 qershor 2020 me ftesë të U.d Drejtorit të Përgjithshëm z. Islami ku janë ftuar përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Dogana e Kosovës, Policia e Kosovës, Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave, operatorët që ofrojnë shërbime aeronautike në vendin tonë, Agjencia për shërbime të navigacionit ajror dhe operatori i Aeroportit

ndërkombëtar të Prishtinës LKIA “Adem Jashari”. Në këtë takim ishte i pranishëm edhe Ministri i Infrastrukturës z. Arban Abrashi. Ministri Abrashi i dha mbështetje këtij grupi dhe vlerësoi punën e përbashkët për hapjen sa më të shpejtë të kufijve ajrorë dhe fluturimeve kaq të mirëpritura sidomos për mërgatën tonë.

Takimi i dytë koordinues në këtë format u mbajt më 25 qershor 2020, me ftesë të Drejtorit të përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil, z. Ejupi. Qëllimi i takimit ishte koordinimi dhe bashkërendimi i veprimeve ndërinstytucionale bashkë me operatorët për rihapjen e aeroportit pas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës që hapja e aeroportit të bëhet më 28 qershor 2020. Në takim u prezantua plani i veprimit për hapat që duhet ndjekur secili institucion. Më pas ky plan është përcjell tek të gjitha institucionet me email.

- **Veprimtaria e Këshillit të Sigurisë në AAC**

Këshilli i Sigurisë në AAC ka mbajtur takime të shumta për shqyrtimin dhe trajtimin e çështjeve të ndryshme të sigurisë. Këshilli jep rekomandim për Drejtorin e përgjithshëm në vendime, ndryshime apo zgjidhje të menjëhershme në çështje të sigurisë. Nga viti 2015 kur edhe është emëruar, në AAC vepron Këshilli i Sigurisë me qëllim të shqyrtimit dhe zgjidhjes së çështjeve të sigurisë së aviacionit. Në vitin 2020 ka skaduar edhe mandati 5 vjeçar i Këshillit të sigurisë në AAC, me ç’rast DP ka lëshuar Vendim për mandat dhe përbërje të re të Këshillit më 20 tetor 2020.

Gjatë vitit 2020 Këshilli ka arritur që:

- Të analizojë regjistrin e shkaktarëve të rrezikut dhe të identifikojë nevojat për formulimin e tij (*Hazard Log*);
- Të bëjë matjet e rreziqeve që ndërlidhen me menaxhimin e operimeve me situatën pandemike me COVID 19 brenda dhe jashtë AAC-së ;
- Të analizojë raportin nga KHAIA për aksidentin me paraglaj më 07.09.2019
- Të analizojë aksidentin me paraglajd të datës 19.07.2020
- Të shqyrtojë ndodhitë e raportuara me status të hapur për tu mbyllur pas rekomandimeve

- **Zhvillime në menaxhimin e sigurisë së aviacionit**

Menaxhimi i rreziqeve nga COVID-19 për funksionim të AAC-së

Para se të fillohet me operimeve në Aeroportin ndërkombëtar “Adem Jashari” pasi që ato ishin limituar vetëm në operime të veçanta për shkak të situatës me pandeminë, gjatë muajit maj 2020, në AAC përmes takimeve të shumta të

punës është kryer identifikimi i rreziqeve që ndërlidhen me funksionimin e papenguar të AAC-së për shkak të përhapjes së virusit, dhe është gjetur mënyra e menaxhimit të këtyre rreziqeve. Si rezultat, AAC ka hartuar edhe dokumentin me veprime për menaxhim të rreziqeve për ta përcjellur atë deri në ndryshim të situatës pandemike dhe në funksionalizim të plotë të operimeve komerciale në aeroport.

Dokumentet e analizës GAP (shq.: *analiza e hendeqeve*) për PSHS-në janë përditësuar për të dhënë informatat e fundit në përmbushjen e detyrave drejt realizimit të PSHS-së. Për shkak se Kosova nuk është anëtare e Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil AAC nuk ka qasje në përditësimet e vazhdueshme të dokumenteve që bën kjo organizatë. Dokumenti i analizës GAP është përditësuar së fundmi dhe qasjen në këtë dokument AAC e ka siguruar përmes shteteve tjera, për ta adaptuar dhe plotësuar më pas për nevojat e vendit tonë.

8.5 ÇËSHTJET E AVIACIONIT TË NDËRLIDHURA ME INTEGRIMIN EVROPIAN

a) Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së

AAC-ja ka dorëzuar inputin për Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) i cili është vendosur në Planin Kombëtar. Pas kërkesës nga MIE për rishikim të PKZMSA-së, më 2 korrik AAC-ja ka dorëzuar në MIE një plan të rishikuar. Për vitin 2020, AAC-ja ka planifikuar transponimin e 7 rregulloreve të BE-së, respektivisht transponimin e 1 rregulloreje në K3 dhe 6 të tjerave në K4.

Është arritur të transponohen 5 prej 7 masave të planifikuara. Dy nga masat e parealizuara janë bartur në vitin 2021 dhe janë shumë afër realizimit (shih tabelën më poshtë):

Raporti i zbatimit është si vijon:

	Masa e planifikuar	Planifikimi	Përditësimi i progresit
1	Rregullore mbi rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe krijimin e një Agjencie Evropiane të Sigurisë së Aviacionit (akt nënligjor i ri)	K4	Është nxjerrë Rregullorja (AAC) nr. 05/2020
2	Rregullore për ndryshimin e Rregullores (AAC) 12/2015, sa i përket listës së transportuesve ajrorë,	K3	Është nxjerrë Rregullorja (AAC) nr.

	të cilët janë të ndaluar të operojnë ose janë subjekt i kufizimeve operacionale brenda Bashkimit (amandamentim)		03/2020
3	Rregullore që përcakton rregulla të hollësishme për operimin e veloreve në përputhje me Rregulloren (AAC) xx/2020 (akt nënligjor i ri)	K4	Është nxjerrë Rregullorja (AAC) nr. 08/2020
4	Rregullore për përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror / shërbimeve të navigimit ajror dhe funksioneve të tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre (akt nënligjor i ri)	K4	Është nxjerrë Rregullorja (AAC) nr. 09/2020
5	Rregullore për ndryshimin e Rregullores (AAC) Nr. 1/2019 në lidhje me kërkesat e operimeve ajrore për velore dhe çantat elektronike të fluturimit (amandamentim)	K4	Del në konsultim publik në janar 2021
6	Rregullore për përcaktimin e kërkesave të përdorimit të hapësirës ajrore dhe procedurave operative në lidhje me navigimin me bazë performancën (akt nënligjor i ri)	K4	Është nxjerrë Rregullorja (AAC) nr. 02/2020
7	Rregullore në lidhje me prezantimin e specifikave të reja shtesë të vlefshmërisë ajrore (amandamentim)	K4	Del në konsultim publik në janar 2021

b) Raporti i Vendit për Kosovën i Komisionit Evropian

Më 6 tetor 2020 është publikuar Raporti i KE-së për Kosovën 2020. Sa i përket aviacionit, raporti thotë:

Sa i përket transportit ajror, Kosova është pjesë e zonës së përbashkët evropiane të aviacionit dhe e përfshirë në aranzhimet e qiellit të vetëm evropian. Sektori vazhdon të përballët me sfida që dalin nga fakti që Kosova nuk është anëtare e disa organizatave ndërkombëtare të aviacionit civil. Mungesa e të ardhurave nga menaxhimi i hapësirës së lartë ajrore vazhdon të kufizojë aftësinë e saj për të investuar në trajnime dhe zhvillimin e infrastrukturës. Agjencia e Shërbimit të Navigacionit Ajror dhe Autoriteti i Aviacionit Civil përballen me vështirësi financimi dhe mungesë të personelit.

Përmirësimet e infrastrukturës në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës janë duke vazhduar, duke përfshirë zgjatjen e pistës dhe azhurnimin e sistemit instrumental të aterrimit.

Lidhur me sigurinë e aviacionit, Kosova është e përkushtuar të përmbushë kërkesat e BE-së, standardet ndërkombëtare dhe praktikatat e rekomanduara për të parandaluar "Aktet e Ndërhijes së Paligjshme".

c) Takimi i Nën-komitetit të MSA-së

Më 11 shkurt 2020, AAC-ja ka dhënë kontributin e saj me shkrim në raportin që MIE i ka dërguar KE-së në parapërgatitje të takimit të Nën-Komitetit të MSA-së për Mjedis, Transport, Energji dhe Zhvillim Rajonal të mbajtur më 19 mars 2020 online.

AAC-ja ka raportuar me shkrim në përgatitje të takimit për dy çështjet e mbetura nga Faza I e Marrëveshjes HPEA, transponimi i Direktivës për kohën e punës dhe disa çështje që afektojnë të drejtat e udhëtarëve në Ligjin e Aviacionit Civil. AAC-ja poashtu ka raportuar për gjendjen e zbatimit të legjislacionit nga Faza II e Marrëveshjes, e cila përfshin një numër të madh të rregulloreve të transponuara si dhe planifikimet për vitin 2020.

Te çështjet tjera AAC-ja ka raportuar se Drejtori i përgjithshëm ka nënshkruar në Berlin Letër Qëllimin për fluturime mes Prishtinës dhe Beogradit dhe për nismën që Autoritetet Islandeze të nënshkruajnë marrëveshje me AAC-në e Kosovës në lidhje me normalizimin e hapësirës së ultë ajrore të Kosovës.

Më 19 mars 2020 u mbajt takimi i Nënkomitetit të MSA-së për transport online në të cilin AAC-ja nuk morri pjesë si rezultat i masave që kanë rrjedhur nga COVID-19.

Konkluzionet e takimit janë pranuar nga AAC-ja më 31 mars 2020. Janë dy konkluzione që i përkasin AAC-së për të cilat duhet të raportojë në të ardhmen:

- 1) Të përfundojë transponimin e legjislacionit të mbetur të përmendur në raportin e vlerësimit të zbatimit të Marrëveshjes HPEA (të kryer në shkurt 2020);
- 2) Të sigurohet se riorganizimi dhe reforma administrative në Autoritetin e Aviacionit Civil merr parasysh si obligimet që dalin nga agjenda e reformës së administratës publike ashtu edhe kërkesat dhe rrethanat specifike të sektorit të aviacionit civil.

Pas kërkesës nga MIE, AAC ka raportuar më 30 korrik 2020 lidhur me progresin e dy konkluzioneve të dala nga takimi i Nën komitetit të MSA për transport të përshkruara më lartë. AAC-ja ka raportuar se riorganizimi i cili ka filluar në korrik 2019 bazuar në rregulloren e re të brendshme, është anuluar në maj të vitit 2020 dhe

AAC-ja tani po funksionon bazuar në strukturën organizative që ishte në fuqi në periudhën 2011-2019.

d) Takimi i Komitetit dhe Këshillit të MSA-së

Më 23 shtator 2020, AAC-ja ka raportuar me shkrim në MIE, përmes MI-së, lidhur me progresin e arritur në mes të dy takimeve të Komitetit të Stabilizim-Asocimit. Raporti ka përfshirë aktivitetet të cilat kanë të bëjnë me MSA gjegjësisht PKZMSA-në në përgatitje për Takimin e IV të Komitetit të Stabilizim-Asocimit BE-Kosovë i cili u mbajt më 15 tetor 2020.

AAC-ja ka raportuar në lidhje me zbatimin e obligimeve të Fazës I të HPEA-së dhe të gjitha zhvillimet tjera legislative që nga raporti i kaluar në shtator 2019.

8.6 BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

AAC-ja ka bashkëpunuar ngusht me institucionet tjera përgjegjëse për aviacionin civil në Republikën e Kosovës në mënyrë që i tërë sistemi rregullator dhe mbikëqyrës i shtetit të funksionojë i koordinuar dhe në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Poashtu, sipas nevojës, është ofruar përkrahje profesionale në fushën e aviacionit civil për institucionet tjera të shtetit.

- ***Bashkëpunimi me Zyrën e BE-së në Kosovë***

Më 22 janar 2020, Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së, priti në një vizitë zyrtare zëvendës-shefin e Zyrës së BE-së në Kosovë, z. Riccardo Serri, së bashku me bashkëpunëtorët e tij. Z. Serri u interesua më për së afërmi për zhvillimet e aviacionit civil në Republikën e Kosovës në përgjithësi si dhe për procesin e normalizimit të hapësirës së ulët ajrore në vendin tonë. Në të njëjtën kohë z. Serri përgëzoj Drejtorin e Përgjithshëm për punën që kishte bërë rreth zhvillimeve të fundit sa i përket nënshkrimit të letrës së qëllimit për realizimin e fluturimeve në mes të Prishtinës dhe Beogradit.

Drejtori i Përgjithshëm informoi zyrtarët e BE-së, se Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës është duke punuar në mënyrë intensive së bashku me NATO-n dhe KFOR-in, në kuadër të takimeve të BANM (Balkans Airspace Normalization Meeting) për normalizimin e hapësirës së ulët ajrore dhe hapjen sa më të shpejtë të korridoreve të reja ajrore me të gjitha shtetet fqinje.

- ***Bashkëpunimi me J3 Air –KFOR-in***

Më 24 korrik 2020, Drejtori i përgjithshëm së bashku me bashkëpunëtorë ka takuar përfaqësuesit e KFOR-it, respektivisht udhëheqësin e njësisë J3 Air Nënkolonelin Angelo Santoro dhe njësisë LEGAD Nënkolonelin Antonio Malerba. Z. Ejupi ka treguar për aksidentin me paraglajd. Palët kanë premtuar t'i ndajnë informacionet për zhvillimet që ndodhin në fushën e aviacionit në Kosovë. Z. Kushtrim Musa, Drejtor i Sigurisë së Fluturimeve, i ka shpjeguar Nënkolonelit Santoro i cili ka arritur rishtas në Kosovë ndarjet e përgjegjësisë në AAC.

Përfaqësuesit e KFOR-it kanë kërkuar të punohet në përgatitje për takimin e BANM ku adresohet normalizimi i hapësirës ajrore të Kosovës, dhe kanë shprehur entuziazëm për hapjen e korridoreve të reja ajrore me vendet fqinje. Nënkoloneli Malerba ka shprehur kënaqësi që projektet e filluara më herët kanë avancuar.

Më datë 21 tetor 2020, Ministri Abrashi së bashku me zyrtarë të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Drejtorin e Përgjithshëm i AAC si dhe Zv/Drejtorin e Përgjithshëm u takuan me LTC. Malerba J3 Air-KFOR, për te diskutuar rreth hapjes së korridorit ajror në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. Siç dihet ASHNA dhe Albcontrol sh.a. kanë nënshkruar Marrëveshje për hapjen e korridorit në mes të Kosovës dhe Shqipërisë në muajin qershor.

Ministri Abrashi falënderoi KFOR-in për mbështetjen e vazhdueshme, dhe shprehu gatishmërinë që edhe në të ardhmen të vazhdojë bashkëpunimi i ndërsjellë.

Më datë 10 nëntor 2020, Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së së bashku me Zv/Drejtorin e Përgjithshëm dhe me bashkëpunëtorë priten në takim lamtumirës LTC. Malerba nga njësi J3-Air i KFOR-it. Në këtë takim z. Ejupi falënderoj LTC Malerba për kontributin e tij të pa rezervë për çështjet e ndërlidhura me aviacionin civil. LTC. Malerba shprehu kënaqësinë për shërbimin e tij në Kosovë dhe vlerësoi pozitivisht të arriturat në aviacion gjatë kësaj periudhe. Me këtë rast z. Ejupi i dëshiroi mirëseardhje edhe zëvendësit të tij LTC. Nappi duke shpresuar në vazhdimin e raporteve të shkëlqyeshme në mes të AAC-së dhe KFOR-it.

- ***Bashkëpunimi me NJQ të PPP***

Më dt. 12 qershor 2020, u.d Drejtori i përgjithshëm i ka dërguar një shkresë Departamentit Qendror PPP përmes së cilës i kërkohej sqarim nëse interpretimi i dt. 12 maj 2019 përfshin edhe furnizimin me karburant si njëra ndër kategoritë e shërbimeve në tokë të përcaktuara në aneksin e Rregullores.

Më 13 korrik 2020, Drejtori i Përgjithshëm i AAC-se z. Ejupi së bashku me bashkëpunëtorë priti në takim Drejtorin e Njesisë Qendrore të Departamentit PPP në kuadër të Ministrisë së Financave, Z. Rama.

Në përpjekjen e AAC për implementimin e Rregullores 04/2011 lidhur me ofruesit e shërbimeve në tokë, Drejtori i AAC z. Ejupi për të sqaruar situatën lidhur me hapjen e tregut është takuar me palët e interesit si dhe ka drejtuar disa shkresa tek komitetit për partneritet publiko privat (KPPP) si grup ndërministror, ku ka kërkuar nga që PPP të përkrah procesin e hapjes së tregut duke qenë se është në interes publik por edhe të vet Aeroportit, poashtu është kërkuar shpjegime për tarifën që organi menaxhues i Aeroporti i aplikon ndaj operatorit të vetëm “Ex-Fis” tarifa që nuk është në përputhje as me kontratën e PPP por as nuk janë tarifa të cilat janë aprovuar nga AAC sipas rregullores.

- ***Bashkëpunimi me Federatën Aeronautike të Kosovës***

Më 21 korrik, 2020, Drejtori i përgjithshëm i AAC-së z. Bujar Ejupi së bashku me bashkëpunëtorë ka takuar përfaqësuesit e Federatës Aeronautike të Kosovës (FAK). Z. Ejupi u ka shprehur ngushëllime përfaqësuesve të Federatës për humbjen e shokut të tyre F.G. gjatë aksidentit aeronautik i cili ka ndodhur ditën e diel pas përplasjes me një paraglajdistë tjetër gjatë aterritimit.

Përfaqësuesit e FAK kanë shpjeguar rrethanat e aksidentit dhe kualifikimet e pilotit i cili ishte në proces të licencimit.

Z. Ejupi ka theksuar se siguria e të gjitha fluturimeve është njëjtë me rëndësi për AAC-në. Përfaqësuesit e Federatës kanë kërkuar rritjen e bashkëpunimit me AAC-në. Pastaj palët kanë diskutuar disa përmirësime të mundshme për rregullimin e fushës dhe sqarimet e nevojshme të rregullores së aplikueshme.

Drejtori Ejupi ka marrë angazhim që të shtohet numri i zonave të para aprovuara në mënyrë që fluturimet me paraglajd të kryhen në këto zona.

- ***Bashkëpunimi me palë të interesit të aviacionit***

Me datë 11 nëntor 2020, Drejtori i Përgjithshëm, dhe Drejtori i Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve z. Kushtrim Musa pritën një delegacion nga klubi i fluturimit “Aviation Enthusiasts Society” (AES) të përfaqësuar nga z. Dukagjin Manxhuka.

Vizitorët u interesuan për fushat e fluturimit në Kosovë, ku mund ta ushtrojnë veprimtarinë e tyre të fluturimit. U përmend çështja e pronësisë së fushave ekzistuese si pengesë për të filluar aktivitetin. Vizitorët shpalosin rolin që aviacioni ka në ekonomi.

Çështje tjetër me interes ishte aprovimi i një shkolle fluturimi në Kosovë. Z. Musa tregoi së AAC-ja është e gatshme për një proces të tillë dhe pastaj shpjegoi procesin për mysafirët e interesuar. U diskutuan edhe implikimet e licencave dhe certifikatave aeronautike të lëshuara nga Kosova për faktin që Republika e Kosovës nuk është palë e Marrëveshjes së Çikagos. Më tej, mysafirët shprehën interesim edhe për rregullimin e hapësirës ajrore dhe për përfshirjen e aeronautikës si lëndë mësimore.

Palët u pajtuan që të vazhdojnë bashkëpunimin e ndërsjellë.

- *Bashkëpunimi me Zyrtarë të Ministrisë së Punëve të Brendshme*

Me datë 7 dhjetor 2020, Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së së bashku Zv/Drejtorin e Përgjithshëm dhe me Drejtorin e Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve priti në një takim pune z. Mensur Hoti, Drejtor i Departamentit për Siguri Publike dhe z. Kastriot Gashi, Udhëheqës i Divizionit për Siguri të Aviacionit Civil nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës. Në këtë takim dypalësh u diskutuan çështjet e përbashkëta të cilat i ndërlidhin këto dy institucione në fushën e aviacionit civil. Palët u dakorduan që bashkëpunimin e tyre të deritanishëm të avancojnë edhe më tutje përmes shkëmbimit të ekspertizës dhe punëtorive të përbashkëta të të dyja institucioneve.

- *Bashkëpunimi me institucione përgjegjëse për Integrim Evropian*

Më 23 shtator 2020, AAC-ja ka raportuar me shkrim në ZKM, përmes MI-së, lidhur me progresin e arritur në mes të dy takimeve të Komitetit të Stabilizim-Asocimit. Raporti ka përfshirë aktivitetet të cilat kanë të bëjnë me MSA gjegjësisht PKZMSA-në në përgatitje për Takimin e IV të Komitetit të Stabilizim-Asocimit BE-Kosovë i cili u mbajt më 15 tetor 2020.

Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA) për periudhën 2020-2024 është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 19 maj 2020 por më 15 qershor është tërhequr për rishikim për shkak të vonesave si pasojë e pandemisë dhe zhvillimeve të tjera. Plani i rishikuar është miratuar më 14 korrik 2020.

Më 11 nëntor AAC-ja ka dhënë inputin e saj në ZKM për Planin PKZMSA 2021 në të cilin kanë kontribuar me inpute gjitha departamentet teknike dhe është aprovuar nga Drejtori i Përgjithshëm. AAC-ja ka planifikuar që gjatë vitit 2021 t'i transponoj 5 rregullore të BE-së që përfshinë fushat e sigurisë së fluturimeve, shërbimeve të navigacionit ajror dhe aerodomeve. Përmes raportit narrativ të dorëzuar më 13 nëntor AAC-ja ka dhënë gjendjen aktuale të përafrimit të legjislacionit dhe objektivat afatmesme.

- *Raportim pranë Komisionit Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Infrastrukturë dhe Mjedis*

Më datë 15 maj 2020, me kërkesë të Komisionit Parlamentar për BPZHIM, U.d Drejtori i përgjithshëm i shoqëruar nga anëtari i Bordit z. Gaxherri ka raportuar pranë Komisionit Parlamentar për raportin vjetor të punës së AAC-së për vitin 2019. Meqenëse raporti vjetor nuk është miratuar unanimisht nga Bordi Mbikëqyrës i AAC-së, atëherë Komisioni nuk e trajtoj raportin vjetor të AAC-së për vitin 2019.

Më datë 30 nëntor 2020, është dorëzuar për herë të parë plani i performancës së AAC-së për vitin 2021 në Komisionin Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Infrastrukturë dhe Mjedis sipas kërkesës së tyre.

Më datë 15 dhjetor 2020, me ftesë të Komisionit Drejtori i Përgjithshëm, se bashku me Zv/ Drejtorin e përgjithshëm si dhe Këshilltaren ligjore në AAC, ka raportuar në Komision për planin e performancës të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2021.

- *Raportim pranë Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Financa*

Më 24 qershor 2020, me kërkesë të Komisionit Parlamentar për buxhet dhe financa, Zv/Drejtori i përgjithshëm, dhe Zyrtarja Kryesore Financiare kanë raportuar pranë Komisionit Parlamentar për Buxhet dhe Financa për Pasqyrat vjetore financiare për vitin 2019.

8.7 AKTIVITETI I AAC-së NË RRAFSHIN NDËRKOMBËTAR

AAC-ja Republika e Kosovës ende nuk është anëtare e barabartë e familjes ndërkombëtare të kombeve në fushën e aviacionit civil. Ne kemi shfrytëzuar çdo mundësi ta prezantojmë punën e autoriteteve tona dhe të thellojmë bashkëpunimin me AAC-të e shteteve tjera. Sidoqoftë, për shkak se vendi ynë ende nuk ka pasur mundësi të hyjë në marrëdhënie kontraktuale me BE-në në fushën e aviacionit civil, ende ka pengesa serioze në trajtimin tonë si partner plotësisht i barabartë me AAC-të tjera të rajonit.

8.8 Bashkëpunimi dypalësh në fushën e aviacionit civil

AAC-ja i kushton rëndësi të madhe bashkëpunimit me autoritetet homologe të rajonit, duke marrë parasysh se të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor janë duke kaluar nëpër të njëjtën sfidë – atë të harmonizimit të legjislacionit, rregullave e standardeve në aviacionin civil me ato të BE-së. Për të formalizuar këtë bashkëpunim,

janë nënshkruar një numër i marrëveshjeve për bashkëpunim teknik që nga themelimi i AAC-së në vitin 2009.

Bashkëpunimi dypalësh me Shqipërinë

AAC ka vazhduar edhe më tutje bashkëpunimin ndërshtetëror midis Autoriteteve të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës dhe AAC-ve të rajonit. Gjatë këtij viti, bashkëpunimi ndërshtetëror midis Autoriteteve të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës, dhe Republikës së Shqipërisë kanë bashkëpunuar ngushtë në realizimin e synimit të përbashkët: shkëmbimi i përvojave për një aviacion më të sigurtë.

Në kuadër të marrëveshjes dypalëshe, inspektorët e aerodromeve kanë pranuar ftesë zyrtare për tu bërë pjesë auditimit gjithëpërfshirës në kuadër të procesit të konvertimit të certifikatës me Rregulloren e EASA 139/2014, për Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës “Nënë Tereza”. Në kordinim të drejtorave të dy AAC-ve, AAC e Kosovës ka dërguar në Tiranë dy inspektorë të aerodromeve për të mbështetur kolegët e AAC të Shqipërisë për këtë proces.

a) Takimi i Berlinit për transportin ajror në mes Prishtinës dhe Beogradit

Më 20 janar 2020, me ftesë të Ambasadorit Richard Grenell, Emisarit Special të Presidentit Trump për dialogun Kosovë-Serbi, ish Drejtori i Përgjithshëm i AAC-së, me autorizim të Ministrit të Infrastrukturës dhe Transportit, mori pjesë në takimin e mbajtur në Berlin me qëllim të hapjes së linjës ajrore në mes të Prishtinës dhe Beogradit, linjë kjo e cila do të operohet nga kompania gjermane Lufthansa, me degën e saj Euroëings.

Takimi i Berlinit rezultoi me nënshkrim të dy Letrave të Qëllimit të nënshkruara nga kompania ajrore gjermane Lufthansa, njërën me palën kosovare dhe tjetrën me atë serbe, në prani të zyrtarëve të lartë të NATO-s. Përmes këtyre letrave të qëllimit, ofrohet përkrahje për kompaninë gjermane me qëllim të realizimit të fluturimit direkt Prishtinë-Beograd dhe anasjelltas, duke nënkuptuar edhe bashkëpunimin në mes të autoriteteve përkatëse të njësive të kontrollit të trafikut ajror në Aeroportin e Prishtinës dhe Beogradit.

b) Nënshkrimi i MoU midis AAC dhe ICETRA

Më 19 qershor 2020 është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit me Autoritetin islandez të transportit (ICETRA) që mbulon aspekte të aktiviteteve të përbashkëta të mbikëqyrjes sipas kërkesave të ICAO-s dhe EASA-s me ICETRA-n. Pëlqimi për nënshkrim është dhënë nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës siç parashihet me Ligjin për marrëveshje ndërkombëtare, MoU është nënshkruar më 19 qershor nga u.d. DP dhe pala islandeze.

c) Koordinimi i asistencës teknike në fushën e aviacionit

AAC është pikë kontakti për një numër projektsh të asistencës teknike në aviacion që i ofrohen vendit tonë nga BE-ja në kuadër të instrumenteve të disponueshme për shtetet që synojnë anëtarësim në BE. Gjatë vitit 2020, vëllim më i madh i asistencës teknike ka qenë nga fondet e BE-së përmes Projektit EASA IPA 5 siç është përshkruar më poshtë.

Projekti EASA IPA 5

EASA IPA 5 është një projekt i financuar nga KE-ja dhe i implementuar nga EASA. Ky projekt është vazhdim i projekteve të mëparshme IPA. Implementimi i IPA 5 ka filluar nga data 01 shkurt 2020 dhe do të zgjasë 36 muaj. Gjatë vitit 2020, AAC-ja ka përfituar nga 4 misione teknike si vijon:

- Prej 20 deri më 22 mars 2020, Punëtori mbi menaxhimin e ndryshimeve madhore në infrastrukturën e aeroportit;
- Prej 1 deri më 2 tetor 2020, Punëtori mbi zbatimin e formatit global të raportimit për aerodrome;
- Prej 17 deri më 19 tetor 2020, Punëtori mbi menaxhimin e ndryshimeve dhe vlerësimin e ndryshimeve të sistemeve funksionale në ASHNA;
- Prej 12 deri më 16 tetor 2020, Punëtori mbi përzgjedhjen e ofruesve të shërbimeve në tokë dhe caktimin e kriterëve;

Nga këto aktivitete kanë përfituar inspektorët e AAC-së dhe zyrtarë të operatorit të aeroportit si dhe të ASHNA-s. Punëtoritë janë ndjekur në mënyrë virtuale dhe do të vazhdojnë kështu gjatë vitit 2021 deri në përmirësim të situatës epidemiologjike.

8.9 AKTIVITETI RREGULLATOR/MBIKËQYRËS

Funksioni bazë i AAC-së është mbikëqyrja dhe rregullimi i aktiviteteve të aviacionit civil në Republikën e Kosovës me qëllim të garantimit të operimeve të sigurt në përputhje me standardet në fuqi. Kjo arrihet përmes inspektimit, auditimit, licencimit dhe certifikimit. AAC ka një personel profesional dhe kompetent për rregullimin e aviacionit civil në vend. Aktiviteti rregullator i AAC-së përfshin sigurinë e aviacionit civil në përgjithësi dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror në Republikën e Kosovës. Në vazhdim do të jepet një pasqyrë e përmbledhur e aktiviteteve rregullatore dhe mbikëqyrëse të AAC-së në fushën e sigurisë së aviacionit, të ndara në këto kategori: siguria e fluturimeve, certifikimi e licencimi, shërbimet e navigacionit ajror dhe aerodromet. Gjithashtu, do të jepet një pasqyrë e përmbledhur edhe për aktivitetet e rregullimit ekonomik në aeroport, në ofruesin e shërbimeve të navigacionit ajror dhe në ofruesit e shërbimeve për aeroplanënë tokë.

a) Siguria e fluturimeve, certifikimi dhe licencimi

- *Inspektimet e mjeteve të huaja ajrore në platformë*

Në pajtim me nenin 50 të Ligjit për Aviacionin Civil, inspektorët e Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve kanë kryer katërmëdhjetë (14) inspektime të sigurisë së aeroplanëve të operatorëve të huaj (SAFA - Vlerësimi i Sigurisë së Mjeteve të Huaja Ajrore), të cilët operojnë në ANP “Adem Jashari”.

Ky numër i inspektimeve të sigurisë së aeroplanëve të operatorëve të huaj paraqet një rënie afërsisht 55% nga viti paraprak dhe është pasojë e situatës së krijuar me pandeminë globale të virusit Corona (COVID-19) dhe shpalljes së gjendjes emergjente për shëndetin publik nga Qeveria e Republikës së Kosovës në parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse.

Janë inspektuar aeroplanët e këtyre kompanive ajrore: Chair Airlines (GSW), Trade Air (TDR), Avion Express (NVD), Air Mediterranean (MAR), Tui Airlines Belgium (JAF), Avion Express (NVD), Helvetic (OAW), Air Alliance Express (AYY), Eizz Air (WZZ), Sëiss Air Ambulance (SAZ), Edelëeiss Air AG (EDW), EasyJet Sëitserland SA (EJS), Sëiss International Air Lines (SWR).

Gjatë këtyre inspektimeve është konstatuar një gjetje e kategorisë 2. Për këtë gjetje janë informuar kompania ajrore (WZZ) dhe autoriteti kombëtar përkatës i operatorit (NAA).



- **Auditimet e operatorëve të aviacionit**

Më datë 04 dhjetor 2020 Inspektorët e Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve kanë audituar organizatën trajnuese për paraglajd “Akademia e Aviacionit”. Qëllimi i këtij auditimi ishte vlerësimi i pajtueshmërisë së vazhdueshme me Rregulloren (AAC) Nr. 01/2012 dhe aprovimin e tyre në cilësinë e organizatës trajnuese për paraglajd dhe deltaplan. Raporti i auditimit përmbledh disa gjetje të cilat duhet të përmirësohen brenda afateve të caktuara kohore të përcaktuara nga Inspektorët e Departamentit të Sigurisë së Fluturimeve.

Më datë 19 gusht 2020 është realizuar auditimi i Qendrës Aero-Mjekësore (AeMC) në Gjakovë, sipas planit të aktiviteteve mbikëqyrëse të vitit 2020. Ky aktivitet ishte planifikuar të realizohej në maj, por për shkak të rrethanave të pandemisë është shtyrë. Raporti i Auditimit të Qendrës rezultoi me një gjetje, të cilën AeMC obligohet ta adresojë gjatë periudhës së vlefshmërisë së autorizimit të lëshuar nga AAC-ja.

Gjatë vitit 2020 në kuadër të mbikëqyrjes së zbatimit të masave për frenimin e përhapjes së COVID-19 në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”, janë realizuar gjithsejtë trembëdhjetë (13) inspekte ad-hoc, me qëllim të mbikëqyrjes së masave të ndërmarra, të frenimit të përhapjes së virusit COVID-19. Këto inspekte mbështeten në aktet ligjore duke u bazuar në dokumentet relevante të hartuara për këtë qëllim si p.sh. Urdhëresa Administrative e aprovuar nga AAC-ja më datë 30.korrik 2020, plani i veprimit i Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” për rinisjen e operimeve, sipas protokollit të shëndetit në aviacion dhe listave zbatuese për autoritetet kombëtare të aviacionit civil të hartuara nga Agjencia Evropiane e Sigurisë së Aviacionit (EASA), Qendra Evropiane për Preventivë dhe Kontrollë të Sëmundjeve (ECDC) dhe Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO).

- **Menaxhimi i sistemit të raportimit të ndodhive në aviacion (OR)**


Me qëllim të ngritjes së sigurisë së aviacionit, duke parandaluar aksidentet dhe incidentet, AAC-ja mbledh dhe analizon informacione të nevojshme të sigurisë së aviacionit civil përmes sistemit të saj të raportimit të ndodhive. Këto informacione i mundësojnë AAC-së dhe industrisë që të informohen për rreziqet e sigurisë me të cilat ballafaqohen, me qëllim të mbështetjes së spektrit të plotë të aktiviteteve në menaxhimin e sigurisë, duke përfshirë miratimin dhe zbatimin e veprimeve lehtësuese aty ku është e përshtatshme. Informacionet relevante të sigurisë raportohen, mbledhen, ruhen, mbrohen, shkëmbehen, shpërndahen dhe analizohen në përputhje me kërkesat e Rregullores së AAC-së nr. 09/2017 për raportimin, analizën dhe përcjelljen e ndodhive në aviacionin civil.

Gjatë vitit 2020 AAC-ja ka pranuar raportime për gjithsejtë 101 ndodhi në aviacionin civil, që paraqet një ulje të konsiderueshme krahasuar me numrin e ndodhive të raportuara gjatë viteve të fundit. Besohet se kjo ulje korrespondon me uljen e numrit të fluturimeve për dhe nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”, e cila vjen si rezultati i ndikimit të përhapjes së pandemisë COVID-19 në Kosovë dhe në botë, nga data 13 mars 2020, kur janë konfirmuar dy rastet e para të personave të infektuar me koronavirus në Kosovë.

Numri i përgjithshëm i ndodhive të raportuara në AAC, që nga viti 2006 deri në fund të vitit 2020 ka arritur në gjithsejtë 1619 ndodhi. Besohet se nuk ka ndonjë ndryshim të rëndësishëm në numrin e raportimeve të ndodhive krahasuar me numrin e fluturimeve dhe kjo tregon nivelin e vetëdijesimit të pjesëmarrësve në industrinë e

aviacionit dhe përkushtimin e tyre për të raportuar, si dhe mund të tregojë nivelin e kënaqshëm të sigurisë në aviacionin civil.

Ndodhitë e raportuara janë koduar në kategori të ndryshme sipas elementeve të aviacionit të përfshira në këto ndodhi dhe bashkë me kategoritë e ndodhive të dy viteve të mëparshme janë paraqitur në grafikun e mëposhtëm, i cili është bazuar në të dhënat e nxjerra nga baza e të dhënave e AAC-së në platformën softuerike ECCAIRS 5 (Qendra Koordinuese Evropiane për Sistemet e Raportimit të Aksidenteve dhe Incidenteve).



Kategorizimi i ndodhive të raportuara gjatë viteve 2018, 2019 dhe 2020 (kodimi i ndodhive sipas elementeve të aviacionit të përfshira në këto ndodhi)

Nga grafiku i mësipërm mund të vërehet se në krahasim me kategoritë e ndodhive të viteve 2018 dhe 2019, kategoritë e vitit 2020 të cilat kanë pësuar rënie dhe kanë ndikuar në uljen e numrit të përgjithshëm të ndodhive janë: ADRM (aerodromi, vetëm krahasuar me vitin 2019), ATM (menaxhimi i trafikut ajror/komunikimi, navigimi dhe vrojtimi), BIRD (goditja e shpendit), CTOL (përplasja me pengesën(at) gjatë ngritjes dhe aterimit), ICE (e lidhur me akullin), LOC-G (humbja e kontrollit - në tokë), MAC (Airprox/ alarmimi ACAS/ humbja e ndarjes/ (afër) përplasjes në ajër), RI-A (futja në pistë - e kafshës, e cila është zëvendësuar nga kategoria e krijuar rishtazi ËILD), RI-VAP (futja në pistë - e automjetit, mjetit ajror ose e personit), SCF-NP (dështimi ose mosfunksionimi i sistemit/komponentës [jo-motorike]), SCF-PP (dështimi ose mosfunksionimi i motorit/ëve), SEC (e lidhur me sigurimin, e cila përmban nënkategorinë e ndodhive të lidhura me sulmet me laser), ËILD (përplasja

me kafshët e egra, vetëm krahasuar me vitin 2019), ËSTRË (gradienti i shpejtësisë së erës ose bubullima) dhe OTHR (tjetër).


Nënkategoria e ndodhive të sulmeve me laser ka pësuar një rënie të madhe në krahasim me vitet e mëparshme, gjë që është shumë e mirëpritur pasi që shndritja e rrezeve laserike drejt mjeteve ajrore në fluturim paraqet pengesë të madhe për pilotët dhe mund t'i verbojë ata gjatë fazave kritike të fluturimit, siç janë ngritja dhe aterrimi, e që si rrjedhojë kjo paraqet rrezik serioz për sigurinë e udhëtarëve dhe ekuipazheve, si dhe të njerëzve që jetojnë në afërsi të aeroporteve. Këto sulme përbëjnë vepra penale dhe kryhen qëllimisht nga persona të papërgjegjshëm.

Ndërsa kategoritë të cilat kanë pësuar rritje janë vetëm dy kategoritë në vijim: AMAN (manovrimi i befasishëm, vetëm krahasuar me vitin 2019) dhe NAV (gabimi në navigacion).

Kategoria e mbetur RAMP (trajtimi në tokë) ka shënuar një vlerë mesatare në krahasim me dy vitet e mëparshme.

Për sqarim, duhet të theksohet që në realitet janë raportuar dhe proceduar 101 ndodhi, por se tri nga këto ndodhi janë koduar në nga dy kategori dhe për këtë arsye numri i përgjithshëm i ndodhive të koduara në grafikun e mësipërm rezulton të jetë 104.

Po ashtu, ndodhitë e raportuara janë klasifikuar në klasa të ndryshme bazuar në ashpërsinë e ndikimit të tyre në operimet e sigurta të mjeteve ajrore dhe në njerëzit në bordin e tyre. Këto klasa, së bashku me klasat e ndodhive të katër viteve të mëparshme janë paraqitur në grafikun e mëposhtëm.



Numri i përgjithshëm i ndodhive të raportuara gjatë viteve 2016-2020 dhe klasifikimi i tyre sipas ashpërsisë

Sic mund të shihet në grafikun e mësipërm, nga 101 ndodhitë e pranuar nga AAC-ja gjatë vitit 2020, 48 ndodhi janë klasifikuar si “Ndodhi pa ndikim në siguri”, 50 ndodhi janë klasifikuar si “Incidente”, një ndodhi është klasifikuar si “Incident i konsiderueshëm”, një ndodhi është klasifikuar si “Incident serioz” dhe një ndodhi është klasifikuar si “Aksident”, dhe nuk ka pasur asnjë ndodhi të klasifikuar si “Incidente të mëdha”. Po ashtu, mund të vërehet se numri i “Ndodhive pa ndikim në siguri” në përqindje ka qenë 47.5% e numrit të përgjithshëm të ndodhive, që paraqet përqindje të përafërt me përqindjen e ndodhive të kësaj klase në vitin 2019 kur përqindja ka qenë 47%, por paraqet përqindje më të vogël në krahasim me vitet e mëparshme, kur përqindja në vitin 2018 ka qenë afër 76%, 66% në vitin 2017 dhe 70% në vitin 2016.

Në numrin prej 50 ndodhive të klasës “Incident” kanë marrë pjesë ndodhitë e koduara në kategoritë: ADRM (me 5 ndodhi), ATM (8 ndodhi), BIRD (20 ndodhi), NAV (6 ndodhi), RAMP (4 ndodhi), SCF-NP (4 ndodhi), SEC (2 ndodhi) dhe ËILD (me 1 ndodhi). Ndodhia e klasifikuar si “Incident i konsiderueshëm” është koduar në kategorinë ATM dhe në të njëjtën kategori është koduar edhe ndodhia e klasifikuar si “Incident serioz”. Ndërsa ndodhia e klasifikuar si “Aksident” është koduar në dy kategori, në kategoritë MAC dhe NAV.

- **Transporti i mallrave të rrezikshme përmes ajrit**

Në bazë të nenit 57 dhe 59 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil dhe nenit 8.1 të Rregullores nr. 8/2014 për kushtet dhe mënyrën e transportimit të mallrave të

rrezikshme përmes ajrit në Republikën e Kosovës, gjatë vitit 2020 janë lëshuar gjithsej njëqind e pesëmbëdhjetë (115) leje për transport të dërgesave me mallra të rrezikshme përmes ajrit, kompanive ajrore që operojnë në ANP “Adem Jashari”, të cilat paraprakisht janë të licencuara dhe posedojnë leje për import të armëve dhe municionit, të lëshuar nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), respektivisht materialeve radioaktive të lëshuar nga Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Bërthamore (AKMRrSB).

Nga ky numër i lejeve shtatëdhjetë e pesë (75) leje i janë lëshuar kompanisë ajrore “Turkish Airlines”, njëzeteshtatë (27) leje i janë lëshuar kompanisë ajrore “Pegasus Hava Tasimaciligi” dymbëdhjetë (12) leje i janë lëshuar kompanisë ajrore “Austrian Airlines”, dhe një (1) leje i është lëshuar kompanisë ajrore “Motor Sich”.

- ***Mbikëqyrja e aviacionit të përgjithshëm***

Gjatë vitit 2020 ka pasur një numër të konsiderueshëm të aktiviteteve të aviacionit të përgjithshëm në hapësirën e ulët ajrore të Republikës së Kosovës, ku përfshihen fluturimet sipas rregullave vizuale të fluturimit (VFR) me aeroplan dhe helikopter, pastaj operime me sisteme të mjeteve ajrore pa pilot (dron) dhe operime me balon me ajër të nxehtë, të cilat sipas bazës ligjore dhe procedurave përkatëse, kanë kaluar nëpër procesin e miratimit nga AAC-ja në koordinim me Policinë e Republikës së Kosovës si dhe njësitin ajror (J3-Air) të Forcës Ndërkombëtare në Kosovë (KFOR).

- **Fluturimet sipas rregullave vizuale të fluturimit (VFR)**

Gjatë vitit 2020 Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve ka lëshuar gjithsej katërmëdhjetë (14) aprovime për fluturim sipas rregullave vizuale të fluturimit (VFR). Nga to, shtatë (7) kanë qenë operime ajrore me aeroplan ndërsa shtatë (7) të tjera kanë qenë operime me balon. Të gjitha aprovimet janë lëshuar në koordinim njësitin ajror (J3Air) të Forcës Ndërkombëtare në Kosovë (KFOR).



(Foto 1 – Operimet me balon ne qytetin e Pejës)

- **Fluturime diplomatike**

Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve gjatë vitit 2020 ka proceduar kërkesat e dërguara nga Ministria e Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës tek njësi ajror

(J3Air) i Forcës Ndërkombëtare në Kosovë (KFOR) kërkesat për aprovimin e gjashtëdhjetë e shtatë (67) fluturimeve diplomatike. Të gjitha këto kërkesa janë aprovuar.

- **Aktivitetet me sisteme të mjeteve ajrore pa pilot (dron)**

Sipas Rregullores së AAC-së me nr. 01/2017 për Sistemet e mjeteve ajrore pa pilot, të gjithë operatorët e sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot apo siç njihen ndryshe me emërtimin “dron” janë të obliguar të regjistrojnë dronët e tyre në AAC-ë varësisht nga pesha e tyre.

Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve gjatë vitit 2020 ka regjistruar njëzet e shtatë (27) aplikues të rinj për operime me sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot (SAP). Numri total i operatorëve të dronëve të regjistruar në Republikën e Kosovës për vitet 2017-2020 ka arritur në njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë (166).

Po ashtu janë aprovuar edhe njëmbëdhjetë (11) operime të sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot të regjistruar në vende të tjera. Aprovimi i operatorëve të sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot, është bërë në koordinim të ngushtë me Policinë e Republikës së Kosovës si dhe njësitin ajror (J3-Air) të Forcës Ndërkombëtare në Kosovë (KFOR).

Në vazhden e aktiviteteve rregullatore të parapara me legjislacionin në fuqi gjatë tremujorit të katërt (K4) Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve organizoi për herë të parë provimin për testin e njohurive për sistemet e mjeteve ajrore pa pilot (dronëve) të Kategorisë 3. Këtij provimi i janë nënshtruar dy (2) kandidat të cilët kanë kaluar me sukses këtë test. Me këtë rast kandidatëve u janë ndarë certifikatat e parë për këtë kategori të sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot, duke ju uruar suksese dhe operime të sigurt në të ardhmen. Operimet e sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot (dronëve) janë të rregulluara me Rregulloren (AAC) Nr. 01/2017.



(Foto 2 – Ndarja e certifikatës për testin e njohurive për sistemet e mjeteve ajrore pa pilot)

- **Gjobat administrative**

Ne përputhje me Rregulloren (AAC) Nr. 02/2019 për gjobat dhe masat administrative të shqiptuara nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës, Departamenti i Sigurisë së Fluturimeve gjatë vitit 2020 ka shqiptuar dhjetë (10) Vendime për shqiptimin e gjobave ndaj personave përgjegjës dhe personave juridik (përfshirë këtu personat juridik që ushtrojnë veprimtari të transportit komercial ajror dhe personat juridik që ushtrojnë veprimtari të transportit komercial ndërkombëtar ajror), të cilët kanë kryer shkelje administrative në fushën e aviacionit civil në Republikën e Kosovës.

- **Mjekësia e aviacionit**

Gjatë vitit 2020 janë lëshuar gjithsejtë 18 (tetëmbëdhjetë) certifikata mjekësore për kontrollorët e trafikut ajror të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA) dhe 29 (njëzetënëntë) certifikata mjekësore të klasës LAPL për anëtarët e Federatës Aeronautike të Kosovës.

Më datë 14 shkurt 2020, pas shqyrtimit të kërkesës për vazhdimin e vlefshmërisë së certifikatës së AME, është konstatuar se kjo kërkesë plotëson kriteret ligjore për vazhdimin e certifikatës së AME, dhe rrjedhimisht Dr. Naim Bardiqit, i është aprovuar nga vazhdimi i certifikatës së lartpërmendur edhe për tre (3) vite të tjera, siç parashihet me legjislacionin në fuqi.

Më datë 16 mars 2020, pas njoftimit me vendimin e Qeverisë së Kosovës për shpalljen e gjendjes së Emergjencës Publike Shëndetësore, të gjitha ekzaminimet e planifikuara mjekësore për personelin e aviacionit civil në Qendrën e Mjekësisë së Aviacionit (AeMC) në Gjakovë, të parapara për muajin mars 2020, janë shtyrë deri në një vendim tjetër, i cili shfuqizon vendimin e qeverisë. Me këtë rast, palët e interesuara nga industria (*kontrollorët e ASHNA-s, anëtarët e Federatës Aeronautike të Kosovës dhe përfaqësuesja e kompanisë ajrore Euroëings*), si dhe Ekzaminuesit e Autorizuar Mjekësorë (AME) dhe Qendra e Mjekësisë së Aviacionit (AeMC) në Gjakovë, janë njoftuar për këtë zhvillim;

Më datë 10 qershor 2020, Dr. Driton Avdiu (AMA) ka marrë pjesë në takimin e Grupit Punues Ndërinstitucional të mbajtur me qëllim të koordinimit të veprimeve gjatë përgatitjes së hapave për rikthimin e operimeve ajrore komerciale civile në ANP "Adem Jashari" me ç'rast janë dhënë komente në lidhje me gjendjen e organizimit të ekzaminimeve Aero-mjekësore për kontrollorët e trafikut ajror të ASHNA-së, si rezultat i masave kufizuese me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit me COVID-19.

Më datë 12 qershor 2020 Qendra e Mjekësisë së Aviacionit (AeMC) në Gjakovë ka njoftuar zyrtarisht për rifillimin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore për publikun në kapacitete të plota.

Më datë 17 qershor 2020, me përkeqësimin e gjendjes epidemiologjike në vend, sipas rekomandimit të IKSHPK-së, drejtoria e ShSKUK-së vendosi përgjysmimin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore në sistemin publik, prandaj AeMC në Gjakovë njoftoi përsëri, konform këtij rekomandimi të ri, se do t'i zvogëlojë shërbimet e veta shëndetësore në masën prej 50%. Si rrjedhojë, u njoftua menjëherë ASHNA për pezullimin e sërishëm të ekzaminimeve aero-mjekësore për kontrollorët e trafikut ajror, të planifikuara për muajin qershor;

Më datë 24 shtator 2020 është njoftuar ASHNA për rifillimin e shërbimeve të AeMC në Gjakovë për kontrollorët e trafikut ajror (KTA).

Më datë 30 shtator 2020 është njoftuar Federata Aeronautike e Kosovës për rifillimin e shërbimeve në Qendrën Aero-Mjekësore në Gjakovë për personelin e aviacionit civil.

Më datë 14 dhjetor 2020, përmes një shkrese zyrtare, Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Shqipërisë ka njoftuar Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës lidhur me pranimin dhe miratimin e Dr. Driton Avdiut në cilësinë e Vlerësuesit të Autorizuar Mjekësorë (AMA) edhe për territorin e Republikës së Shqipërisë.

- **Mjetet ajrore të ndaluara në Kosovë**

Disa kompani ajrore janë të ndaluara të operojnë në hapësirën ajrore evropiane (duke përfshirë hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës), pasi që ato janë të pa sigurta dhe/ose ju mungon mbikëqyrja e mjaftueshme nga autoritetet e tyre përkatëse të licencimit. Lista e kompanive ajrore të ndaluara hartohet nga Komisioni Evropian në konsultim të ngushtë me autoritetet e sigurisë së aviacionit të të gjitha shteteve anëtare të Bashkimit Evropian dhe partnerëve të tyre.

Sipas nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, aeroplanët e kompanive ajrore që u është ndaluar nga Bashkimi Evropian (BE) të operojnë në hapësirën ajrore të shteteve anëtare të BE-së, nuk u lejohet të fluturojnë në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës. Për më tepër, lista e përditësuar e BE-së e kompanive ajrore të ndaluara është e postuar në faqen zyrtare të internetit të AAC-së.

Gjatë vitit 2020 nuk është realizuar asnjë fluturim i ndonjë kompanie nga kjo listë e BE-së në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës.

- **Avionët civil të regjistruar dhe ata të larguar nga regjistri i avionëve civil**

Ne vitin 2020 AAC-ja nuk ka regjistruar apo larguar nga regjistri i avionëve civil asnjë mjet ajror.

- **Licencat, certifikatat dhe lejet e aprovuara, duke përfshirë pezullimet dhe revokimet e tyre**

Licencë/certifikatë/leje	Referenca në aktet ligjore	Numri
Leje për transport të dërgesave me mallra të rrezikshme përmes ajrit	Neni 57 i LAC dhe Rregullore 8/2014	115
Leje për operime të aviacionit të përgjithshëm	LAC, Neni 2 dhe 75	14
Leje për regjistrimin e sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot	Rregullore 01/2017	27
Leje për operim të sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot me regjistrim të huaj	Rregullore 01/2017	11
Gjoha për operim të pa-autorizuar të sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot	Rregullore 01/2017	10
Licenca për pilot të paragjajdit	Rregullore 1/2012	-
Licenca për pilot të sistemeve të mjeteve ajrore pa pilot	Rregullore 01/2017	2
Certifikatë mjekësore, klasa 3	LAC, Neni 37	18
Certifikatë mjekësore, klasa 2	LAC, Neni 37	29
Certifikatë mjekësore, klasa 1	LAC, Neni 37	-

b) Shërbimet e navigacionit ajror

- **Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA)**

Më 1 janar 2016, në bazë të Ligjit nr. 04/L-250, është themeluar Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, si entitet pasardhës i Kontrollit Ajror – ANP “Adem Jashari” sh.a. Më 19 gusht 2016 AAC-ja e ka certifikuar ASHNA-n për një periudhë 5 vjeçare për ofrimin e këtyre shërbimeve: shërbimet e trafikut ajror (KTA), shërbimet e komunikimit, navigimit dheurvejimit (KNS), shërbimet e informatave aeronautike (SHIA) dhe shërbimet meteorologjike (MET). Certifikata u lëshua në bazë të nenit 78 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil dhe kriterëve të sigurisë, qëndrueshmërisë ekonomike dhe sigurimit që dalin nga Rregulloret nr. 9/2009 dhe nr. 7/2012, që transponojnë në rendin e brendshëm ligjor të Republikës së Kosovës Rregulloren (KE) nr. 550/2004 dhe Rregulloren (KE) nr. 1035/2011 përkatësisht.

ASHNA ka 26 kontrollorë të trafikut ajror, të cilët aktualisht ofrojnë shërbimet e kontrollit të trafikut ajror në Kosovë. Të gjithë këta janë të licencuar nga AAC-ja në bazë të Rregullores nr. 19/2017 të AAC-së.

- **Mbikëqyrja e vazhdueshme në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror**

ASHNA është certifikuar si ofrues i shërbimeve të navigacionit ajror më 19 gusht 2016. Departamenti i SHNA-së është përgjegjës për të mbikëqyrur edhe mirëmbajtjen dhe respektimin e kushteve të certifikatës nga ana e ASHNA-s, përmes auditimeve të rregullta dhe vizitave dhe inspektimeve ad-hoc.

Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia, plani i auditeve në ASHNA për vitin 2020 nuk ka mundur të realizohet sipas planifikimeve. Megjithatë, gjatë vitit 2020, AAC ka arritur të realizojë dy auditime të plota, njëren virtualisht, duke verifikuar njëherit përmbushjen e kërkesave rregullative.

- *Inspektimet dhe auditimet*

Në kuadër të mbikëqyrjes së vazhdueshme të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, gjatë vitit 2020, AAC-ja ka realizuar gjithsej dy auditime në ASHNA:

Nga data 3 deri me 7 gusht 2020, u mbajt auditimi i sigurisë, i cili për shkak të përballjes me pandeminë u realizua në formën virtuale, përmes platformës “Zoom”, të cilën u dakorduar paraprakisht që ta përdorim me zyrtarët e ASHNA-s.

Qëllimi i auditit ka qenë verifikimi i përmbushjes së kërkesave të Rregullores nr. 06/2012 për mbikëqyrjen e sigurisë në menaxhimin e trafikut ajror dhe shërbimet e navigacionit ajror, përkatësisht nenet 8 dhe 9 dhe kërkesave të Aneksit II të Rregullores nr. 07/2012 mbi kushtet për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror, përkatësisht pikës 3.2.2. të këtij Aneksi.

Fushëveprimi i këtij auditi u përcaktua pasi që janë një numër i ndryshimeve të cilat janë duke ndodhur në këtë agjenci dhe të cilat kanë qenë të klasifikuara si madhore, e që kërkojnë përfshirjen e SHNA-së, si autoritet mbikëqyrës në këtë rast.

Janë audituar zhvillimet në lidhje me ndryshimet:

1. CH/2018/03 – Rilokimi dhe azhurnimi i APP/TWR;
2. CH/2018/04 – Sistemi i ri i radio-komunikimit në lokacionin e Gërmisë;
3. CH/2018/05 – Sistemi i ri iurvejimit;
4. CH/2018/08 – Zgjatja e pistës;
5. CH/2019/02 – Duplikimi i sistemit AFTN;
6. CH/2019/05 – Flight progress strips;
7. CH/2019/06 – AIM, dhe
8. CH/2020/03 – ATM i ri.

SHNA ka dorëzuar raportin e auditit dhe në ndërkohë ka pranuar planin me hapa korrektues, i cili adreson gjetjet e identifikuara gjatë këtij auditit. I njëjti është rishikuar nga SHNA, dhe është konfirmuar që të vazhdohet me implementim të masave të propozuara sipas këtij plani.

Auditimi i dytë është mbajtur me 23-27 nëntor 2020 në ASHNA. Qëllimi i auditit ka qenë verifikimi i kërkesave të cilat rrjedhin nga Rregullorja Nr. 07/2012 mbi kushtet për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror, përkatësisht pikën 3 të Aneksit II të saj, Rregullorja Nr. 04/2013 e cila transponon Aneksin 11 të ICAOs mbi Shërbimet e Trafikut Ajror, Rregullorja Nr. 05/2013 e cila transponon Aneksin 15 të ICAOs mbi Shërbimet e Informatave Aeronautike, Rregullorja Nr. 02/2016 e cila transponon Aneksin 10 të ICAOs mbi Telekomunikacionin Aeronautik, Rregullorja Nr. 19/2017 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror, Rregullorja Nr. 04/2019 mbi vendosjen e kërkesave për ndarjen e kanaleve të komunikimit me zë për Qiellin e Vetëm European dhe Rregullorja Nr. 10/2019 mbi organizimin dhe shfrytëzimin e hapësirës ajrore në Qiellin e Vetëm Evropian - plotësuar nga Rregullorja 01/2016.

Ekipi i auditorëve të SHNA-së, gjatë kësaj periudhe audituese ka identifikuar gjithsej dy gjetje dhe tri observime.

Sic kërkohet edhe me procedurë, ASHNA ka përgatitur planin me hapat korrektues i cili adreson gjetjet dhe observimet e identifikuara, dhe i cili është pranuar nga DSHNA.

Niveli i përkrahjes, bashkëpunimit dhe gatishmëria e personelit të ASHNA-së që të ofrojë informata dhe qasje në dokumentet e kërkuara nga ekipi i auditimit kanë qenë në nivel.

Vlen të theksohet se DSHNA në kuadër të mbikëqyrjes së vazhdueshme, monitoron në vazhdimësi zbatimin e hapave korrektues nga ASHNA, dhe mbyll gjetjet e adresuara në momentin e pranimit të dëshmive të mjaftueshme.

- *Auditimi vlerësues nga EASA*

Më 26 tetor 2017, AAC-ja ka pranuar raportin final të auditimit vlerësues të EASA-s, i mbajtur në periudhën 21-25 nëntor 2016 në AAC. Edhe pse ky raport është pranuar me pothuajse një vit vonesë, Departamenti i SHNA-së ka vazhduar adresimin e gjetjeve të identifikuara gjatë këtij auditimi, në përputhje me planin e përpiluar të hapave korrektues. Më 20 dhjetor 2017 plani i hapave korrektues i është dorëzuar ekipit auditues të EASA-s ndërsa plani zyrtarisht u pranua nga EASA më 23 shkurt 2018.

Plani fillestar (versioni 8.0) i dorëzuar tek EASA ka përmbajtur 49 hapa korrektues të cilët adresojnë 23 gjetjet e ngritura nga ekipi auditues. Të gjithë 49 hapat e propozuar nga AAC-ja kanë qenë të pranueshëm nga EASA por kanë kërkuar edhe shtimin/propozimin e disa hapave të tjerë duke rezultuar me gjithsej 58 hapa në

planin e fundit (versioni 10.0) i cili është pranuar zyrtarisht më 23 shkurt 2018. Në ndërkohë, pas komunikimeve me EASA-n është kaluar edhe në versionin 11 dhe 12 të planit korrektues me 57 veprime korrektuese.

Më 17 maj 2019, DSHNA ka dorëzuar versionin 13.0 të Planit Korrigjues të Veprimeve (Corrective Action Plan - CAP). Më 18 korrik 2019, DSHNA ka pranuar njoftimin nga z. Klus (udhëheqës i ekipit vlerësues të EASA-s) se dëshmitë e dorëzuara në maj të këtij viti, si dhe versionin 13.0 i Planit Korrigjues të Veprimeve (Corrective Action Plan - CAP) janë të pranueshme për ta. Momentalisht nga gjithsej 57 hapa sa janë gjithsej, 55 janë të mbyllur dhe 2 të tjerë pritet të mbyllen.

Gjatë vitit 2020, nuk ka pasur ndryshime në statusin e hapave korrektues. Kjo ka qenë pasojë e situatës së krijuar nga pandemia, pasi që ka cunguar zhvillimin e disa procesve siç janë diskutimet në BANM për normalizimin e hapësirës së ultë ajrore dhe implementimi i projektit të zgjatjes së pistës, e të cilat ndërlidhen me realizimin e plotë të hapave korrektues të parapara për të adresuar çështjet e ngritura nga EASA.

- *Mbikëqyrja e ASHNA-s si Organizatë Trajnuese (OT)*

ASHNA është certifikuar më 19 dhjetor 2017 nga AAC-ja për një periudhë 3 vjeçare për të ofruar shërbimet që i takojnë një Organizate Trajnuese për Kontrollorët e Trafikut Ajror (KTA) siç janë: trajnimet për njësi për KTA dhe trajnimet e vazhdueshme për KTA.

Procesi i certifikimit ka filluar në vitin 2016 kur ASHNA ka aplikuar për certifikim. Me hyrjen në fuqi të Rregullores nr. 19/2017 të AAC-së e cila zëvendësoi Rregulloren nr. 05/2012, në bazë të së cilës asokohe u certifikua ASHNA si OT, AAC u obligua që të bëjë zëvendësimin e certifikatës aktuale në formatin e ri të përcaktuar ne Rregulloren nr. 19/2017. Në përputhje me këtë kërkesë, AAC më 04.01.2019 ka zëvendësuar certifikatën e lëshuar në vitin 2017, me certifikatën CAAK/ANS/1-2019, sipas formatit të ri të paraparë me rregulloren e lartpërmendur.

Që nga koha e certifikimit, ASHNA OT është audituar disa herë nga Departamenti i SHNA-së, brenda kornizave të procesit të mbikëqyrjes së vazhdueshme, për të garantuar dhe verifikuar se OT vazhdon të plotësojë të gjitha kërkesat e rregullores.

Lëshimi i Certifikatës dëshmon për sigurinë dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara por që kërkon angazhim të vazhdueshëm nga ana e ASHNA-s për respektimin e kushteve të certifikimit dhe për ngritje edhe më tutje të cilësisë së shërbimeve.

Gjatë vitit 2020, kërkesat e Rregullores nr.19/2017 janë audituar në auditin e mbajtur me 23-27 nëntor 2020. Nuk ka pasur gjetje në lidhje me këto kërkesa.

- *Kalibrimi i pajisjeve të Navigimit*

Për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, kalibrimi i rregullt nga ajri i sistemeve të navigimit është shtyer.

Si rrjedhojë, ASHNA ka parashtruar kërkesë për shtyrje të afatit të kalibrimit për pajisjen ILS CAT II për RWY17. Në bazë të Rregullores nr. 3/2011 për Kalibrimin e Instalimeve Aeronautike nga Ajri, si dhe duke u bazuar në Udhëzuesin e lëshuar nga ICAO dhe pas pranimit të një sërë testimesh, të cilat kanë dëshmuar që pajisjet në fjalë nuk kanë devijuar nga operimi normal, është aprovuar shtyrja e afatit të kalibrimit për muajt korrik dhe gusht.

Pas lehtësimit të masave ndaj pandemisë në tërë vendet si dhe në vendin tonë, u bë e mundur kontraktimi nga ASHNA, i kompanisë e cila do të bënte kalibrimin nga ajri të sistemeve të navigimit (DVOR, DME dhe ILS).

Ky kalibrim u realizua me datën 09-10.09.2020, rezultatet e të cilave janë dërguar edhe tek ne nga personat përgjegjës për këto pajisje.



- ***Ndryshimet në sistemet e ASHNA-s***

ASHNA është shumë e ndjeshme ndaj rreziqeve që mund të ndodhin gjatë punës së përditshme. Qëllimi kryesor i këtyre shërbimeve është parandalimi i përplasjeve të avionëve në ajër dhe në tokë.

Për këtë arsye, sistemi i menaxhimit të sigurisë kërkon që para çdo ndryshimi, sado i vogël që të jetë ai, në sistemet e ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror të merren hapat e duhur për t'u siguruar se ndryshimi i bërë nuk do të shkaktojë rrezik të patolerueshëm në sistem. Sipas Rregullores nr. 6/2012 të AAC-së, që transponon në rendin tonë të brendshëm ligjor Rregulloren nr. 1034/2011 të KE-së, ofruesit e këtyre shërbimeve janë të obliguar të njoftojnë AAC-në për çfarëdo ndryshimi të

planifikuar që mund të ketë ndikim në siguri; dhe sipas Rregullores nr. 07/2012, që transponon Rregulloren nr. 1035/2011 të KE-së, të bëjnë vlerësimin e rreziqeve të mundshme dhe të marrin të gjithë hapat e nevojshëm parandalues për evitimin e tyre, para se të fillojnë me zbatimin e ndryshimeve.

Gjatë viti 2020 DSHNA-ja është njoftuar për 8 ndryshime të reja të cilat priten të realizohen në sistemet e ASHNA-s:

1. **CH/2020/01** - “Lidhja e radiove me UPS te radarit”

Pas pranimit të vlerësimit të sigurisë nga ASHNA dhe analizës së bërë nga DSHNA, ky ndryshim u klasifikua si ndryshim madhor. Duke u bazuar në këtë klasifikim, nga ASHNA u kërkua të bëhet Plani i Sigurisë si dhe të dorëzohen të gjitha dëshmitë në lidhje me implementimin e masave mitiguese. Dokumentacioni i kërkuar është dorëzuar më 11.03.2020 dhe pas rishikimit, ndryshimi u pranua me datën 11 mars 2020.

2. **CH/2020/02** - “Lidhja me gjeneratore të LKIA”

Është klasifikuar si minor. Ky konstatim rezultoi pas pranimit të Vlerësimit të Sigurisë për këtë ndryshim. Sipas Rregullores nr. 06/2012, ky ndryshim nuk është subjekt i rishikimit dhe pranimit nga ana e AAC-së.

3. **CH/2020/03** - “Sistemi i ri ATM”.

Ndonëse ky ndryshim është njoftuar, klasifikimi i tij ende nuk është bërë për shkak se ende nuk është dorëzuar dokumentacioni i kërkuar.

4. **CH/2020/04** - “Integrimi i Sistemeve të Kullës së Trafikut Ajror”.

Ndryshimi është klasifikuar si madhor. Deri më tani janë pranuar dokumentet preliminare të vlerësimit të sigurisë, ndërsa pritet dorëzimi i dokumenteve shtesë dhe plani i zbatimit.

5. **CH/2020/05** - “Furnizim me softverin për analizë në kohë reale të dhënave të survejimit”.

Është klasifikuar si minor. Ky konstatim rezultoi pas pranimit të Vlerësimit të Sigurisë për këtë ndryshim. Sipas Rregullores nr. 06/2012, ky ndryshim nuk është subjekt i rishikimit dhe pranimit nga ana e AAC-së.

6. **CH/2020/06** - “Sistemi Multilateration (MLAT)”

Ndryshimi është klasifikuar si madhor. Deri më tani janë pranuar dokumentet preliminare të vlerësimit të sigurisë dhe koncepti operacional, ndërsa pritet dorëzimi i dokumenteve shtesë dhe plani i zbatimit.

7. **CH/2020/07** - “Ndryshimi i rrjetit të internetit nga LIMAK në ASHI ne sistemin AFTN”

Ndryshimi është klasifikuar si minor. Ky konstatim rezultoi pas pranimit të Vlerësimit të Sigurisë për këtë ndryshim. Sipas Rregullores nr. 06/2012, ky ndryshim nuk është subjekt i rishikimit dhe pranimit nga ana e AAC-së.

8. CH/2020/08 - "Ndërrimi i Shef Instruktorit"

Është klasifikuar si minor, por pas vlerësimit të dokumentacionit, është konstatuar se ndonëse ky ndryshim nuk klasifikohet si madhor, për kah efekti në siguri, i njëjti kërkon aprovim formal nga AAC, në përputhje me dispozitat ATCO.AR.E.010 and ATCO.OR.B.015 të rregullores së AAC-së Nr. 19/2017. Rrjedhimisht, AAC, ka rishikuar dokumentacionin e dorëzuar dhe ka konstatuar se ky ndryshim nuk e cenon përmbushjen e kërkesave të Shtojcës III (PART ATCO.OR) të Rregullores 19/2017. Në përputhje me dispozitën ATCO.AR.E.010 të Rregullores 19/2017, ky ndryshim u aprovua më 9 nëntor 2020.

Të gjitha këto ndryshime do të trajtohen në përputhje me kërkesat e përcaktuara me Rregulloren e AAC-së nr. 6/2012 mbi trajtimin e ndryshimeve madhore apo minore.

Gjatë këtij viti DSHNA në vazhdimësi ka përfshirë ndryshimet e njoftuaranë aktivitetet mbikëqyrëse dhe ka rishikuar dokumentacionin e dorëzuar nga ASHNA në lidhje me to. Në veçanti ndryshimet e listuara më poshtë të cilat janë në implementim e sipër, kanë qenë subjekt i auditit të mbajtur më 3 deri me 7 gusht 2020.

1. CH/2018/03 – Rilokimi dhe azhurnimi i APP/TWR;
2. CH/2018/04 – Sistemi i ri i radio-komunikimit në lokacionin e Gërmisë;
3. CH/2018/05 – Sistemi i ri iurvejimit;
4. CH/2018/08 – Zgjatja e pistës;
5. CH/2019/02 – Duplikimi i sistemit AFTN;
6. CH/2019/05 – Flight progress strips;
7. CH/2019/06 – AIM, dhe
8. CH/2020/03 – ATM i ri.

• *Lëshimi i licencave për kontrollorët e trafikut ajror dhe vlerësimi i gradimeve*

AAC-ja është përgjegjëse për lëshim dhe ripërtëritjen e licencave të kontrollorëve të trafikut ajror, të cilët ofrojnë shërbimet e kontrollit ajror në Republikën e Kosovës. Duke pasur parasysh rëndësinë e shërbimit të kontrollit të trafikut ajror në sigurinë e fluturimeve, kontrollorët duhet të përmbushin një varg të kërkesave dhe kushteve për të mirëmbajtur licencat dhe miratimet e tyre, të cilat dalin nga Rregullorja nr. 19/2017 e AAC-së që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror.

Kërkesat kryesisht ndërlidhen me nivelin e kompetencës profesionale, që përfshijnë ndjekjen e trajnimeve profesionale përditësuese dhe ushtrimin e detyrave të kontrollorit të trafikut ajror për një numër të caktuar të orëve brenda vitit. Kontrollorët gjithashtu, në baza vjetore, i nënshtrohen vlerësimit profesional për të verifikuar nivelin e aftësive.

Rëndësi e veçantë i kushtohet edhe zotërimit të gjuhës angleze, pasi që komunikimi në aviacionin ndërkombëtar bëhet në këtë gjuhë. Niveli i zotërimit të gjuhës angleze vlerësohet në mënyrë periodike dhe merret parasysh gjatë lëshimit apo ripërtërimit të licencës. Kontrollorët gjithashtu duhet të kenë shëndet të mirë, në përputhje me kërkesat ligjore, dhe kjo verifikohet në mënyrë të rregullt nga AAC-ja si pjesë e procesit të licencimit.

Për shkak të përballjes me Pandeminë COVID-19, procesi i rregullt i rivalidimit të miratimeve të njësisë nuk ka mundur të zhvillohet si në vitet paraprake, pasi që situata ka pamundësuar ndjekjen e trajnimeve rifreskuese e që është kërkesë e Rregullores Nr.19/2017.

Për ta adresuar këtë çështje dhe për të vazhduar zgjatjen e afatit të miratimeve të njësisë për KTA, fillimisht ASHNA ka parashtruar kërkesën për zgjatje të afatit të miratimeve, ndërsa SHNA, pas shqyrtimit të bazës ligjore të Rregullores Nr. 05/2020 mbi rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe themelimin e Agjencisë së Bashkimit Evropian për Sigurinë e Aviacionit, përkatësisht nenit 71 të saj, Rregullores Nr. 19/2017 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror, pranimit dhe analizimit të vlerësimit të sigurisë, si dhe dokumentacionit përcjellës në lidhje me vlerësimet e kompetencës së KTA-ve, ka dhënë rekomandimin për zgjatje të afatit të validitetit të miratimeve të njësisë për një periudhë 4 muajore nga data e skadimit, me mundësi vazhdimi edhe për 4 muaj të tjerë. Ndërsa AAC-ja, me datë 31.12.2020 ka lëshuar shkresën me të cilë lejon zgjatjen e privilegjeve të miratimeve të njësisë sipas rekomandimit nga DSHNA.

Gjatë vitit 2020 janë lëshuar 9 licenca për studentë kontrollorë, ndonëse për shkak të pandemisë pjesën më të madhe të vitit 2020, shumica e aktiviteve trajnuese (OJTI) kanë qenë të suspenduara.

Detajet me licencat e ripërtërira dhe rivalidim të gradimeve, për vitin 2020, është dhënë në tabelën e mëposhtme.

Licencimi i Kontrollorëve të Trafikut Ajror (KTA)	Numri i të licencuarve
Ripërtëritja e licencave për KTA (miratimeve të njësisë)	0
Rivalidim i gradimeve (miratimeve të njësisë)	0
Rivalidim/ripërtëritje e gradimeve për instruktorë/asesorë	1
Licencimi i studentëve KTA	9
Licencim i KTA-ve	0

- Publikimi i Informatave Aeronautike

Në bazë të Rregullores nr. 5/2013 të AAC-së për zbatimin e Shtojcës 15 të Konventës Ndërkombëtare për Aviacionin Civil për shërbimet e informimit aeronautik, AAC-ja ka përgjegjësi që të publikojë dokumentin “Publikimi i Informatave Aeronautike” (PIA), i njohur sipas akronimit në anglisht si AIP (*Aeronautical Information Publication*). Ky është një dokument shtetëror i një rëndësie të veçantë, në të cilin publikohen të gjitha informatat në lidhje me aviacionin e një shteti. Dokumenti në vete përmban tre kapituj: kapitulli i parë përmban informata të përgjithshme për aviacion, i dyti ka të bëjë me hapësirën ajrore dhe kapitulli i tretë ka të bëjë me specifikat e detajuara për secilin aeroport/heliport, përfshirë edhe procedurat e fluturimit për aeroplanët.

Meqë ky publikim përdoret në masë të madhe nga kompanitë ajrore që operojnë ose synojnë të operojnë në Kosovë, AAC-ja kujdeset që AIP e Kosovës të mbahet e përditësuar dhe secili ndryshim që ndodhë në lidhje me aviacionin civil brenda shtetit të reflektohet në këtë dokument. Këto ndryshime janë të rregullta dhe bëhen përmes amandamentimeve në cikle të caktuara çdo 28 ditë, përmes të të ashtuquajturit Kontrolli dhe Rregullimi i Informatave Aeronautike (KRIA) (ang. *Aeronautical Information Regulation and Control - AIRAC*) dhe bëhen efektive çdo 56 ditë.

Gjatë këtij viti janë aprovuar tri amandamente AIRAC (AIP AIRAC AMDT), një amandament AIP, një suplement dhe dy qarkore për publikim në dokumentin e Publikimit të Informatave Aeronautike (AIP).

Respektivisht janë publikuar:

- AIP AMDT 01/2020 i bërë efektiv me datë 27 shkurt 2020;
- AIP AIRAC SUP 01/2020 me datë efektive 31 dhjetor 2020;
- AIP SUP 02/2020 me datë efektive 15 shkurt 2020 (i cili ka zëvendësuar AIP SUP 01/2020);
- AIP SUP 03/2020 me datë efektive 26 mars 2020 (i cili ka zëvendësuar AIP SUP 02/2020);
- AIP AIRAC SUP 04/2020 me datë efektive 18 qershor 2020;
- AIC 01/2020 me datë efektive 20 tetor 2020;
- AIP AMDT 02/2020 me datë efektive 31.12.2020;

Publikimi më aktual i informatave aeronautike është i qasshëm në çdo kohë në faqen zyrtare të AAC-së në internet.

- **Aktivitetet në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19**

Që nga paraqitja e pandemisë COVID-19, DSHNA ka bashkëpunuar ngushtë me ASHNA-n për të koordinuar aktivitetet e publikimit të NOTAM-ëve për të reflektuar vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me kufizimet dhe masat e ndërmarra për parandalimin dhe përhapjen e sëmundjes.

c) Aerodromet

Sipas Ligjit Nr. 03/L-51 për Aviacionin Civil, AAC është përgjegjës për rregullimin dhe zhvillimin e politikave të aerodromeve dhe ofruesve të shërbimeve në tokë, duke verifikuar zbatimin e standardeve të aplikueshme të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar, dhe duke siguruar një ambient të sigurt të aviacionit civil në Republikën e Kosovës.

Varësisht nga natyra e operimeve dhe shkalla e shfrytëzimit, aerodromet civile kategorizohen në aerodrome të certifikuara, aerodrome të aprovuara dhe aerodrome të regjistruara. Në kuadër të AAC-së, Departamenti i Aerodromeve është përgjegjës për certifikim, aprovim dhe regjistrim të aerodromeve në dispozicion për shfrytëzim civil në Republikën e Kosovës, përfshirë edhe fushat ajrore dhe heliportet. Gjithashtu, me qëllim të përcaktimit të rregullave dhe procedurave që rregullojnë qasjen në tregun e shërbimeve në tokë në Republikën e Kosovës, Departamenti i Aerodromeve është përgjegjës për vlerësimin e sigurisë së ofruesve të shërbimeve në tokë në aerodromet e Republikës së Kosovës, përfshirë edhe ofruesit e shërbimeve në tokë për furnizim të aeroplanëve me karburant.

Për t'u siguruar se aftësimi profesional dhe trajnimi i punonjësve të aerodromit dhe punonjësve tjerë të kontraktuar, ofruesve të shërbimeve në tokë dhe shfrytëzuesve të shërbimeve të aerodromit të cilët vetë japin shërbime në tokë, bëhet sipas standardeve dhe kriterëve të përcaktuara me legjislacionin përkatës, Departamenti i Aerodromeve është përgjegjës për aprovimin e organizatave të aftësimit profesional për fushën e aerodromeve.

Me qëllim të mirëmbajtjes së sigurisë së aviacionit civil në Republikën e Kosovës, Departamenti i Aerodromeve, gjithashtu është përgjegjës për caktimin dhe monitorimin e zonave mbrojtëse të aerodromeve. Ky departament koordinon bashkëpunimin mes operatorëve të aerodromeve, departamentit përgjegjës në ASHNA, subjekteve juridike/personave fizik, të cilët kanë në pronësi apo planifikojnë të ndërtojnë një objekt brenda zonave mbrojtëse të aerodromeve apo ndonjë objekt të lartë kudo në territorin e Republikës së Kosovës dhe institucioneve përgjegjëse për lëshimin e lejeve të ndërtimit sipas Ligjit për ndërtim. Departamenti i aerodromeve duhet të sigurojë që të gjitha palët e përfshira i respektojnë procedurat të përshkruara në rregulloren mbi zonat mbrojtëse të aerodromit dhe rregulloren për shënjimin e pengesave.

Për të verifikuar dhe siguruar zbatimin e plotë të legjislacionit të aplikueshëm vendor dhe ndërkombëtar, Departamenti i Aerodromeve bën mbikëqyrje të vazhdueshme të sigurisë së aerodromeve, ofruesve të shërbimeve në tokë dhe organizatave të aftësimeve profesionale përmes auditimeve, inspektimeve dhe monitorimit të aktiviteteve të tyre.

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" fillimisht është certifikuar më 1 dhjetor 2008 nga AAC-ja si aeroport ndërkombëtar në përputhje me Ligjin për

Aviacionin Civil, Rregulloren e AAC-së nr. 1/2008 për aerodromet dhe standardet dhe praktikat e rekomanduara të ICAO-s. Në vitin 2011 aeroporti është dhënë në koncesion dhe menaxhimi i tij ka kaluar në duart e operatorit privat, konzorciumit turko-francez "Limak - Aéroports de Lyon" (Limak Kosovo International Airport sh.a.). Më 8 nëntor 2013, bazuar në kërkesat ligjore, me rastin e transferimit të operimeve në terminalin e ri, AAC-ja ka amandamentuar certifikatën e operatorit "Limak Kosovo International Airport" sh.a. (LKIA). Përfundimisht, pas hyrjes në fuqi të Rregullores nr. 17/2017 të AAC-së që përcakton dispozitat dhe procedurat administrative lidhur me aerodromet, që e ka zbatuar në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës Rregulloren e Komisionit (BE) nr. 139/2014 me të njëjtin emër, më 8 nëntor 2018, AAC-ja ka certifikuar Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" dhe operatorin e aerodromit "Limak Kosovo International Airport" sipas standardeve më të larta të sigurisë së aerodromeve dhe në përputhje me kërkesat e Bashkimit Evropian.

Në bazë të Rregullores nr. 04/2011 të AAC-së për qasje në tregun e shërbimeve në tokë, më 1 janar 2012 AAC-ja ka lëshuar aprovimin në kohëzgjatje prej 7 vjetësh për kompaninë "Ex-Fis" Sh.P.K. si furnizues i shërbimeve në tokë për kategorinë e shërbimeve të furnizimit me derivate dhe vajra. Në fund të vitit 2018, operatori "Ex-Fis" Sh.P.K. ka aplikuar në AAC për vazhdim të aprovimit. Me kalimin e pragut prej 2 mil. pasagjerëve të shërbyer në ANP "Adem Jashari" janë përmbushur kushtet për angazhim të më shumë kompanive të interesuara.

Më 1 qershor 2012, AAC-ja ka aprovuar operatorin LKIA për ofrim të shërbimeve në tokë në disa kategori në ANP "Adem Jashari".

- *Mbikëqyrja e vazhdueshme e sigurisë së aerodromeve*

Një nga funksionet themelore të Departamentit të Aerodromeve, për garantimin e sigurisë së aerodromeve në Republikën e Kosovës, është zbatimi i sistemit efektiv të mbikëqyrjes. Mbikëqyrja efektive e sigurisë bëhet përmes vlerësimit dhe aprovimit të manualeve, programeve dhe procedurave të ndryshme të operatorit, miratimeve të vlerësimeve të sigurisë, dhe veçanërisht përmes kryerjes së inspektimeve formale (me apo pa njoftim paraprak të operatorit), bazuar në planin vjetor të mbikëqyrjes, apo duke iu përgjigjur situatës që mund të kërkojë nevojën për vigjilencë shtesë në siguri.

Sipas planit të aktiviteteve për monitorimin e rregullt dhe verifikimine zbatimit të standardeve të aplikueshme për operatorin e ANP "Adem Jashari" dhe ofruesve të shërbimeve në tokë, inspektorët e Departamentit të Aerodromeve gjatë vitit 2020 kanë kryer (1) një auditim, shtatë (7) inspektime të rregullta, (1) një inspektim tek ofruesit të shërbimeve në tokë, kompanisë "Ex-Fis", (2) dy inspektime "follow-up" i inspektimeve të mëhershme.

Auditimi i planifikuar i sistemit të menaxhimit të LKIA-së, përfshirë edhe sistemin e menaxhimit të sigurisë ("SMS"), është realizuar në ANP "Adem Jashari" në periudhën 10-16.11.2020. Sistemi i menaxhimit të sigurisë është vlerësuar nga AAC

në faza të ndryshme të procesit të certifikimit, si dhe është monitoruar vazhdimisht përmes aktiviteteve të mbikëqyrjes së sigurisë së operatorit LKIA. Qëllimi i këtij auditimi ishte të bëhet një vlerësim gjithëpërfshirës i sistemit dhe të vlerësoj zbatimin dhe pjekurinë e tij. Për qëllimet e këtij auditimi, është përdorur dokumenti i EASA-së për vlerësimin e sistemit të menaxhimit të një aerodromi.

- **Zbatimi i protokollit të sigurisë së shëndetit për frenimin e përhapjes së COVID-19 në ANP “Adem Jashari”**

Inspektorët e aerodromeve së bashku me “Vlerësuesin e Autorizuar Mjekësor” për aviacion nga departamenti i sigurisë së fluturimeve, gjatë vitit 2020 në baza të rregullta kohore kanë realizuar njëzetë (20) inspekte në ANP “Adem Jashari”, për të verifikuar zbatimin e masave për parandalimin e përhapjes së COVID-19, duke e inspektuar tërë procesin e menaxhimit të udhëtarëve në arritje dhe në shkuarje sipas planit të veprimit të operatorit të aeroportit. Në përgjithësi procesi ka qenë në rregull dhe në disa raste sipas nevojës janë dhënë vërejtje dhe sugjerime.



Pamje nga inspektimi

- **Aprovimi i programeve për aftësi profesionale të LKIA-së**

Në përputhje me kërkesat e Rregullores së AAC-së nr. 01/2014 mbi aftësimin profesional të punonjësve të aerodromit dhe punonjësve tjerë të kontraktuar, edhe gjatë vitit 2020 janë pranuar disa kërkesa nga operatori LKIA i ANP “Adem Jashari” për aprovime të programeve të ndryshme për aftësi profesionale. Pas shqyrtimit

të programeve trajnuese dhe instruktorëve dhe konstatimit se standardet dhe kushtet relevante janë përmbushur, është aprovuar programi i trajnimit dhe instruktorët për "Operimet për Shtyrjen e Aeroplanit", është aprovuar programi i përditësuar i trajnimit për "Trajnimin bazik për SMS", është aprovuar programi i përditësuar i trajnimit për "Shkrirje te akullit dhe dëborës dhe mbrojtje kundër ngrirjes se aeroplanëve" ("Aircraft de-icing/angi-icing").

Si pjesë e procesit të aprovimit të trajnimeve, AAC ka bërë edhe monitorimin e implementimit të seancave trajnuese, me ç'rast është vlerësuar performanca e mësimdhënies nga instruktori, si dhe rezultatet e mësimnxënies nga ana e pjesëmarrësve në trajnime.

Raportet e vlerësimit të këtyre trajnimeve me komentet dhe sugjerimet e nevojshme janë dërguar te operatori LKIA.

- **Projekti për zgjatjen e pistës në ANP "Adem Jashari" dhe për ngritjen e kategorisë së sistemit të aterrimin me instrumente nga "CAT II" në "CAT III b"**

Siç kërkohet me rregulloren 17/2017 për aerodrome dhe në përputhje me materialin udhëzues TP 27 - "Procedurat për ndryshime të aerodromit", është vazhduar monitorimi i punëve që janë duke u kryer për implementimin e projektit për zgjatjen e pistës. Inspektorët e aerodromeve kanë inspektuar vazhdimisht në baza të rregullta procesin e punës.

Në bashkëpunim të ngushtë me inspektorët e shërbimeve të navigacionit ajror, është bërë vlerësimi i rrezikut për zhvendosjen e pragut të pistës, i cili është pranuar pas përfshirjes të të gjitha rekomandimeve. Pjesë e këtij procesi ka qenë edhe rishikimi dhe aprovimi i të dhënave në shtojcën e Publikimit të Informatave Aeronautike (AIRAC), i cili është bërë në koordinim të plotë mes palëve, LKIA-ASHNA-AAC.

Për shkak të situatës së emergjencës publike të shkaktuar nga pandemia e Covid-19 janë ndërprerë punët ndërtimore për zgjatjen e pistës, kurse zhvendosja e pragut të pistës, është shtyrë për një afat të pacaktuar. Ndërsa, nga data 18 qershor ANP "Adem Jashari" ka filluar operimet me pragun e zhvendosur të pistës, duke shkurtuar gjatësinë e pistës nga 2500 m në 2200 m, gjithashtu operatori ka dërguar njoftimin se kanë bërë kërkesën për kalibrimin e PAPI-ve. Më datë 12.11.2020 inspektorët e AAC kanë realizuar inspektimin në ANP Adem Jashari me qëllim të verifikimit të gjendjes në terren pas kërkesës se operatorit LKIA për kthimin e pragut të pistës nga 2200m në 2500 m. Pas përmbushjes së kërkesave të AAC, operatorit LKIA ANP "Adem Jashari" ka filluar me operimet e rregullta me gjatësinë e plotë të pistës (2500 m).



Foto nga realizimi i projektit



Pamje nga auditimi

- *Vlerësimi i ndikimit të turbinave të erës dhe ndërtimeve të larta në sigurinë e operimeve ajrore në Republikën e Kosovës*

Departamenti i aerodromeve ka vazhduar të ushtrojë rolin koordinues për vlerësimin e ndikimit të ndërtimeve të larta në sigurinë e operimeve ajrore në Republikën e Kosovës.

Sipas Ligjit Nr. 03 / L-051 për Aviacionin Civil, Rregullores (AAC) nr. 09/2018 mbi zonat mbrojtëse të aerodromit dhe Rregullores (AAC) Nr. 03/2019 për Shënjimin e pengesave, Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC) është përgjegjës për të siguruar se të gjitha objektet, të palëvizshme apo të lëvizshme, që gjenden brenda një hapësire me rreze prej 15 km prej një aerodromi, apo objekte të larta që mund të konsiderohen si pengesa për aeroplanët në fluturim jashtë kësaj hapësire, janë nënshtruar shqyrtimit dhe vlerësimit aeronautik gjithëpërfshirës nga ana e operatorit të ANP "Adem Jashari" (LKIA) dhe Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA). Varësisht nga rezultatet e vlerësimeve, AAC do të konstatoj se a paraqet pengesë një objekt apo jo, dhe mund të kërkoj nga aplikuesi që të zbatoj procedurat për shënjimin (me ngjyrosje dhe/apo ndriçim) e objekteve, me qëllim për të ngritur sigurinë e fluturimeve, duke i bërë pengesat të dallueshme nga zona përreth dhe të dukshme nga të gjitha drejtimet për aeroplanët. Duke i koordinuar veprimet nën përgjegjësinë e saj, AAC duhet të sigurohet se ndërtimi, instalimi dhe operimi i turbinave të erës nuk do të ndikojë në sigurinë e operimeve të aeroportit dhe në trajektoret e fluturimeve të aeroplanëve në Republikën e Kosovës. Gjatë vitit 2020 inspektorët e aerodromeve kanë vazhduar konsultimet dhe koordinimin edhe me operatorin e fermës së turbinave të erës në kodrën "Kikë" - Komuna e Kamenicës, lidhur me vendosjen e dritave sinjalizuese shtesë, bazuar në rregulloren 03/2019. Invesitori/operatori i fermës së turbinave të erës 'GURIS', ka njoftuar se pas disa shtyerjeve për shkak të situatës me panedeminë, prodhuesi i turbinave 'General Electric' nga Gjermania gjatë muajit Gusht 2020 ka filluar të bëjë montimin e dritave në shtyllat e gjeneratorëve. Në tetor të këtij viti, AAC është njoftuar nga zyrtarët përgjegjës për farmën e gjeneratorëve për përfundimin e këtij projekti.

Me 30.11.2020 AAC ka realizuar një inspektim edhe në fermën e gjeneratorëve të kompanisë "SOWI Kosovo LLC" në SELAC, ku janë parë nga afër zhvillimet e punimeve të këtij projekti. AAC do të vazhdoj të monitorojë nga afër zhvillimet e punimeve deri në përfundim të plotë të këtij projekti.



Turbinat e erës në Kikë, Kamenicë

- **Implementimi i Rregullores nr.03/2019 për shënjimin e pengesave dhe Rregullores 09/2018 mbi zonat mbrojtëse të aerodromeve**

Zbatimi i Planit për verifikim të implementimit të Rreg. 03/2019 dhe Rreg. 09/2018

Në kuadër të përgjegjësisë, inspektorët e aerodromeve kanë vazhduar inspektimet në terren, për të konfirmuar përmbushjen e kërkesave të Rregullores 03/2019 për shënjimin e pengesave dhe Rregullores 09/2018 mbi zonat mbrojtëse të aerodromeve. Në këtë kontest, inspektorët e aerodromeve kanë përpiluar një plan të detajuar të veprimit të ndarë në tri fusha kryesore:

- Identifikimi i largpërçuesve në autoudhët dhe rrugët nacionale,
- Verifikimi i shënjimit (ndriçimit dhe ngjyrosjes) të objekteve të identifikuara më parë,
- Organizimi i takimeve me operatorët dhe institucionet relevante.

Me këto veprime është synuar të bëhet verifikimi i shënjimeve të objekteve të cilët mund të jenë pengesa për aviacionin civil, të bëhet regjistrimi i tyre dhe pastaj prezantimi i rezultateve tek personat përgjegjës. Me datë 20 Gusht të viti 2020 AAC, ka kërkuar skjarim nga KOSTT, lidhur me për derogimin e nenit 6 të Rregullores nr.03/2019 për Shënjimin e pengesave. Sipas planit të veprimit për vitin 2020, , të cilin e ka dërguar më herët në AAC, KOSTT ka planifikuar furnizimin me trupa ndriçues për linjat 400/220/100 KV të cilat janë në kryqëzim të autostradës "Ibrahim Rugova", që përshkruan aksin rrugor (R7) Arllat – Prizren, dhe autostradës "Arbër Xhaferi" në aksin rrugor (R6) Prishtinë – Hani Elezit. Nga KOSTT jemi njoftuar se kanë përfunduar fazën e prokurimit dhe përgjatë viti 2021 do të fillojnë me realizimin këtij projekti.

AACK është duke mbajtur korrespondencë të vazhdueshme me KOSTT-in në lidhje me implementimin të Rregullores 03/2019 për Shënjimin e pengesave.

Ndërtimet brenda zonave mbrojtëse të ANP "Adem Jashari"

Në kuadër të përgjegjësiave për rregullimin e zonave mbrojtëse të aerodromeve, inspektorët e aerodromeve kanë vazhduar me mbikëqyrjen e zbatimit të rregullores mbi zonat mbrojtëse të aerodromit dhe Rregullores për shënjimin e pengesave.

Gjatë vitit 2020 është pranuar nga ANP "Adem Jashari" LKIA një vlerësim i aplikacionit për ndërtime brenda zonave mbrojtëse të aeroportit, si dhe vlerësimi dhe aprovimi i aplikacionit të pranuar nga aeroporti për projektin, lidhur me vendosjen e antenave "Glide Path" në të dy anët e pistës.

AAC-ja ka vlerësuar dhe rishikuar në hollësi dokumentacionin e pranuar dhe, pasi është siguruar që ndërtimet nuk do të ndikojnë në sigurinë e operimeve të aviacionit civil, ka miratuar vlerësimet, me kusht që zbatohen të gjitha rekomandimet e parashtruara. Për më shumë, me qëllim të intensifikimit të bashkëpunimit mes palëve përgjegjëse për zbatimin e rregulloreve relevante për ndërtim brenda zonave mbrojtëse të aerodromeve, inspektorët e aerodromeve kanë zhvilluar takime me zyrtarë përgjegjës të komunës së Fushë Kosovë dhe të LKIA-së.

- ***Vlerësimi i kërkesave për ndërtimin e heliporteve***

Edhe gjatë vitit 2020, AAC ka pasur takime me palë të interesuara që kanë bërë shprehjen të interesit për hapje dhe operim të heliporti.

Në këto takime inspektorët e AAC kanë dhënë udhëzimet e nevojshme për procesin e aplikimit dhe aprovimit të heliporti. Në koordinim me inspektorin për operimet ajrore, është përpiluar edhe letra me udhëzimet përkatëse për kushtet të cilat duhet të plotësohen nga palët e interesuara (operatori) për tu pajisur me aprovim që iu është dorëzuar palëve të interesuara.

- **Bashkëpunimi midis Departamenteve të Aerodromeve nga Kosova dhe Shqipëria**

Departamenti i aerodromeve ka vazhduar edhe më tutje bashkëpunimin ndërshtetëror midis Autoriteteve të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës dhe AAC-ve të rajonit. Gjatë këtij viti, bashkëpunimi ndërshtetëror midis Autoriteteve të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës, Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut kanë bashkëpunuar ngushtë në realizimin e synimit të përbashkët: shkëmbimi i përvojave për një aviacion më të sigurtë.



Në kuadër të marrëveshjes dypalëshe, inspektorët e aerodromeve kanë pranuar ftesë zyrtare për tu bërë pjesë auditimit gjithëpërfshirës në kuadër të procesit të konvertimit të certifikatës me Rregulloren e EASA 139/2014, për Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës “Nënë Tereza”. Në kordinim të drejtorave të dy AAC-ve, AAC e Kosovës ka dërguar në Tiranë dy inspektorë të aerodromeve për të mbështetur kolegët e AAC të Shqipërisë për këtë proces.

Pas përfundimit të rishikimit të dokumentacionit të prezantuar nga aeroporti, nga data 7 deri me 12 dhjetor 2020, në aeroportin e Tiranës “Nënë Tereza” u realizua auditimi një javor që përfshiu sistemin e menaxhimit të sigurisë, planin emergjent, karakteristikat fizike dhe infrastrukturën e aerodromit, etj. Përveç kësaj u mbuluan edhe pjesa tjetër për shërbimet operative si shërbimi për zjarrfikje dhe shpëtim, shërbimi operimeve në platformë, transporti i mallrave të rrezikshme, siguria e lëvizjes së automjeteve në fushën ajrore, mirëmbajtja e fushës ajrore dhe menaxhimi i rrezikut nga bota shtazore, si dhe kontrolli i pengesave në zonat mbrojtëse të aeroportit.

Ky auditim i përbashkët përveç rëndësisë që kishte për shkak të konvertimit të certifikatës së aeroportit me një standard më të lartë të BE, procesi u vlerësua si shumë pozitiv nga të dyja palët edhe në aspektin e bashkëpunimit të dy institucioneve, sepse mundësoi shkëmbimin e përvojave dhe ekspertizave të inspektorëve që më tutje do të aplikohen në interes të ngritjes së standardeve të aviacionit të të dy shteteve, dhe për më shumë krijoi një lidhje edhe më të ngushtë në mes të dy institucioneve.



Foto nga inspektimi

d) Rregullimi ekonomik i aviacionit

Në bazë të nenit 15, pika e) e LAC-së, AAC-ja është përgjegjëse për rregullimin e ekonomisë së aeroporteve dhe ofruesve të shërbimeve të navigacionit ajror në Republikën e Kosovës. Rregullimi ekonomik i këtyre operatorëve nënkupton masat që merr një rregullator i aviacionit për t'u siguruar se tarifat të cilat i vendos aeroporti dhe ofruesi i shërbimeve të navigacionit ajror për kompanitë ajrore janë të vendosura në mënyrë të arsyeshme, transparente dhe jodiskriminuese.

- **Mbikëqyrja ekonomike e aeroportit**

Mbikëqyrja e zakonshme vjetore ekonomike

Analiza e pasqyrave të audituara financiare të operatorit të ANP "Adem Jashari" për gjendjen financiare në fund të vitit 2019 ka vërtetuar që LKIA sh.a. kishte qëndrueshmëri financiare dhe ka vazhduar të ketë rritje të profitit dhe të efikasitetit operativ. Sipas analizës së raportit financiar rezulton se operatori i ANP "Adem Jashari" ka shëndet të mirë financiar edhe pse me ulje të vogël të likuiditetit por njëkohësisht ulje të kostos së financimit. Gjatë dorëzimit të raporteve të audituara financiare për tarifat e rregulluara nga AAC-ja dhe për tarifat e shërbimeve në tokë, AAC-ja ka vërtetuar që këto llogari financiare janë të ndara ashtu siç kërkohet me Nenin 4 të Rregullores nr. 04/2011 të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 05/2019 të AAC-së mbi qasjen në tregun e shërbimeve në tokë. Sa i përket vetëm

segmentit të shërbimeve në tokë, në raportet e audituara gjithashtu janë pasqyruar llogaritë e ndara të të hyrave dhe shpenzimeve të LKIA-së nga ky aktivitet ashtu siç kërkohet me Rregulloren e lartpërmendur.

Në kuadër të mbikëqyrjes ekonomike të operatorëve, në muajin prill është konfirmuar vlefshmëria e policës së sigurimit të LKIA-së për operimet në ANP. Polica për përgjegjësi në aviacion mbulon periudhën 4 prill 2020 - 3 prill 2021 dhe ka mbulesë prej 100,000,000 EUR për cilëndo rast dhe në agregat në relacion me përgjegjësinë për produktet.

Aprovimi i Programit Nxitës të ANP “Adem Jashari” LKIA

Më 22 maj 2020, U.D Drejtori i përgjithshëm, përmes Vendimit 06/ZDP/VE/2020 ka aprovuar programin nxitës për ANP “Adem Jashari” për periudhën 22 maj 2020 deri më 26 mars 2022. Departamenti BNRREA ka vlerësuar në hollësi propozim-programin nxitës të dorëzuar nga LKIA më 12 shkurt 2020 dhe kanë rekomanduar aprovimin e tij pasi që kanë marrë opinionet e kompanive ajrore, siç parashihet me Rregulloren nr. 03/2015 të AAC-së mbi tarifatat në aeroporte. Programi nxitës 2020-2022 përmban këto nxitje: nxitje për zhvillimin e destinacioneve të reja, nxitje për zhvillimin e frekuencave shtesë dhe nxitje për stacionim të aeroplanëve.

• Shqyrtimi i propozimit të LKIA për ulje uniforme tarifash aeronautike

Më 2 qershor 2020, LKIA ka dërguar në AAC për miratim propozimin për aplikimin e një mase lehtësuese uniforme për të gjitha kompanitë ajrore si mënyrë për të adresuar rënien e thellë të trafikut si rezultat i pandemisë. Kjo masë lehtësuese konsistonte në ulje tarifash aeronautike për të gjitha kompanitë ajrore prej momentit të heqjes së kufizimit të operimeve ajrore komerciale në ANP deri në fund të sezonit dimëror 2020/2021. Qëllimi i këtij propozimi ishte që kompanitë ajrore dhe aeroporti të tejkalojnë bashkërisht efektet operative dhe financiare të shkaktuara nga pandemia.

Pas shqyrtimit të kërkesës së LIMAK, e cila ishte një shkresë dhe nuk ofronte informacione tjera të nevojshme që kërkohet sipas Rregullores 03/2015, AAC ka kërkuar nga organi menaxhues i aeroportit që të sjellë provat e kërkesave të kompanive ajrore drejtuar LKIA-së për të siguruar masat lehtësuese për të kapërcyer krizën financiare të shkaktuar nga pandemia, provën e konsultimit me përdoruesit, efektin e masave lehtësuese në trafik dhe efektin e masës lehtësuese në qëndrueshmërinë financiare të LKIA-së.

Operatori nuk i është përgjigjur kërkesës së AAC-së të datës 23 korrik 2020 për dorëzimin e dokumentacionit shtesë, prandaj Drejtoresha e DBNRREA ka lajmëruar Drejtorin e Përgjithshëm se afati për shqyrtim nga ana e DBNRREA ka skaduar.

- **Mbikëqyrja ekonomike e ASHNA-s**

Në bazë të Rregullores nr. 03/2016 të AAC-së mbi skemën e përbashkët të tarifave të shërbimeve të navigacionit ajror, ASHNA çdo vit i propozon AAC-së për miratim një vlerë të tarifës terminale njësi e cila do të jetë e aplikueshme në vitin pasues. Me qëllim të vlerësimit të propozimit të ASHNA-s për përcaktimin e tarifës njësi terminale për vitin 2021, AAC përveç raportimit të dytë (sepse raportimi i parë është shtyrë për shkak të situatës së krijuar nga pandemia) ka pranuar edhe dokumente shtesë të nevojshme gjatë vitit nga ASHNA. Pasi që zyrtarët e rregullimit ekonomik të aviacionit kanë analizuar të gjitha dokumentet e dorëzuara nga ASHNA për vitin 2021, i kanë rekomanduar Drejtorit të përgjithshëm të AAC-së lëshimin e Vendimit Ekzekutiv nr. Nr. 10/ZDP/VE/2020 përmes të cilit përcaktohet tarifa njësi terminale në Republikën e Kosovës në vlerë prej 407 EUR, respektivisht të mbetet e njëjtë me vitin 2020 duke filluar nga 1 janari 2021, e vlefshme për një vit. Kjo vlerë e përcaktuar nga AAC është më e vogël se ajo e propozuar nga ASHNA (495.58 EUR). Nën supozimin se rritja e numrit të njësive terminale të shërbyera gjatë vitit 2021 të jetë 97% në krahasim me vitin 2020, kjo tarifë pritet të sjellë të hyra afro 4.27 milion EUR për ASHNA-n.

Tarifa terminale e navigacionit u ngarkohet kompanive ajrore nga ASHNA për shërbimet terminale të navigacionit ajror që kjo ofron në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës. Shërbimet për aeroplanët që mbikalojnë Kosovën do të vazhdojë t'i ofrojë HungaroControl, prandaj edhe të hyrat për këtë shërbim i shkojnë ofruesit të shërbimeve të navigacionit ajror të Hungarisë. Gjatë përcaktimit të tarifave aeronautike, AAC kujdeset që të miratojë vetëm kostot e pranueshme dhe të nevojshme për të dhënë shërbimin në pajtim me rregulloren në fuqi në mënyrë që të ruaj edhe interesin e udhëtarëve dhe konkurrueshmërinë e aeroportit.

Duhet pasur parasysh që kjo tarifë është dukshëm më e lartë sesa në vendet e rajonit: Shqipëri 235.67 EUR, Kroaci 241.33 EUR dhe Maqedoninë e Veriut rreth 271.80 EUR. Kjo për arsye që ASHNA ka të vetmin burim financimi këtë tarifë ndërsa për ofruesit e rajonit të hyrat më të mëdha janë nga tarifa njësi e mbikalimit që ata e vjelin për shërbimet e navigacionit ajror që ofrojnë në hapësirën e lartë ajrore.

Në kuadër të mbikëqyrjes ekonomike të operatorëve, është konfirmuar vlefshmëria e policës së sigurimit të ASHNA-së të datës 11 dhjetor 2019. Polica për përgjegjësi në aviacion mbulon periudhën 1 janar 2020 – 31 dhjetor 2020 dhe ka mbulesë prej 200,000,000 EUR për cilëndo rast dhe në agregat në relacion me përgjegjësinë për produktet ndërsa 20,000,000 EUR për lëndim personal.

- **Mbikëqyrja ekonomike e shërbyesve në tokë**

Në ANP operojnë dy ofrues të shërbimeve në tokë, të cilët janë miratuar nga AAC-ja për këtë qëllim: operatori i ANP "Adem Jashari", LKIA, si ofrues i një game të gjerë

shërbimesh (shërbimet e udhëtarëve, përpunimin e bagazhit, të aeroplanit në tokë etj.) si dhe kompania “Ex Fis” sh.p.k., e cila bën furnizimin e aeroplanëve me derivate. Të dy operatorët janë në mbikëqyrje të vazhdueshme nga AAC-ja për mirëmbajtjen e kritereve të sigurisë dhe atyre ekonomike.

Në përpjekje të AAC për implementimin e rregullores 04/2011 lidhur me ofruesit e shërbimeve në tokë, si drejtor i AAC-së për të sqaruar situatën lidhur me hapjen e tregut jam takuar me palët e interesit si dhe kam drejtuar disa shkresa tek komiteti për partneritet publiko Privat si grup ndërministror, dhe kam kërkuar nga komiteti PPP të përkrah procesin e hapjes së tregut duke qenë se është në interes publik por edhe të vet Aeroportit. Poashtu kam kërkuar shpjegim për tarifën që organi i menaxhuar i Aeroportit aplikon ndaj operatorit të vetëm “Exfis” tarifë e cila nuk është në përputhje as me kontratën e PPP por as nuk është tarifë e cila është aprovuar nga AAC sipas rregullores.

Përmes shkresave dërguar komitetit PPP kemi kërkuar shpjegim për tarifën që aplikon LKIA ndaj “Ex-Fis” e që është 0.12 euro, për të cilën tarifë AAC nuk ka qenë e informuar paraprakisht dhe nuk është aprovuar nga AAC. Për këtë çështje deri më tani AAC nuk ka pranuar ndonjë përgjigje nga Komiteti PPP. AAC është në dijeni se në bazë të Marrëveshjes për PPP në ANP, Aneksi 11 pjesa B, LKIA ka të drejtë të aplikoj tarifën prej 0.02 euro ndaj operatorit që ofron shërbime për furnizim me karburante. AAC-ja respekton në plotëni Marrëveshjen për PPP, mirëpo konsideron që nuk mund të caktohet një tarifë shtesë jashtë kontratës së PPP-së e cila në të njëjtën kohën nuk është e aprovuar nga AAC, në cilësinë e rregullatorit ekonomik.

- **Mbikëqyrja vjetore ekonomike e LKIA si ofrues i shërbimeve në tokë**

Gjatë vitit 2020, organit menaxhues të ANP “Adem Jashari” LKIA i është vazhduar Aprovimi dy herë: prej 1 prill 2020 deri më 01 tetor dhe prej 01 tetor deri më 31 mars 2021. Pas shqyrtimit të aplikacionit është konstatuar se operatori i përmbush kushtet e parapara të Rregullores nr. 04/2011 të ndryshuar me Rregulloren (AAC) nr. 05/2019 si furnizues i shërbimeve në tokë për palë të treta në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës që kanë të bëjnë me qëndrueshmërinë financiare të nevojshme për të mbajtur nivelin e dëshiruar të sigurisë së operimeve.

- **Mbikëqyrja e jashtëzakonshme ekonomike e LKIA si ofrues i shërbimeve në tokë për shkak të pandemisë**

Si rezultat i uljes së trafikut të shkaktuar nga pandemia COVID-19 në ANP dhe efektin që kjo situatë ka pasur në aktivitetin në aeroport, AAC-ja ka monitoruar gjatë 2020 në periudha të rregullta tremujore shëndetin financiar të LKIA si ofrues i shërbimeve në tokë, deri në stabilizimin e situatës, për të vlerësuar nëse operatori po mirëmban kushtet ekonomike në bazë të të cilave është aprovuar, në pajtim me Nenin 11.4 të Rregullores nr. 4/2011 për shërbimet në tokë të ndryshuar me Rregulloren (AAC) nr.05/2019.

Në raportet tremujore të mbikëqyrjes ekonomike për vitin 2020 është konkluduar që kriza dhe ulja e trafikut prej 53% që ka shkaktuar atë ka prekur shëndetin financiar të LKIA e cila ka filluar të përmirësohet në tremujorin e fundit. Marxhina e profitit dhe e operimeve ka rënë në -39% dhe -2% respektivisht gjatë vitit 2020.

Gjendja e keshit në dispozicion ka shënuar rritje gjatë tremujorit të fundit të 2020, sigurisht pasi ka rikapitalizuar ose ka pasur financim shtesë.

AAC-ja do të vazhdojë mbikëqyrjen ekonomike nëpër tremujor deri në tejkalimin e krizës. Kriza dhe ulja e trafikut që ka shkaktuar atë vazhdon të ketë ndikim në shëndetin financiar të LKIA.

- **Mbikëqyrja vjetore ekonomike e “Ex-fis” shpk si ofrues i shërbimeve në tokë**

Gjatë vitit 2020, operatorit “Ex Fis” i është vazhduar Aprovimi dy herë: prej 1 maj 2020 deri më 31 korrik 2020 dhe prej 01 gusht 2020 deri më 31 janar 2021.

Pas shqyrtimit të aplikacionit është konstatuar se operatori i përmbush kushtet e parapara të Rregullores nr. 4/2011 të ndryshuar me Rregulloren (AAC) nr. 05/2019 si furnizues i shërbimeve në tokë për palë të treta në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës që kanë të bëjnë me qëndrueshmërinë financiare të nevojshme për të mbajtur nivelin e dëshiruar të sigurisë së operimeve.

Analiza e pasqyrave të audituara financiare të operatorit “Ex Fis” sh.p.k. ka vërtetuar se kompania e aprovuar nga AAC-ja për furnizim të mjeteve ajrore me karburant ka pasur gjendje të mirë financiare gjatë vitit 2019, si dhe është përmbushur kërkesa nga Rregullorja nr. 04/2011 e AAC-së të ndryshuar me Rregulloren (AAC) nr. 05/2019 për ndarje të llogarive të biznesit që zhvillohet në aeroport nga aktivitetet tjera biznesore që zhvillon kjo kompani.

Gjithashtu, është konfirmuar vlefshmëria e policës së sigurimit të “Ex fis” sh.p.k. e cila ka mbulesë 500,000,000 USD për cilindo rast dhe në agregat në relacion me përgjegjësinë për produktet dhe mbulon periudhën 26 maj 2020 – 25 maj 2021. Ky është një element tjetër i rëndësishëm i mbikëqyrjes ekonomike të operatorëve në fushën e aviacionit civil.

- **Mbikëqyrja e jashtëzakonshme ekonomike e “Ex- Fis”shpk për shkak të pandemisë**

Si rezultat i uljes së trafikut të shkaktuar nga pandemia COVID-19 në ANP në nivel prej -53% dhe efektin që kjo situatë ka pasur në aktivitetin e operatorëve në aeroport, AAC-ja ka monitoruar gjatë vitit 2020 në periudha të rregullta tremujore shëndetin financiar të ofruesve të shërbimeve në tokë, deri në stabilizimin e situatës, për të vlerësuar nëse operatori po mirëmban kushtet në bazë të të cilave është aprovuar duke përfshirë ato ekonomike, në pajtim me Nenin 11.4 të Rregullores nr.04/2011 për shërbimet në tokë të ndryshuar me Rregulloren nr.05/2019.

Gjatë tremujorëve të vitit 2020 "Ex Fis" shpk sh.p.k. në tërësi përkundër krizës ende është biznes rentabil. Përderisa shitja është ulur si rezultat i pandemisë, veçanërisht në aeroport, proporcionalisht janë ulur edhe kostot ndërsa biznesi përshkruhet me kosto kryesisht variable.

AAC do të vazhdoj mbikëqyrjen deri në tejkalimin e krizës edhe pse tanimë është e qartë se sa i përket Ex Fis sh.p.k. efekti më i madh i krizës ka kaluar por operimet në aeroport ende operojnë me humbje. Për momentin nuk ka ndonjë çështje specifike që duhet theksuar.

8.10 *AKTIVITETI LEGJISLATIV*

AAC-ja në bazë të kompetencave të dhëna në Ligjin nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil, është e autorizuar të nxjerrë akte nënligjore për zbatim të Ligjit për Aviacionin Civil, me të cilat bëhet përvetësimi i standardeve ndërkombëtare të aviacionit civil (të njohura si Standardet dhe Praktikat e Rekomanduara "SPR" e anekseve të Konventës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil - Konventa e Çikagos) dhe të atyre për zbatim të legjislacionit të BE-së në fushën e aviacionit civil, si ato në kuadër të Marrëveshjes HPEA, ashtu edhe të tjerat, të cilat vlejnë për vendet e BE-së, por që ende nuk janë bërë zyrtarisht pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

AAC bën zbatimin e legjislacionit të BE-së në përputhje të plotë me dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 3/2013 të Qeverisë së Kosovës për standardet e hartimit të akteve normative. Kjo ndër të tjera nënkupton që secila projekt-rregullore e hartuar nga AAC-ja, që zbaton një akt nënligjor të BE-së, kalon nëpër procedurën e miratimit nga Ministria e Integriteteve Evropiane para se të nënshkruhet nga Drejtori i përgjithshëm.

a) Aktet nënligjore

AAC aplikon procedurë transparente gjatë nxjerrjes së akteve nënligjore në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr. 1/2012 të AAC-së për procedurat e konsultimit publik. Të gjitha aktet nënligjore të AAC-së i nënshtrohen procesit të konsultimit publik të palëve të interesit. Ky konsultim ndjek procedurat dhe afatet kohore të dhëna, gjatë të cilit, çdo palë interesi, qoftë person fizik apo juridik, ka të drejtën e dhënies së komenteve, sugjerimeve apo të kërimit të informacioneve shtesë nga strukturat e AAC-së, të cilat e nxjerrin një projekt-akt në konsultim publik. Forma e marrjes së këtyre komenteve/sugjerimeve nga palët e interesit mund të jetë me organizim të tryezave të rrumbullakëta, varësisht nga numri i të interesuarve, apo nëpërmes korrespondencës elektronike. Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik, strukturat e AAC-së brenda 2 javëve janë të obliguara që të përgatisin një raport, në të cilin do t'i ofrojnë përgjigjet e tyre në komentet e pranuar, ndërsa duhet të shpjegojnë arsyet për pranimin apo mospranimin e sugjerimeve për ndryshim të dispozitave të projekt-aktit nënligjor që është objekt i konsultimit publik.

Publikimi i akteve nënligjore të AAC-së bëhet në platformën elektronike të Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës si dhe në faqen zyrtare të AAC-së në internet.

Në vazhdim janë aktet nënligjore, të cilat janë nxjerrë gjatë vitit 2020:

- Rregullorja (AAC) nr. 01/2020 për vendosjen e rregullave të përbashkëta ajrore dhe dispozitave operacionale në lidhje me shërbimet dhe procedurat në navigimin ajror dhe ndryshimin e Rregullores (AAC) 07/2012, Rregullores (AAC) 03/2016, rregullores (AAC) 15/2010 dhe rregullores (AAC) 08/2017.
- Rregullore (AAC) nr. 02/2020 që përcakton kërkesat e përdorimit të hapësirës ajrore dhe procedurat e operimit në lidhje me navigimin e bazuar në performancë;
- Rregullore (AAC) nr. 03/2020 për ndryshimin e rregullores (AAC) nr. 12/2015 për sa i përket listës së transportuesve ajrorë të cilët janë të ndaluar të operojnë ose janë subjekt i kufizimeve operacionale brenda republikës së Kosovës;
- Rregullore (AAC) nr. 04/2020 për kushtet dhe metodat e transportit të mallrave të rrezikshme përmes ajrit;
- Rregullore (AAC) nr. 05/2020 për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe themelimin e agjencisë së bashkimit evropian për sigurinë e aviacionit dhe ndryshimin e rregullores (AAC) NR. 10/2015 dhe shfuqizimin e rregullores (AAC) NR. 11/2009, rregullores (AAC) NR. 03/2009 dhe rregullores (AAC) NR. 6/2009;
- Rregullore (AAC) nr. 06/2020 për kushtet dhe mënyrën e përdorimit të paragjajdëve dhe deltaplanëve
- Rregullore (AAC) nr. 07/2020 për aftësimin profesional për punonjësit të cilët kryejnë detyra që ndikojnë në sigurinë e operimeve në aerodrome dhe certifikimin e organizatave për aftësi profesionale
- Rregullore (AAC) nr. 08/2020 që përcakton rregullat e hollësishme për operimin e veloreve në përputhje me rregulloren (AAC) NR. 05/2020
- Rregullore (AAC) nr. 09/2020 për përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror/navigimit ajror dhe funksioneve tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre. Rregullorja është nënshkruar nga Drejtorit të Përgjithshëm më 31 dhjetor 2020

Janë hartuar edhe këto projekt-rregullore:

- Projekt Rregullore (AAC) nr. XX/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01/2017 për sistemet e mjeteve ajrore pa pilot (SAP);
- Projekt Rregullore (AAC) nr. XX/2021 mbi aftësinë mjekësore të personelit të aviacionit të cilët janë subjekt i përjashtimit me Rregulloren (AAC) nr. 05/2020;
- Projekt rregullore e AAC-së nr. XX/2021 që ndryshon Rregulloren (AAC) Nr. 15/2017 në lidhje me prezantimin e specifikimeve të reja shtesë të vlefshmërisë ajrore;
- Projekt Rregullore (AAC) nr. XX/2021 e cila ndryshon Rregulloren (AAC) nr. 01/2019 për kërkesat e operimeve ajrore për velorë dhe çantat elektronike të fluturimit.
- Projekt Rregullores për ndryshimin e Rregullores Nr. 05/2013 për futjen në fuqi të botimit të fundit, përkatësisht edicionit 16 të Aneksit 15, për ta zëvendësuar ose amenduar Rregulloren Nr. 05/2013.

Projekt-rregulloret e listuara më lart pritet të hyjnë në fuqi gjatë vitit 2021.

b) Urdhëresat administrative, Vendimet ekzekutive dhe vendimet administrative

Në vijim janë listuar vendimet ekzekutive dhe ato administrative të lëshuara nga Drejtori i përgjithshëm i AAC-së gjatë vitit 2020:

Urdhëresat Administrative

- Urdhëresa administrative (AAC) nr. 1/2020 mbi masat për të zvogëluar rrezikun e përhapjes së virusit COVID-19.
- Urdhëresa administrative (AAC) nr. 2/2020 mbi përgatitjet e aeroporteve për kthim në operime normale dhe zbatimin e protokollit të sigurisë së shëndetit në aviacion për COVID-19.
- Urdhëresë Administrative (AAC) NR. 3/2020 mbi përgatitjet e aeroporteve për kthim në operime normale, rreth ofrimit të shërbimeve në tokë në aeroporte dhe zbatimin e protokollit të sigurisë së shëndetit në aviacion për Covid-19
- Urdhëresë Administrative (AAC) nr. 04/2020 për respektim të orarit të punës
- Urdhëresa Administrative (AAC) NR. 5/2020 për operacionet e aeroplanëve me shkronjë më të lartë të kodit

Udhëzimet Administrative

- Udhëzimi Administrativ (AAC) nr. 01/2020 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ nr. 2/2011.

Vendimet ekzekutive dhe vendimet administrative

Në vijim janë listuar vendimet ekzekutive dhe ato administrative të lëshuara nga Drejtori i përgjithshëm i AAC-së gjatë vitit 2020:

Vendimet ekzekutive

1. Vendimi 01/ZDP/VE/2020, dt. 30 janar 2019, për zgjatje të afatit për Ex Fis si ofrues i shërbimeve në tokë në ANP, për furnizim me karburante;
2. Vendimi 02/ZDP/VE/2020, dt. 08 mars 2020, për ndalimin e fluturimeve nga Italia Veriore për shkak të COVID-19; dhe
3. Vendimi 03/ ZDP/VE/2020, dt. 08 mars 2020, për zgjatje të afatit për LKIA si ofrues i shërbimeve në tokë në ANP.
4. Vendimi nr. 2020/01/94, dt. 27 mars 2020, paraprovim i kushtëzuar “Invious Group” sh.p.k.
5. Vendimi 04/ZDP/VE/2020 i dt. 01 prill 2020 për lëshimin e para-aprovimit të kushtëzuar për angazhim në aktivitetet e shërbimeve në tokë për palë të treta në ANP për kategorinë shërbimi me derivate dhe vajra.
6. Vendimi 05/ZDP/VE/2020 i dt. 22 prill 2020 për zgjatje të aprovimit për ofrimin e shërbimeve në tokë për furnizim me karburante në ANP
7. Vendimi 06/ZDP/VE/202022 i dt. 22 maj 2020 për aprovim të Programit Nxitës 2020-2022 për ANP "Adem Jashari"
8. Vendimi 07/ZDP/VE/2020 i dt. 29 korrik 2020, për zgjatje të aprovimit për ExFis për dhënie të shërbimeve në tokë për furnizim me derivate;
9. Vendimi 08/ZDP/VE/2020 i dt. 14 shtator 2020, për autorizim të Qendrës së Mjekësisë së Punës në Gjakovë si QMA; dhe
10. Vendimi 09/ZDP/VE/2020 i dt. 29 shtator 2020, për zgjatje të afatit të LKIA për dhënie të shërbimeve në tokë.
11. Vendimi 10/ZDP/VE/2020 i dt. 24 dhjetor 2020 për tarifën terminale për AShNA për vitin 2021.

Vendimet administrative

1. Vendimi 01/2020, dt. 06 janar 2020, për ndryshimin e Vendimit 51/2019 dhe 54/2019 të lidhura me Komisionin e Ristrukturimit;

2. Vendimi 02/2020, dt. 06 janar 2020, për caktimin e komisionit për negocimin e vazhdimin të kontratës me qira;
3. Vendimi 03/2020, dt. 16 janar 2020, për caktimin e anëtareve të Komisionit Disiplinor;
4. Vendimi 04/2020, dt. 17 janar 2020, për caktimin e personit përgjegjës për vulën katrore;
5. Vendimi 05/2020, dt. 17 janar 2020, për caktimin e personit përgjegjës për vulën rrethore;
6. Vendimi 06/2020, dt. 17 janar 2020, për caktimin e personit përgjegjës për vulën e vogël;
7. Vendimi 07/2020, dt. 17 janar 2020, për caktimin e Komisionit për shenjat unike të klasifikimit të dokumenteve dhe afatin e ruajtjes së tyre në AAC;
8. Vendimi 08/2020, dt. 24 janar 2020, për caktimin e anëtarit të tretë të komisioni disiplinor;
9. Vendimi 09/2020, dt. 24 janar 2020, për caktimin e Komisionit për tjetërsim /asgjësim;
10. Vendimi 10/2020, dt. 27 janar 2020, për ndryshim të Vendimit nr. 09/2020;
11. Vendimi 11/2020, dt. 28 janar 2020, për caktimin e Komisionit për përpilimin e specifikave teknike;
12. Vendimi 12/2020, dt. 30 janar 2020, për caktimin e anëtarëve të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave (KZKA);
13. Vendimi 13/2020, dt. 05 shkurt 2020, për caktimin e anëtarit të tretë të Komisionit për Shqyrtimin e gjobave administrative;
14. Vendimi 14/2020, dt. 14 shkurt 2020, për caktimin e Komisionit për vlerësimin e aplikacioneve të shërbimeve në tokë;
15. Vendimi 15/2020, dt. 19 shkurt 2020, për caktimin e anëtarit të tretë të Komisionit për zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave;
16. Vendimi 16/2020, dt. 24 shkurt 2020, për caktimin e anëtarit të tretë të Komisionit Disiplinor;
17. Vendimi 17/2020, dt. 27 shkurt 2020, për caktimin e anëtarit të tretë të Komisionit për zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave;
18. Vendimi 18/2020, dt. 10 mars 2020, për caktimin e Komisionit për përzgjedhjen e objektit me qira;
19. Vendimi 19/2020, dt. 10 mars 2020, për caktimin e anëtarit të tretë të KZKA;
20. Vendimi 20/2020, dt. 12 mars 2020, për caktimin e anëtarit të tretë të KZKA;
21. Vendimi 21/2020, dt. 19 mars 2020, për caktimin e stafit esencial në situata të jashtëzakonshme.
22. Vendimi 22/2020, dt. 23 mars 2020, për shfrytëzimin e telefonisë mobile dhe fikse;

23. Vendimi 23/2020 i dt. 24 prill 2020 për shfuqizim të Vendimit me nr. ref 51/2019 dhe Vendimit me nr. ref 54/2019;
24. Vendimi 24/2020 i dt. 30 prill 2020 për caktimin e Komisionit për shqyrtimin e shkeljeve administrative;
25. Vendimi 25/2020, dt. 04 maj 2020 për caktimin e personit përgjegjës për vullë rrethore;
26. Vendimi 26/2020, dt. 04 maj 2020 për caktimin e personit përgjegjës për vullë katrore;
27. Vendimi 27/2020, dt. 07 maj 2020 për caktimin e anëtareve për përpilim të specifikacioneve teknike për aktivitetin e prokurimit " Furnizim me material higjienik";
28. Vendimi 28/2020, dt. 14 maj 2020 për caktimin e komisionit për evidentimin e aseteve / pasurisë dhe dokumenteve në zyrën e Drejtorit të përgjithshëm;
29. Vendimi 29/2020, dt. 15 maj 2020 për caktimin e zyrtar për komunikim me publikun dhe zyrtar përgjegjës shqyrtimin e kërkesave për qasje në dokumente zyrtare;
30. Vendimi 30/2020, dt. 18 maj 2020 për anulimin e Rregullores së Brendshme të AAC-së;
31. Vendimi 31/2020, dt. 20 maj 2020 për shfuqizimin e Vendimit me nr. ref. 14/2020;
32. Vendimi 32/2020, dt. 27 maj 2020 për korrigjim të Vendimit me nr. ref. 29/2020;
33. Vendimi 33/2020, dt. 09 qershor 2020 për caktimin e sekretarisë së Komisionit Disiplinor;
34. Vendimi 34/2020, dt. 09 qershor 2020 për caktimin e anëtarit të tretë të Komisionit Disiplinor;
35. Vendimi 35/2020, dt. 09 qershor 2020 për caktimin e Ushtruesit të detyrës së Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve të Navigimit Ajror;
36. Vendimi 36/2020, dt. 09 qershor 2020 për ndryshimin e Vendimit me nr. ref. 12/2020;
37. Vendimi 37/2020, dt. 09 qershor 2020 për caktimin e anëtarit të tretë të KZKA;
38. Vendimi 38/2020, dt. 09 qershor 2020 për caktimin e Sekretarisë së KZKA;
39. Vendimi 39/2020, dt. 10 qershor 2020 për shfuqizim të Vendimit me nr. ref 26/2020;
40. Vendimi 40/2020, dt. 10 qershor 2020 për caktimin e personit përgjegjës për ushtrimin e detyrave të Personelit;
41. Vendimi 41/2020, dt. 25 qershor 2020 për ndryshimin e Vendimit me nr. ref. 34/2020;
42. Vendimi 42/2020, dt. 29 qershor 2020 Komisioni për pranim dorëzim të punës së ud të burimeve njerëzore;

43. Vendimi 43/2020, dt. 07 korrik 2020, për zëvendësimin e anëtarit të tretë të Komisioni Disiplinor;
44. Vendimi 44/2020, dt. 13 gusht 2020, për plotësimin e përshkrimit të detyrave të punës së inspektorit të vlefshmërisë ajrore;
45. Vendimi 45/2020, dt. 19 gusht 2020, për plotësimin e përshkrimit të detyrave të punës së zyrtarit kryesor financiar;
46. Vendimi 46/2020, dt. 26 gusht 2020, për caktimin e kryesuesit të Komisioni për shqyrtimin e shkeljeve administrative;
47. Vendimi 47/2020, dt. 31 gusht 2020, për caktimin e anëtarit të tretë të komisionit për shqyrtimin e shkeljeve administrative;
48. Vendimi 48/2020, dt. 02 shtator 2020, për zëvendësimin e anëtarit të tretë të Komisionit për shqyrtimin e shkeljeve administrative (për shkak të konfliktit të interesit);
49. Vendimi 49/2020, dt. 04 shtator 2020, për caktimin e anëtareve të Komisionit Disiplinor;
50. Vendimi 50/2020, dt. 07 shtator 2020, për autorizimin e përfaqësimit të AAC-së në rastet e procedurës përmbartimore;
51. Vendimi 51/2020, dt. 08 shtator 2020, për autorizimin e drejtorit të DSF për të nënshkruar lejet për mallra të rrezikshme dhe SAP;
52. Vendimi 52/2020, dt. 11 shtator 2020, për zëvendësimin e anëtarit të tretë të Komisioni Disiplinor;
53. Vendimi 53/2020, dt. 24 shtator 2020, për ndryshimin e vijës llogaridhënëse të zyrtarit përgjegjës për prokurim publik;
54. Vendimi 54/2020, dt. 12 tetor 2020 për caktimin e Komisionit të inventarizimit të pasurisë jo financiare;
55. Vendimi 55/2020, dt. 12 tetor 2020 për caktimin e Komisionit për Vlerësim dhe Zhvlerësim të pasurisë jo Financiare;
56. Vendimi 56/2020, dt. 09 tetor 2020, për ndryshimin e Vendimit 54/2020;
57. Vendimi 57/2020, dt. 09 tetor 2020, për ndryshimin e Vendimit 55/2020;
58. Vendimi 58/2020, dt. 20 tetor 2020, për themelimin e Këshillit të Sigurisë;
59. Vendimi 59/2020, dt. 27 tetor 2020, për caktimin e grupit punues për hartimin e projekt Rregullorese se AAC-se për organizim të brendshëm;
60. Vendimi 60/2020, dt. 04 tetor 2020 për autorizim të udhëheqësit të njësisë së burimeve njerëzore dhe caktimi i linjës raportuese;
61. Vendimi 61/2020, dt. 05 nëntor 2020, për shfuqizimin e Vendimit me nr. ref. 31/2020 , për Komisionin për shqyrtimin dhe verifikimin e dokumentacionit të aplikacioneve të ofruesve të shërbimeve në tokë;
62. Vendimi 62/2020, dt. 24 dhjetor 2020, për zgjatje të afatit për përfundim të punës së grupit punues për hartimin e projekt Rregullorese së brendshme.

c) Ndëshkime/ankesa/konteste

Komisioni për Ankesa pranë AAC-së

- Komisioni për Ankesa pranë AAC-së gjatë vitit 2020 ka shqyrtuar Ankesën me nr. te prot. 2020/01/59, dt. 21.02.2020 kundër Vendimit të Komisionit për shqyrtimin e gjobave administrative (me nr. te prot. 2020/03/54).
